

# Revistë edukative-kulturore

# ETIKA

Shqipëri: 150 Lek  
Kosovë: 1 Euro  
Maqedoni: 60 Den  
Europa: 2 Euro

Dhjetor 2010 • Numri: 33 • E përmuajshme

A është parë atë  
që ëpshin të vjetër  
të marrë për zot?  
(Furkan, 25/43)

## EDITORIAL

*L*o është “hyjnizimi i epshit”? Si ndodh?

Ky fenomen është tejkalimi i rregullave të përcaktuara prej Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Për shembull.:

- Nëse ambicia për pasuri e lë nën hije respektimin e parimeve të haramit dhe hallallit.
- Nëse bëhet shkak për neglizhimin e përgjegjësive si zekati apo sadakaja...
- Nëse marrëdhënia juaj me pasurinë ju bën të mendoni se jeni zotëruesi absolut i saj, që e keni fituar me mundin tuaj dhe kjo ju krijon ndjenjën se jeni ju që po i “jepni rrizkun” punëtorëve që keni...
- Nëse bëni si t’ju dojë qejfi...
- Nëse dashuria për fëmijët ju shtyn t’i ndihmoni ato qoftë edhe në vepra të ndaluara...
- Nëse ambicia për famë ju bën që çdo gjë ta shihni si të lejuar, pa marrë parasysh se është haram apo hallall, vetëm e vetëm për t’u ngjitur sa më lart...
- Nëse kur të keni arritur lart, arroganca ju nxit të nënçmoni devotshmërinë ndaj Allahut...
- Nëse pasioni për pushtet ngjall brenda jush një ndjenjë fuqie të pakufishme, ndjenjë e cila ju bën të mendoni se “Nuk ka më të madh se unë” ...
- Nëse epshet seksuale ju bëjnë të shkelni ligjet hyjnore në këtë fushë... dhe nëse bota e juaj e pasioneve ka dalë jashtë kontrollit dhe ka filluar të marrë në dorë frerët... kjo do të thotë se në atë moment ka filluar katastrofa e “hyjnizimit të epshit”.

Shikoni se si e paralajmëron Kurani njeriun në lidhje me tejkalimin e kufinjve të pasioneve njerëzore: *“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia, për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.”* (Et-Teube, 24)

# Do të lexoni:



**Ahmet Tashgetiren / 4**

A e ke parë atë që hyjnizon epshin e vet?

**Nexhat Ibrahim / 8**

Si e kuptuan Islamin myslimanët e parë?

**Prof. Dr. Ethem Xhebexhiollu / 10**

Të ngrënit e pakët sipas Mevlanës

**Mr. Zymer Ramadani / 13**

Ai që dëshirën e bëri zot

**Mr. Abdylkadër Durguti / 16**

Struktura e jetës fetare në periudhën e Muhamedit (a.s.)

**Murat Kaja / 19**

Paralajmërimet e Kuranit në lidhje me dëshirat dhe pasionet e egos vetiak

**Muhamed Sytari / 22**

Një ditë e paharruar që bashkoi dy festa të shënuara...

**Rrustem Spahiu / 24**

(Jo) kultura e trafikut dhe Islami

**Gilman Kazazi / 26**

Vendet më të dashura tek Allahu janë xhamitë

**Ahmet Tashgetiren /**

A e ke parë atë që hyjnizon epshin e vet?



4

**Prof. Dr. Ethem Xhebexhiollu /**

Të ngrënit e pakët sipas Mevlanës



10

**Gilman Kazazi /**

Vendet më të dashura tek Allahu janë xhamitë



26

Viti: V | Numri: 33 | Dhjetor 2010

**Administrator i Progresi botime:**

**Shuaqip Bashan**

bashan43@hotmail.com

+355 69 20 76768

**Drejtor & Kryeredaktor:**

**Alban Kali**

albankali@yahoo.com

+355 69 24 23989

**Përkthyesit:**

**Alban Kali / Elvira Puka**

**Elona Sytari / Evans Drishti**

**Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha / Tasim Darsi**

**Redaktor letrar:**

**Shpëtim Kelmendi**

**Redaktor gjuhësor:**

**Ma. Irida Hoti**

**Dizajn - Grafik:**

**Bledar Xama**

bledar\_xama@hotmail.com

**Për artikuj**

**e-mail: revistaetika@progresibotime.com**


**e-mail: kosova@progresibotime.com**

**e-mail: maqedoni@progresibotime.com**

# Dhjetor 2010

32

**Osman Nuri Topbash /**  
Hz. Osmani (r.a.)



40

**Mr. sci. Flamur Sofiu /**  
Përkujdesja dhe edukimi i fëmijës



58

**Teknologji /**  
Ja mbulesa e qendisur me ar e Qabes



**/30** Një Ajet - Një Hadith

**Osman Nuri Topbash /32** Hz. Osmani (r.a.)

**Mr. sci. Flamur Sofiu /40** Përkujdesja dhe edukimi i fëmijës në të drejtën Islame

**Imam Naim Drijaj / 44** Vetëllogaria

**Mr. Artur Tagani / 46** Kurani si terapi

**/ 48** Enciklopedi Islame  
Meleku i madh Xhebrail

**Mag. Ermal Nurja / 50** Kadri Prishtina dhe revista "Udha e së vërtetës"

**/ 52** Parabola sufi  
- Të shtosh nevojat  
- Mbreti dhe çunaku i varfër

**Familja / 54** Parimet themelore në edukimin e fëmijës

**Shëndeti / 56** Alkooli më i dëmshëm se heroina

**Teknologji / 58** Ja mbulesa e qendisur me ar e Qabes

**Aktualitet / 59** Vizita e kryeministrit Erdogan në Kosovë

**PROGRESI**  
BOTIME  
www.progresibotime.com

**Adresa:**

**L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi**  
**Shkodër / Albania**  
**Tel: +355 22 254 634**  
**Fax: +355 22 254 633**

**Zyra e përfaqësimit Maqedoni**

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25  
Shkup / Maqedoni  
+389 71 956 271

**Zyra e përfaqësimit Kosovë:**

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin  
Prizren / Kosovë  
Tel: +381 29 222 795  
Fax: +381 29 222 797  
+377 441 63 651

**Çmimi:**

**Shqipëri: 150 Lekë**  
**Abonim (një vjetor): 1500 Lekë**  
**Kosovë: 1 Euro**  
**Abonim (një vjetor): 10 Euro**  
**Maqedoni: 60 DEN**  
**Abonim (një vjetor): 720 DEN**  
**Europë: 2 Euro**  
**Abonim (një vjetor): 24 Euro**

# A është parë atë që hyjnizon epshin e vet?

*Ahmet Tashgetiren*

**P**arimi themelor i “**Besimit Islam**” është “**teuhidi**”. Teuhid do të thotë pranim dhe vërtetim i njëshmërisë së Allahut. Të gjitha konceptet e jetës dhe të besimit lidhen me “**teuhidin**”. Sipas Islamit, teuhidi është kuadri ligjor më themelor midis Krijuesit dhe njeriut. Pra, Krijuesi i bën të ditur njeriut se “*Vetëm brenda këtij kuadri mund të kesh marrëdhënie të drejta me Mua.*” Ndërsa shprehja unike e kësaj është “**kelime-i teuhid**”, pra shprehja “**La ilahe illallah**”. Për të këtë arsye, qoftë Profeti (s.a.v.s.), qoftë Kurani dhe ndjenja më e lartë e vetëdijes së myslimanit janë të orientuara në mbrojtjen e teuhidit. Pothuajse e gjithë periudha e Mekes i është dedikuar ndërtimit të vetëdijes së teuhidit. Sipas asaj që mësojmë nga ajete të ndryshme të Kuranit Famëlartë, gjatë gjithë historisë njerëzore i pari mesazh i Krijuesit që të gjithë profetët u kanë komunikuar popujve të cilët janë dërguar ka qenë shprehja “**La ilahe illallah**”. Në polin e kundërt të teuhidit qëndron “**shirku**”. Shirku do të thotë t’i bësh ortak Zotit, pra të shkelësh ligjin e Tij. Në Kuranin Famëlartë bëhet çdo lloj paralajmërimi për të pastruar mendjen e njeriut prej shirkut. Kështu që, këto paralajmërimë bëhen në të gjitha ato fusha, ku njeriu mund të bie në shirk. Shenjtërimi i fuqisë, i urdhrit, i dashurisë, i frikës së dikujt... Pra, nëse dashuria, frika dhe lidhjet e çdo lloji janë më të forta se lidhja

me Allahun e Madhëruar, kjo do të thotë se shirku ka filluar. Por Islami refuzon në mënyrë të prerë çdo lloj dashurie, çdo lloj frike dhe lidhjeje të këtillë. Islami kërkon prej njeriut që brenda kornizës së “**teuhidit**” të pranojë Allahun si të vetmin Krijues, Furnizues, Ligjvënës, dhënës dhe marrës të jetës e llogaritës në ditën e gjykimit. Gjithashtu, nuk pranohet që brenda këtyre fushave të futet në veprim ndonjë fuqi tjetër. Shpesh gjejmë në Kuran ajete që fillojnë me shprehjen “**Pyeti ata.**”, e mënjëherë pastaj radhiten pyetjet si: “**Kush i krijoi qiejt?, Kush ju krijoi prej një pike uji?, Kush është ai që ju furnizon prej tokës?, Kush është krijuesi i jetës dhe i vdekjes?, Kush e zbret ujin prej qiellit?**”.

Përsëri, po në Kuran na bëhet me dije se njerëzit i përgjigjen këtyre pyetjeve me “**Allahu**”. Pastaj vjen pyetja “**Mirë, po atëherë përse një zot tjetër?**”. Në përgjithësi njerëzit ngatërrohen në “**përcaktimin e mënyrës së jetesës**”. Ndonjëherë futen në mes fuqi politike si Faraoni, ndonjëherë futet klasa e priftërinjve, kurse ndonjëherë tjetër epshi dhe pasioni i vetë njeriut... Mbase njeriu as që mund ta kuptojë që në këtë rast ka përdhosur “**teuhidin**” dhe është drejtuar kah “**shirku**”, pra ka shkelur ligjin e Allahut. Një ngjarje e tillë ka ndodhur edhe në periudhën e Profetit (s.a.v.s.). Ajo zhvillohet kështu:

Një ditë, djali i Hatem-i Tainit, Adiji i cili ishte i njohur për bujarinë e tij, vjen për vizitë tek Profeti (s.a.v.s.). Në atë kohë, Adiji ishte ende në fenë e krishterë, pra ende nuk e kishte pranuar Islamin. Në atë çast Resulullahu (s.a.v.s.) lexon këtë ajet prej sures Teube:

**“Në vend të Allahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre...”** (Et-Teube, 31)

Me të dëgjuar këtë ajet, Adiji tha: **“O Resulullah, ata nuk i adhurojnë murgjit e tyre”**. Përgjigja që i jep Resulullahu (s.a.v.s.) Adijit tregon rëndësinë që i jepet teuhidit Islam dhe rregullit të jetës. Profeti (s.a.v.s.) urdhëron kështu: **“Atë që Allahu e ka bërë hallall, ata e bëjnë haram. Ju a nuk vepronit kështu (sipas fjalës së tyre)? Atë që Allahu e ka bërë haram, ata e bëjnë hallall. Ju a nuk vepronit kështu (sipas fjalës së tyre)?”** Ndërsa Adiji i miratoi fjalët e Resulullahut dhe tha: **“Po”**. Pastaj, Resulullahu (s.a.v.s.) tha: **“Ja pra, kjo do të thotë t’i adhurosh ata”**. Ndërsa adhurimi i bëhet vetëm atij që pranohet për Zot. Sipas Kuranit, nëse njeriu fillon t’i pranojë si **“Hallall – Haram”** mendimet e priftërinjve, të murgjve apo të gjithë atyre prijësve fetarë që shkelin ligjet e Allahut, kjo do të thotë se e ka humbur orientimin e devotshmërisë. Në lidhje me këto ajete, Elmallëllë Hamdi Jazër, në tefsirin e tij shprehet kështu: **“Këto transmetime tregojnë se për të bërë dikë zot nuk është kusht që t’i vihet emri “zot”. T’i bindesh urdhrave të dikujt pa e llogaritur nëse është apo jo në përshtatje me urdhrin e Allahut, veçanërisht në çështjet fetare për të cilat pretendohet se ka kompetenca, t’i bindesh atij pa u menduar se ato që thotë mund të jenë në kundërshtim me urdhrat e Allahut, si dhe t’i zbatosh këto urdhra si adhurime, do të thotë se e ke bërë zot atë dhe po e adhuron.”** Në të njëjtën kohë, Elmallëllë flet edhe për ndryshimin që ekziston midis urdhrat të Kuranit për **“Bindje ndaj udhëheqësve”** dhe qortimeve për **“bindjen ndaj priftërinjve dhe murgjve”**. Më konkretisht, ai shprehet kështu: **“A nuk është farz urdhri i Allahut për t’iu bindur dijetarëve të fesë e prijësve që janë edhe udhëheqës të shtetit? Atëherë përse qortohet bindja e jahudinjve dhe e të krishterëve ndaj urdhrave të prijësve të tyre fetarë, murgjve dhe priftërinjve? Këtu s’ka arsye të mendojmë në këtë mënyrë, sepse ajo për të cilën bëhet fjalë nuk është bindja dhe dorëzimi ndaj Allahut, por bindja ndaj urdhrave që bien ndesh me urdhrat e Allahut.”** Gjithashtu, Elmallëllë na kujton se kur thuhet zot **“përveç Allahut”**, nënkuptohen krijesa si shejtani, Nemrudi dhe Faraoni. Për më tepër, ai thotë kështu: **“Nëse shpërfillen urdhrat e Allahut dhe të dijetarëve, u jepen kompetenca për të vënë ligje ose për të bërë ndryshime qoftë edhe në një pjesë të vogël**



të ligjit, do të thotë se dikujt tjetër përveç Allahut i janë dhënë kompetencat e Zotit. Ashtu sikundër është shirk e kufur të adhurosh shejtanin, Nemrudin, Faraonin dhe idhujt e tjerë, po ashtu është shirk edhe lartësimi e madhërimi i tepruar i dijetarëve. Për shembull, t’i bindesh dikujt që nuk e ndan të drejtën nga e shtrembëra, të vërtetën nga e kota, një personi, fjalët e të cilit nuk mbështeten në urdhrat e Allahut, duke i mbajtur lart fetvatë që mbështeten në qejfet e tij, a thua se ka kompetenca të bëjë haram atë që Allahu ka bërë hallall dhe të kundërtën, a thua se ka të drejtë të ndryshojë ligjet e Allahut, ndërkohë që gabimet e këtij njeriu duken qartë, e tërë kjo përbën shirk dhe kufur. Pra, kjo do të thotë të lësh Allahun dhe të adhurosh dikë tjetër.” Duke trajtuar çështjen e botës së krishterë, Elmallëllë prek edhe një pikë tjetër interesante dhe shprehet: **“Kompetenca e Zotit kaloi prej priftërinjve tek deputetët (parlamentarët)”**. Më tej vazhdon kështu: **“Në kristianizëm, privilegji i klases së priftërinjve për të marrë kompetencat e Zotit quhet “klerikalizëm”. Protestantizmi doli si rrymë që e kundërshtoi këtë koncept. Më vonë, kompetencat e Zotit dolën nga duart e priftërinjve dhe kaluan te parlamentarët.”** (Hak Dini Kur’an Dili, c.4, s.318-319, I. Karaçam, E. Işık, N.



Bolelli, A. Yücel)

Në Kuran, ka shumë ajete që i tërheqin vëmendjen njeriut që **“të mos i bindet epshit të tij apo epshit të dikujt tjetër”**. Mirëpo, dy ajete e vënë theksin tek rreziku i shirkut. Kur i lexojmë këto dy ajete si një të vetëm, del në pah qartë mënyra e konceptimit të personit që **“hyjnizon epshin e tij”**. Ja disa ajete të sures El-Xhathije:

**“Mendo pak! Kush, përveç Allahut, mund ta udhëzojë atë njeri që dëshirat e veta i ka bërë zot; atë njeri të cilin Allahu, duke e njohur për të tillë, e ka shpënë në humbje, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën e duke i vënë perde para syve të tij?! A nuk po merrni vesh? Ata thonë: ‘Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë dhe vetëm koha na shkatërron’. Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, ata vetëm hamendësojnë ashtu.”** (El-Xhathije, 23-24)

Ndërsa në suren El-Furkan, profili i personit që **“hyjnizon epshin e tij”** jepet në këtë mënyrë:

**“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij? A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti. Madje, ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë.”** (El-Furkan, 43-44)

Në komentimin e këtyre ajeteve Ibën Xheriri thotë: **“Ai që vepron sipas epshit dhe dëshirës së vet pa marrë parasysh hallallin dhe haramin që ka caktuar Allahu, e ka marrë epshin e vet për zot”**. Ndërsa El Xhessasi thotë: **“Një njeri i tillë i bindet epshit të vet ashtu siç i bindet Allahut”**. Zemahsheriu në tefsirin e tij shprehet kështu: **“Ai që vepron sipas orientimit të epshit të tij i bindet epshit të tij njësoj siç i bindet Allahut”**. (Meududi, Tefhimu’l Kur’an, vol. 5, faq 326-328)

Në lidhje me **“atë që hyjnizon epshin e tij”**, ajetet e Kuranit nënvizojnë këto veçori:

- Këta lloj njerëzish i kanë veshët dhe zemrat të kyçura, pra nuk mund të dëgjojnë dhe nuk mund të ndjejnë dhe në sytë e tyre ka rënë perde.

- Ata kujtojnë se jeta e kësaj bote është gjithçka. Të lindësh, të vdesësh dhe kaq. Sipas tyre kjo jetë nuk ka kuptim tjetër. Ata janë të pavetëdijshëm për jetën e amshueshme dhe si rrjedhojë janë larg mendimit se një ditë do të japin llogari për gjithçka që veprojnë e nuk veprojnë. Mirëpo kjo është një hamendje e tyre që nuk mbështetet në asnjë dituri të saktë.

- Të adhurosh epshin, pra të bëhesh rob i pasioneve personale, kjo të degradon në nivelin e kafshës, madje të bën edhe më të hutuar se ajo, sepse kafsha nuk ka vetëdije e nuk planifikon gjë sipas pasioneve. Ndërsa njeriu që bëhet rob i pasioneve të veta, ai është në gjendje të bëjë çdo të keqe. Për këtë arsye, njeriu që është rob i pasioneve të veta mund të degradohet në një nivel më të ulët se kafshët. Ky lloj individi ndodhet në një gjendje edhe më të rrezikshme se ata që adhurojnë drurët apo gurët. Nga një anë, pasionet e veta e kanë shtyrë ta vendosin veten në qendër të të gjithë njerëzimit, pra, pasionet ia kanë verbuar sytë e zemrën, ndërsa nga ana tjetër është kapluar nga ndjenja e mungesës së përgjegjësisë, e cila e bën të pandehë se kjo jetë është gjithçka dhe se nuk do të japë llogari për asnjë vepër. Mendjen dhe vetëdijen që i është falur e ka bërë rob të egos së tij... Prandaj, nuk ka adhurim idhujsh që mund të jetë më i prishur dhe më i rrezikshëm se ky. Sipas një hadithi të transmetuar nga Ebu Umame, Resulullahu (s.a.v.s.) ka urdhëruar kështu:

**“Tek Allahu, prej idhujve të rremë që adhurohen përveç Tij, më i keqi është epshi i njeriut.”** (Taberani)

Po ç’është **“hyjnizimi i epshit”**? Si ndodh?

Ky fenomen është tejkalimi i rregullave të përcaktuara prej Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Për shembull.:

- Nëse ambicia për pasuri e lë nën hije respektimin e parimeve të haramit dhe hallallit.

- Nëse bëhet shkak për neglizhimin e përgjegjësi si zekati apo sadakaja...

- Nëse marrëdhënia juaj me pasurinë ju bën të mendoni se jeni zotëruesi absolut i kësaj pasurie, që e keni fituar me mundin tuaj dhe kjo ju krijon ndjenjën se jeni ju që po i **“jepni rrizkun”** punëtorëve që keni...

- Nëse bëni si t’ju dojë qejfi...

- Nëse dashuria për fëmijët ju shtyn t’i ndihmoni ato qoftë edhe në vepra të ndaluara...

- Nëse ambicia për famë ju bën që çdo gjë ta shihni si të lejuar, pa marrë parasysh se është haram apo hallall, vetëm e vetëm për tu ngjitur sa më lart...

- Nëse kur të keni arritur lart, arroganca ju nxit të nënçmoni devotshmërinë ndaj Allahut...

- Nëse pasioni për pushtet ngjall brenda jush një ndjenjë fuqie të pakufishme, ndjenjë e cila ju bën të mendoni se **“Nuk ka më të madh se unë”** ...

- Nëse epshtet seksuale ju bëjnë të shkelni ligjet hyjnore në këtë fushë... dhe nëse bota e juaj e pasioneve ka dalë jashtë kontrollit dhe ka filluar të marrë në dorë frerët... kjo do të thotë se në atë moment ka filluar katastrofa e **“hyjnizimit të epshit”**.

Shikoni se si e paralajmëron Kurani njeriun në lidhje me tejkalimin e kufinjve të pasioneve njerëzore: **“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia, për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.”** (Et-Teube, 24)

Kurani është harta e rrugës që do t’i ndriçojë udhën njeriut deri në pafundësi. Kurani është një udhëzues hyjnor që përcakton në çdo kohë problemet personale të njerëzve dhe i nxit ata të gjejnë marrëdhëniet e duhura me Allahun Teala. Edhe sot, e madje më shumë se kurrë, problemi i **“hyjnizimit të epshit”** është kthyer në problemin kryesor të njeriut. Mentaliteti *“jetojmë dhe vdesim... më tej nuk ka”* ndikon një pjesë të madhe të shoqërisë. Imagjinata e një jete pa botë tjetër e çrregullon mendjen njerëzore. Pasionet e përkohshme të kësaj bote kanë fituar një ndikim aq të madh, sa ia ka errur



sytë egos së njeriut. Njeriu është rrethuar në të gjitha anët nga kjo botë, dhe përderisa ai të vazhdojë të jetë rob i pasioneve, kjo botë do të vazhdojë t’i ngjajë një pylli të egër...

I ndërthurur me teknologjinë marramendëse, ndërveprimi i pasioneve të njeriut do ta çojë Gjithësinë në një atmosferë shkatërrimi dhe egërsie të pamendueshme, në luftëra dhe në padrejtësi ndaj të dobtëve.

**“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve...”** (Er-Rum, 41)

**“Sikur e Vërteta të ishte sipas dëshirave të tyre, atëherë do të shkatërroheshin qiejt dhe Toka e gjithçka që gjendet në to...”** (El-Mu’minun, 71)

Në Kuranin Famëlartë, Allahu Teala përcakton një lloj njeriu dhe kërkon prej nesh që të mos jemi brenda cilësive të atij lloji. Ai lloj njeriu është rob i pasioneve të veta. Ai lloj njeriu hyjnizon pasionet e veta dhe po në emër të pasioneve qëndron larg ligjeve hyjnore.

Brenda kornizës së teuhidit duhet të skanojmë edhe njëherë personalitetin tonë dhe të pastrohemi njëherë e përgjithmonë prej gjërave që janë në kundërshtim me **“Teuhidin”** e që na kujtojnë adhurimin e egos, adhurimin e epshit tonë dhe të krijesave të tjera përveç Allahut.





# Si e kuptuan Islamin myslimanët e parë?

Nexhat Ibrahim

**A**nalizat dhe shqyrtimet historike në lidhje me brezat e parë të myslimanëve janë mbështjellë disi me vellon e hyjnoses dhe të paprekshmërisë. Për këtë veprim të tyre, këta thirren në fjalë të Muhamedit (a.s.) se për ashabet duhet të flitet vetëm me respekt e dashuri. Megjithatë, në këtë respekt e dashuri shpesh shpërfillet faktori njeri, faktori i iniciativës, respektivisht faktori i planifikimit dhe i veprimit njerëzor, i rezultateve dhe pasojave, faktori njeri që në çështje të caktuara është i pavarur prej urdhërësave nga lart. Ata që e shohin Muhamedin (a.s.) vetëm si instrument të thjeshtë të shpalljes, gabojnë, sepse krahas udhëzimeve nga shpallja ai ka pasur hapësirë të mjaftueshme për ta angazhuar potencialin e tij mendor dhe aftësitë strategjike. Ai për vete nuk pretenduar diçka jashtë njerëzores. Allahu në Kuran thotë: **“Unë jam vetëm një njeri si ju, që më është shpallur se Zoti juaj është një Zot i Vetëm ...”**. (El-Kehf, 110), duke mos pretenduar se është diçka jashtë njerëzve.

Mu'xhizja e vetme që ka pasur Muhamedi (a.s.) është Kurani. Ai e ka ndihmuar Muhamedin (a.s.), por edhe çdo besimtar tjetër, që ta maksimalizojë potencialin e tij intelektual-shpirtëror dhe ta jetojë Kurantin. Kjo, meqenëse për përhapjen dhe jetësimin e një ideje ka nevojë për njerëz të mençur dhe largpamës, pasi vetvetiu ideja e vërtetë nuk garanton edhe përhapjen e jetësimin e saj në mesin e njerëzve.

Në lidhje me këtë e pamë të arsyeshme të japim disa qortime, sepse të angazhuar në jashtësi që t'u përngajmë sa më shumë brezave të parë, kemi harruar të studiojmë e përvetësojmë edhe brendinë e mësimëve të tyre, çdo gjë që ata i bëri ata të mëdhenj, si në planin material ashtu edhe në

atë shpirtëror.<sup>1</sup>

## AFTËSIA E VROJTIMIT DHE E GJYKIMIT

Për të mos hyrë në trajtime e teorizime të gjata, do të kalojmë drejtpërdrejt në një ndodhi që na rrëfen Omeri (r.a.): “Një ditë ishim duke ndejur te i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur u duk një njeri me rroba shumë të bardha dhe flokë shumë të zeza. Në të nuk hetohesh shenja e udhëtimit dhe askush prej nesh nuk e njohu...” (Muslimi)<sup>2</sup>

Sipër e kemi hadithin e njohur kur erdhi Xhibrili në formë njeriu dhe i mësoi njerëzit në fenë e tyre nëpërmjet shtruarjes së pyetjeve Muhamedit (a.s.) dhe besimtarëve të pranishëm. Në tërë këtë është interesant reagimi i Omerit (a.s.) ndaj këtij njeriu të huaj dhe vrojtimi i tij i saktë sa u takon të gjitha hollësive që lidhen me këtë temë:

1. Rroba shumë të bardha;
2. Flokë shumë të zeza;
3. Nuk ka shenja të udhëtimit;
4. Askush nga të pranishmit nuk e njohu të huajin.

5. Këtu kemi shembullin e syrit, i cili në çast skenon tërë shfaqjen e personit tjetër, për të përfunduar dhe gjykuar se nuk kemi të bëjmë me njeri të zakonshëm por me person që ka ardhur tek ata nëpërmjet ndonjë mënyre tjetër. Këtë e vërejtë edhe në fytyrat e ashabeve të tjerë. E tërë kjo vërteton se syri dhe mendja e njeriut është e aftë të vrojtojë

1. Husejn Ahmed Emin, Përsiatje për gjendjen e vërtetë të Të Parëve të mirë (Selef'us-salih), në: Havle'd-da'veti ila tatbiki'sh-sheriatil'islamijeh, Darun-nahdatil'arabijeh, Bejrut, 1985, fq. 101-112.

2. Imam En-Neveviu, Dyzet hadithe dhe shtojca e Ibni Rexhebit, Shkup, 1413, 1992, fq. 10-13.

edhe çaste të tjera me rëndësi, lidhur me aktivitetin dhe veprimin e tyre gjatë jetës.<sup>3</sup>

## LARGPAMËSIA E MUHAMEDIT (A.S.) DHE E SURAKËS

Suraka bin Maliku ishte i vetmi që zbuloi gjurmët e Muhamedit (a.s.) dhe të Ebu Bekrit, pas daljes së tyre nga shpella Theur, në jug të Mekës, rrugës për në Medinë duke ecur në shtegun më pak të shkelur me qëllim që t'i vriste. Mirëpo, teksa u përpoq të përmbushte qëllimin e tij, atë e pengonte zënia në thua e kalit të tij, derisa më në fund hoqi dorë nga qëllimi i vrasjes. Me këtë rast, Suraka kërkoi të merrte një garanci me shkrim nga Muhamedi (a.s.), që kur myslimanët të bëheshin fuqi politiko-ekonomike, atij do t'i falej jeta. Muhamedi (a.s.) ia dha këtë garanci. Dhe ishte pikërisht kjo garanci ajo që ia shpëtoi jetën Surakës në Hunejn, kur ai luftonte si jomusliman kundër myslimanëve. Suraka e pranoi Islamin vetëm pas çlirimit të Mekës.<sup>4</sup>

Shembulli i Surakës na mëson dy gjëra: njëra ka të bëjë me gjenialitetin e Muhamedit (a.s.), me aspektin e tij njerëzor pas meditimit të gjatë, aftësinë për të gjykuar drejt dhe për të parashikuar forcën e ardhshme ekonomike-politike, pavarësisht faktit se myslimanët ishin ende forcë në ikje, ndërsa gjëja tjetër është mendjemprehtësia e Surakës (ndonëse kundërshtar) që të mendonte drejt dhe të vlerësonte perspektivën e forcave politike-ushtarake.<sup>5</sup>

### HIXHRETI NË ABISINI – VENDIM STRATEGJIK

(Nuk qe urdhëruar me shpallje)

Kjo shpërngulje ndodhi në vitin e pestë të peygamberisë, pas torturimeve të rënda që myslimanët po përjetonin nga ana e kurejshitëve në Mekë. Me iniciativën e tij, Muhamedi (a.s.) dërgoi në Abisini 83 meshkuj dhe 19 femra, të cilët pastaj i ktheu vetëm pas marrëveshjes në Hudejbije, teksa ndërkohë për bartësit e Islamit kishte kaluar rreziku i zhdukjes nga ana e kundërshtarëve. Muhamedi (a.s.) e studioi me vëmendje këtë mundësi dhe vendosi që ata të dërgoheshin atje për t'iu kursyer jeta, si dhe me qëllim që ata të mund ta vazhdonin misionin Islam, në rast se myslimanët e Mekës apo një pjesë e tyre do të vdisnin.

Dallohen disa momente strategjike të vendimit të Muhamedit (a.s.):

#### 1. Zhvendosja e potencialit njerëzor dhe material në disa

3. Për ixthihadin dhe për perceptimin e drejtë të Kur'anit dhe Hadithit shih: Ibrahim Džananovic, *Idžtihad u prva cetiri stoljeca islama*, Sarajevo, 1986, fq. 29 e tutje.

4. Muhammed Husejn Hejkel, *Zivot Muhammeda a.s.*, Sarajevo, 1425 h./2004, fq. 463 e tutje.

5. Muhammed Husejn Hejkel, op. cit., fq. 238. Martin Lings, *Muhammed s.a.s.v.*, Sarajevo, 1996, fq. 370 e tutje.

vende në rast rreziku;

2. Hulumtimi i truallit të frytshëm dhe të fortë për përhapjen e Islamit;

3. Thyerja dhe demoralizimi i disa familjeve kurejshite, duke ua larguar disa nga bijtë e tyre në vende të tjera, me besim të ri.<sup>6</sup>

### HIXHRETI, PËRGJEGJËSI FETARE DHE HISTORIKE

Gjendje të ngjashme kemi edhe me hixhretin në Medinë, i cili ndonëse si akt ishte i urdhëruar, mënyra e shpërnguljes dhe hollësitë e tjera mbeten në planin e në vlerësimin individual, me gjithë çka nënkupton kjo: frikën, trembjen, lodhjen, ikjen, fshehjen etj.

Kështu, sipas këshillës së Xhibrilit, Muhamedi (a.s.), e lë Aliun (r.a.) në shtratin e tij, që t'i vononte kundërshtarët, meqenëse shtëpia e tij ishte ditë e natë e rrethuar dhe e ruajtur me kujdes nga armiqtë. Nga shtëpia doli gjatë ditës, në drekë, kur bënte vapë e madhe dhe kur ishte më pak e mundur të vihej re. Shkoi drejt shtëpisë së Ebu Bekrit (r.a.), nga dera dytësore, duke iu shmangur vrojtimit të kundërshtarëve. Me Ebu Bekrin udhëtoi drejt shpellës Theur, e cila gjendej në jug të Mekës, në drejtimin e kundërt të Medinës, duke pasur si qëllim mashtrimin e ndjekësve të tyre. Ndenjën disa ditë në shpellën Theur, rreth 5 milje (rreth 8 km) larg Mekës. Esmaja, e bija e Ebu Bekrit vinte dhe u sillte ushqime. Ebu Bekri ngarkoi të birin e tij, Abdullahun që të merrte informacione nga kurejshitët dhe pastaj të vinte e t'i njoftonte në shpellë. Këtë punë mund ta bënte edhe Esmaja, por ata dëshironin të kishin lajme të sigurta. Pejgamberi (a.s.) e porositi bariun e Amir bin Fahirit që kopenë e dhenve ta drejtonte në rrugën ku kalonte Esmaja dhe Abdullahu, me qëllim që t'u mbulon-te gjurmët. Megjithë bindjen se Allahu do t'i mbronte duke bërë rrjetin e merimangës, Muhamedi (a.s.) me Ebu Bekrin nuk e shpërfillën planin e tyre. Kështu dolën nga shpella me udhërrëfyes të paguar, jomuslimanë por besnikë, me dy kuaj, që ata t'i udhëhiqnin rrugëve më më pak të shkelura deri në Medinë, ashtu që të humbisnin gjurmët dhe të arrinin me sukses deri në vendin e caktuar.<sup>7</sup>

### NË VEND TË PËRMBYLLJES

Shembulli i Muhamedit (a.s.), i Omerit (r.a.), por edhe i brezit të parë, është mënyra praktike se jetësimi i Islamit në histori i imponon njeriut edhe përfilljen e ndihmës që Krijuesi ia ka dhënë njeriut për të jetuar më mirë, më me lehtësi dhe në pajtim me ligjësitë e Zotit në gjithësi.

Të kuptuarit e drejtë të begative, do ta bëjnë njeriun sundues dhe fitues, sepse ai është "halif në tokë".

6. Muhammed Husejn Hejkel, op. cit., fq. 176, 183 e të tjera.

7. Muhammed Husejn Hejkel, op. cit., fq. 176 e tutje. Martin Lings, *M - hammed (s.a.s.v.)*, Sarajevo, 1996, fq. 146 e tutje.



# Të ushqyerit e pakët sipas Mevlanës

*Prof. dr. Ethem Shebexhiollu*

**P**lani gastronomik i përcaktuar nga Islami në boshtin kuranor ka në qendër të ushqyerit e pakët. Manifestimi hyjnor që na është paraqitur nëpërmjet Kuranit nga Krijuesi i gjithësisë merr formë të prerë nga këto shprehje:

**“Hani, pini dhe mos e teproni.”**<sup>1</sup> Në tërësinë kurane, kjo përkon me ajetet e mëposhtme të sures Rrahman për të krijuar një ekuilibër të përgjithshëm kozmik:

**“Allahu e përcaktoi kufirin. Mos e prishni atë!”**<sup>2</sup>

Se si do mundësohet ky ekuilibër në mënyrën e të ushqyerit, kjo na është treguar me fjalë dhe me vepra nga i Dërguari i Allahut. Ai ishte një Kuran i gjallë.

*Një të tretën e stomakut besimtarët duhet ta mbushin me ushqim, një të tretën me ujë, ndërsa pjesën që mbetet me dhikër!*<sup>3</sup>

Kuptimi i këtij hadithi është të ngrihesh gjysmë i uri-

1. A'raf- 31.

2. Rrahman- 7-8.

3. Zühd 47, (2381); İbn Mâce, Et'ime 50, (3349).

tur nga sofrë. Pra, kur të ulemi në tryezë për të ngrënë, duhet ta bëjmë nijet me zemër që të ngrihemi paksa të uritur nga tryeza. Fakti që në hadith është krijuar një lidhje e drejtpërdrejtë mes stomakut të boshatisur dhe të kujtuarit e Allahut, tregon edhe të vërtetën që fshihet në të ushqyerit e pakët. Fakti që Pejgamberi ushqej pak, që edhe oxhaku i shtëpisë së tij nuk nxirrte shpesh tym për të përgatitur ushqimin, fakti që ai lidhte gurë në bark nga uria, janë gjëra që tashmë dihen prej të gjithëve. Nëse nisemi nga parimet etike, duhet t'i shmangemi ngopjes si bashkësia e një Pejgamberi që lidhi miqësi të ngushtë me urinë.

Edhe ashabet ishin të tillë. Hanin pak. Një doktor i dërguar në Medinë nga Perandori i Bizantit, Heraklis, kur vuri re që myslimanët nuk sëmureshin shpesh, ishte detyruar të kthehej në Stamboll. Kur perandori e kish pyetur në lidhje me arsyen e një dukurie të tillë, ai që përgjigjur: Ata ngrihen të uritur nga tryezat!.

Vetë sufitetë që pasuan rrugën e Kuranit dhe të Profetit e organizuan jetën e tyre mbi këtë parim, në mënyrë që

gjatë gjithë jetës të shprehnin kujdes ndaj ushqyerjes së tepërt. Nëse e ilustronim me një shembull, mund të përmendet këtu “Guri i zi” i ekspozuar në Muzeun Etnografik të Haxhi Bajram Veliut. Ky i fundit kishte një gur të zi, të cilin e përdorte për të shtypur urinë që e kish kapluar në bindje të synetit, gur të cilin e lidhte për bark që të bënte trysni mbi urinë sikurse vetë Pejgamberi (a.s.).

Në vija të përgjithshme, ana epike e njeriut ose shpreh pjesën kafshërore që e ndjen të nevojshme çështjen e edukimit, ose natyrën e tij primitive. Njeriu e ka të nevojshme që nëpërmjet urisë ta vërë nën kontroll këtë prirje. Si rezultat, trupi fiton lehtësinë dhe përqëndrimin e duhur për të zbuluar sekretin që fshihet në të.

Dhe, për të fituar këtë formë, njeriu i duhet t’i plotësojë në mënyrë të mjaftueshme nevojat e tij themelore dhe të tregohet i qëndrueshëm ndaj kënaqësive epike, me vullnet dhe bindje të plotë, gjë e cila shihet si e pashmangshme për të. Në këtë mënyrë, njeriu nis të vërë re shtrembërimet që sjellin dëshirat epike në mendjen dhe në shpirtin e tij.

Nëse i rikthehem sërish çështjes së të ushqyerit të pakët, përmendim faktin se Mevlana, pohon, se e kish nisur këtë rrugë që në moshën shtatëvjeçare. Kur erdhi në moshën shtatëdhjetëvjeçare vijonte ende të hante pak, të flinte pak dhe të fliste pak. Kur e pyetën se pse vijon akoma në këtë rrugë me gjithë moshën e thyer që kishte, qe përgjigjur se nefs i është në çdo moment në kurth dhe për rrjedhojë duhet t’i bindet urisë që të mund ta mbante nën kontroll.

Me të vërtetë, një ditë në hamam rrethi i tij i ngushtë, me të parë se nga dobësimi i tepërt po i shfaqeshin kockat dhe trupi i tij kish marrë një ngjyrë si në të verdhë, u mërzitën shumë.

Transmetohet se shumë herë, kur Mevlana vinte në shtëpi dhe e shoqja i thoshte se s’kishin gjë për të ngrënë, atij i shfaqej në fytyrë një buzëqeshje e ëmbël dhe më pas thoshte: -Faleminderit Zotit, shtëpia jonë i ngjaka shtëpisë së Pejgamberit!

Edukimin e anës kafshërore të njeriut, Mevlana e përqa me shembullin e edukimit të një qeni gjuetie. Siç dihet, qentë e gjuetisë nuk ushqehen shumë, por edhe nuk lihen të uritur kur dërgohen për gjueti. Kur nuk ngopen



plotësisht nuk shkojnë në gjueti, por edhe kur janë të uritur mund të hanë gjahun. (Mesnevi, I, b. 2873/7)

Le ta qartësojmë edhe më mirë idenë e Mevlanës lidhur me të ushqyerit e pakët, nëpërmjet dy shembujve nga jeta e tij.

Një herë, në një vend ku ishin të ftuar të gjithë dijetarët dhe shejhët, u përgatit ceremonia e semazerëve dhe më pas edhe një tryezë e përkryer. Një nga vezirët e pranishëm, Pervane Muinuddin bën me shenjë të përgatitet një pilaf brenda të cilit do të vendosej një qese plot me flori dhe kjo do t’i jepej më pas Mevlanës.

Pervane Muinuddin e këshillonte me këmbëngulje Mevlanën:

- Ky ushqim është bërë me para hallalli. Ju lutem urdhëroni dhe hajeni! (Në mënyrë që të hante pilafin për t’u dalluar florinjtë.)

Mevlana e vuri re një situatë të tillë dhe iu drejtua Pervanes me fjalët:

– Vendosija e një ushqimi të tillë para njerëzve të Zotit është jashtë normave të fesë sonë, por edhe jashtë normave të farës njerëzore. Faleminderit Zotit që na ka mësuar t’u qëndrojmë larg këtyre qeseve, duke mos na bërë



t'ua ndejmë nevojën atyre duke na prerë edhe hovin ndaj tyre.

Me këto fjalë ngrihet në këmbë dhe nis semaverin, ndërsa më pas këndon këto vargje:

*Për Allah! Nuk lakmoj as yndyrën e as ëmbëlsirën,  
As qeset e floririt e as rrezatimet e kësaj natyre.*

Me të mbaruar semaveri, Pervane Muiuddin i kërkoi ndjesë Mevlanës dhe u largua. (Eflaki, Menakibu'l Arifin, v I, fq 2007-8)

Në një vend tjetër, ku ishin të ftuar, Emir Pervane këmbënguli në mënyrë të tepruar që Mevlana të merrte pak nga ushqimi i këndshëm. Por Mevlana reagoi ashpër ndaj tij duke i thënë:

- O Emir Muinuddin! Nuk të vjen zor nga vetja? Më detyron të shkoj në tualet!

Dhe më pas këndoi këtë ode:

*Ti ha gjërat e yndyrshme dhe të ëmbla që do jenë ushqim  
jo për materien, por për shpirtin tënd,  
Që krahët të rriten dhe të mësosh të fluturosh,  
Gjërat e yndyrshme dhe të ëmbla materiale janë të lejuara,  
Por të gjitha këto në një natë bëhen vetëm ndyrësi.*

Ai thekson rëndësinë që ka përpunimi i shpirtit, i kësaj strukture të pavdekshme të personalitetit të njeriut, duke e nxitur atë drejt ushqimeve shpirtërore. Duke vënë në dukje se ushqimet materiale që janë të dëmshme për të përkohshmen konsumohen brenda një nate të vetme, hedh një rreze drite edhe në përkujdesjen që duhet të tregojmë për t'u shmangur ushqimit të tepërt. Pasi nuk duhet harruar se çdo gjë merr vlerë sipas rezultatit.

Mevlana thotë se "Të ushqyerit e shumë të dëmton trupin e njeriut, por në të njëjtën kohë ul kapacitetin e konceptimit shpirtëror, prandaj dhe uria është ushqim i robërve të Allahut." (Mesnevi, V, b. 1745-7; V b. 2846)

Përballja me hilet e shejtanit arrihet nëpërmjet ushqimit të pakët siç e shpreh edhe Mevlana me mendimin e tij filozofik.

*Një njeri me barkun bosh nuk mund të pandehë se është zot,*

*Zjarrit të egos së tij i mungojnë drurët,  
Një bark bosh është burgu i shejtanit,  
Shejtanët aty bërtasin e zhurmë bëjnë.*

Mevlana është i mendimit se nëse njeriu i konsumon më shumë se ç'duhet ushqimet që janë prodhime të tokës, i ka thurur anës shpirtërore një perde toke, e kështu ka verbuar syrin e zemrës:

*Kjo gojë ha të njëjtën dhé,  
por e ha atë në forma të ndryshme,  
zbukuruar me shumëllojshmëri ngjyrash,  
Bir! Ky qebap, ky sheqer, kjo pije,  
Është një dhé i zbukuruar, i lyer,  
Kur ti hash ato dhé dhe të të bëhen mish e lëkurë,  
Hyjnë në ngjyrën e mishit, por e vërteta e tyre është prej dheu,  
Në fillim nga dhéu bëhen gjëra të ndryshme,  
Më pas të gjitha shpërbëhen, kthehen të gjitha në dhé.*

Përmbledhtazi, mund të themi se sipas Mevlanës, njeriu e ka të nevojshme t'i shmanget ushqimit të tepërt për të edukuar egon e tij, kuptohet me kushtin e ruajtjes së ekuilibrit. Njeriu nuk duhet ta teprojë as me urinë e as me ngopjen. Allahu na i ndriçoftë zemrat me urinë Muhamedane.

# Ai që dëshirën e bëri zot

*Ma. Zymer Ramadani*

**P**ër fat të keq, në shumicën e rasteve, me apo pa qëllim, shumë nga krijesat njerëzore gabojnë në marrjen e vendimeve në lidhje me ndonjë gjë që mund të presin apo të shpresojnë. Në çaste të vështira, ata harrojnë pothuajse gjithçka, madje ndonjëherë edhe vetveten. Veç kësaj, të shtyrë nga pesimizmi e dhimbja që kalojnë, ata drejtohen nga rruga, që i çon në humbje, drejt ndonjë shprese të kotë apo kah një humnere të pafund për të kërkuar ndihmë e shpëtim. Jo gjithkush mund t'i ndjekë këto rrugë, por po ashtu jo gjithkush mund t'i hetojë problemet për një çast. Kështu që këta njerëz harrojnë diçka edhe më të madhe se këto që i përmendëm, harrojnë shpresën e vërtetë dhe të vetme, cakun e pranimit të kërkesave, vendin e prehjes shpirtërore... Pra, ata harrojnë krijuesin e tyre, Allahun Fuqiptotë, Krijuesin e gjithë asaj që gjendet në këtë horizont që syri ynë mund ta shohë, por edhe në atë që nuk mund ta shohë. Allahu (xh.sh.) në Kuranin Fisnik na ka treguar për të gjithë llojet e njerëzve, mënyrat e sjelljeve, besimet, bindjet, mashtrimet dhe gënjeshtat e tyre, pëlqimet, refuzimet, sinqeritetin dhe naivitetin e tyre etj. Ai, po ashtu na ka dhënë njohuri edhe për një karakter tjetër njerëzor që është ndoshta ndër më karakteret më të rrezikshëm. Është fjala për personin që harron krijuesin si Zot dhe për zot të vetin bën egon, epshin, dëshirën apo pasionin e tij.

Ky karakter njerëzor ka zhveshur karakterin e krijesës-njeri, ka nënçmuar jetën dhe sjelljen e krijesave të tjera njerëzore. Ky karakter mbase nuk mund të quhet më karakter njerëzor, sepse tashmë ka rënë nën nivelin e një kafshe dhe të një krijese pa intelekt. Këtë karakter njerëzor, Allahu (xh.sh.) e përmend në mënyrë të veçantë, posaçërisht në Suren Furkân, sure e cila siç vërehet edhe nga emri ka kuptimin e ndarjes dhe të dallimit nga të mirat dhe të këqijat. Në këtë rast ku del në pah një karakter njerëzor që ka tejkaluar kufijtë e të qenit njeri, Allahu (xh.sh.) thotë:

***“A e ke parë ti atë, që për zot e çmon epshin e vet, a mos do t’i bëhesh ti atij mbrojtës? A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë ose kuptojnë? Ata nuk trajtohen ndryshe, por vetëm si kafshë, bile janë edhe më të humbur nga e vërteta”.*** (Furkan, 25/43-44)

Përmes këtij ajeti, Allahu (xh.sh.) i drejtohet Muhamedit (a.s.), por edhe të gjithë njerëzve të tjerë, që kanë moral e karakter, duke u thënë se ka njerëz që edhe pse shirkun – bërjen shok Allahut e fshehin në zemrat e tyre, ata vazhdojnë me vepra të ndotura. Këtë çështje, Allahu na e tregon në formë pyetëse, por pas pyetjes pason përgjigjja se në mesin tuaj ka njerëz të tillë që kanë kaluar jashtë kufijve njerëzorë. Faktikisht, këta janë bërë robër e skllëvër të pasioneve të tyre, edhe pse mund të kenë ndonjë pozitë apo pasuri, prapëseprapë skllavëria e tyre vazhdon të jetë në fuqi për sa kohë që ecin drejt egos mashtruese të epshit, drejt dëshirës dhe rrugës që i largon nga Krijuesi e nga vetvetja e tyre.

Në këtë rast, ajeti kritikon edhe ata besimtarë që në një formë thonë se “besuam”, por duke vazhduar në këtë mënyrë ata humbin besimin e tyre dhe bëhen robër të egos së tyre. Ndjekësi i egos së tij ka bërë shirk – i ka bërë shok Allahut njëlloj si ai që adhuron një put apo diçka të ngjashme. Egoja në këtë rast, është një ndjenjë që e çon njeriun drejt një vendi të papërcaktuar; ajo e shndërron atë në një kafshë, që shëtit në një hapësirë dhe nuk e di cakun e vet, apo si bagëti që bariu e shpie nga të dojë. Për fat të keq ajo dele nuk e di se i zoti po e dërgon në kullota, apo në ndonjë vend për ta prerë. Pikërisht në këtë mënyrë, karakteret e njerëzve të tillë janë krejtësisht në humbje; ata as nuk mendojnë e as nuk janë në gjendje të mendojnë. Bota e tyre është një terr në të cilin nuk depërton drita. Këta njerëz, Allahu (xh.sh.) i krahason me kafshët e madje shkon edhe më tutje, duke thënë: ***“...si kafshë, bile janë edhe më të humbur nga e vër-***



**teta**". Ata kanë rënë në një nivel më të ulët se ato. Por kafsha, edhe pse nuk i është dhënë ndonjë obligim siç i është dhënë njeriut, ajo përsëri e kryen me përpikmëri detyrën e vet. Ndërsa njeriut, në dallim nga kafshët i është dhënë intelekt, por fakti se ai nuk mundi ta vinte në funksion këtë dhunti të Allahut, është diçka që të bën të habitësh më shumë me pozitën e kësaj shkalle njerëzore. (Tefh'imu'l-Kuran, Mevdudi, komenti i ajetit 43-44, Surja Furkan)

Në lidhje me këtë sëmundje të rëndë, në Kuranin Fisnik edhe në disa ajete tjera Allahu e ka cekur dobësinë dhe sëmundjen e nefsit, duke i nënçmuar dhe duke treguar karakterin e dobët të kësaj shkalle njerëzore: **"E nëse ata nuk të përgjigjen ty (O Pejgamber), atëherë dije se ata ndjekin vetëm dëshirat e veta, e kush është më i humbur se ai që duke pasur fakt prej Allahut, ndjek epshin e vet? S'ka dyshim se Allahu nuk udhëzon popullin zullum-qar"**. (Kasas, 28/50)

Transmetohet nga Ebû Hurejre se Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

*"Kur Allahu (xh.sh.) e ka krijuar xhenetin, i tha melekut Xhebrail:*

*-Shko dhe shikoje atë.*

*Xhibrili shkoi dhe e shikoi atë, u kthye dhe tha:*

*-Pasha Ty o Allah! Askush që dëgjon për xhenetin dhe pasurinë e tij nuk do të mbesë pa hyrë në të.*

*Allahu (xh.sh.) e mbushi xhenetin me orendi që nuk i pëlqejnë egos – nefsit, pastaj tha:*

*-Jâ Xhibrîl! Shko dhe shikoje atë.*

*Xhibrili (a.s.) shkoi, e shikoi atë dhe tha:*

*- O Allah, falë madhërisë sate, kam frikë se askush nuk mund të hyjë në të.*

*Kur Allahu (xh.sh.) e krijoi xhehenemin tha:*

*-Jâ Xhibrîl ! Shko dhe shikoje atë.*

*Xhibrili (a.s.) shkoi, e pa dhe tha:*

*-O Allah, betohem në madhërinë tënde, askush që dëgjon për të nuk do të hyjë aty.*

*Allahu (xh.sh.) e mbushi atë me gjëra që i pëlqejnë nefsit, pastaj tha:*

*-Jâ Xhibrîl! Shko dhe shikoje atë.*

*Xhibrili (a.s.) përsëri shkoi për ta parë dhe kur u kthye tha:*

*-O Allah, pasha sundimin tënd, kam frikë se të gjithë do të hyjnë në të dhe askush nuk do mbetet". (Ebu Davud, Sunnet, 21, 22, Tirmidhi, Xhennet, 21)*

Nga thënia e Pejgamberit (a.s.) vërejmë se për njeriun janë krijuar dy mundësi, dy zgjedhje apo alternativa: nëse njeriu zgjedh atë që ia ka ënda nefsit, ai do të përfundojë në një cak të humbur, por nëse zgjedh atë që është në favor të jetës, shëndetit, besimit dhe interesit të tij, padyshim se do të futet të listën e atyre për të cilët Allahu (xh.sh.) e ka krijuar xhenetin me bukuritë e tij. Në shumë raste flitet për liritë dhe të drejtat e njeriut, por në fakt është lënë prapa liria e tij shpirtërore, ngase nuk mund të llogaritet se jeton në liri ai i cili ecën sipas dëshirës së tij drejt një morali dhe sjelljeje të gabuar. Nuk është liri ajo që e bën njeriun të varur nga një gjë, ajo që ia shkatërron moralin dhe jetën. E si mund të quhet liri ajo me të cilën njerëzit e ndryshëm bien viktimë?

Hadithin që cekëm, në mënyrë më të theksuar i jep kuptim edhe ajeti tjetër kuranor ku Allahu (xh.sh.) thotë: **"Dhe Ne, i sqaruam atij për të dy rrugët"**. (Beled, 90/10) Këto dy rrugë janë e drejta që të shpie në xhenet, me kushtin që t'i përmbahemi programit të Kuranit dhe Pejgamberit (a.s.) dhe e gabuara, e cila shpie në një humnerë dhe zjarr, shkak i së cilës është largimi nga rruga e Allahut (xh.sh.) e Suneti i Muhamedit (a.s.). Më tej Kurani vazhdon të cekë mënyrat dhe llojet e egos së njeriut, disa prej të cilave e nxisin njeriun në vepra të mira dhe disa të tjera i bëjnë gjithmonë presion që të jetë rob i egos së tij. Këto lloj egosh e kanë kapur për gjuhe njeriun dhe e drejtojnë vetëm në gjëra të shëmtuara. Njeriu është krijuar në mënyrë të atillë, që të anojë nga pasionet dhe dëshirat e egos, ndërsa shpirti i tij është i prirur të anojë nga gjërat e këqija që përmbledhen në termin **"nefsu'l-emmâre"**. Për këtë lloj nefsi Allahu thotë: **"Unë nuk e shfajësoj veten time, pse epshi është shumë nxitës për të keqen, përveç atë që ka mëshiruar Zoti im, se Zoti im është që fal e mëshiron"**

*shumë*". (Jusuf, 12/53) Një faktor tjetër që nxit kryerjen e veprave të këqija është fakti se shumë nga njerëzit që janë në dyshim apo që nuk besojnë në jetën tjetër, mendojnë se kjo botë është gjithçka dhe se këtu duhet vepruar. Në këtë mënyrë ai bie shumë lehtë në mëkat. Sipas terminologjisë kuranore ky quhet "*nefsu'l-levvâme*". Përveç kësaj, është edhe një lloj egoje tjetër që i hedh poshtë dëshirat dhe pasionet e kota të njeriut. Quhet "*nefsu'l-mutmeinne*" – pra i edukuar, i qetë dhe që dëshiron të arrijë kënaqësinë e Allahut: "**O ti shpirt i bindur plotësisht! Kthehu te Zoti yt i vetëkënaqur e i pranuar!**" (Fexhr, 89/27-28). Ka pak njerëz që i përmbahen rregullave të kësaj bote, apo kush-tetutës hyjnore të zbritur nga Allahu.

Një nga gjërat që e trazon, që e mundon njeriun dhe që e zbratë gjendjen e tij shpirtërore në nivel të ulët e të dobët është edhe i ashtuquajtur i mëkat i madh i fshehur. Siç u cek edhe më lart, ky është mëkat më i rrezikshëm se adhurimi i putave. Nxitës i këtij adhurimi të fshehtë është pa dyshim *nefsi* – egoja. Sipas një hadithi tjetër të transmetuar nga Ebu Hurejre (r.a.), i dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.) thotë: "*Xhehenemi është zburuar me gjëra që i pëlqejnë nefsit, ndërsa xheneti është mbushur me gjëra që nuk i pëlqejnë atij*". (Muttefekun alejhi)

E si mund të mbrohet njeriu nga këto mashtrime, meqenëse ndjekja e rrugës së nefsit e shkatërron dhe e zhvesh njeriun nga karakteristikat e tij si qenie njerëzore? Dihet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë se për çdo sëmundje ka ilaç, përveç pleqërisë dhe vdekjes... Natyrisht, metoda e shërimit të këtyre veseve të këqija njerëzore krahas terapisë së mjekut, është përdorimi i ilaçit më të mirë: me lutje nga Kurani dhe nga suneti i Pejgamberit (a.s.). Allahu (xh.sh.) i përgëzon personat që mbrohen nga këto kurthe, me këto fjalë: "**E kush iu frikësua paraqitjes para Zotit të vet dhe ndaloi veten prej epsheve, Xheneti është vendi i tij**". (Naziat, 79/40-41) Natyrisht, ata që kanë besimin e sinqertë në Allahun dhe në atë që ka zbritur Ai, do të mbrohen nga ky kurth. Në këtë rast, rol të madh luan edhe besimi në botën tjetër, besim ky që e bën njeriun të mbrohet prej të ligave. Duke llogaritur se një ditë do të paraqitet para madhërisë së Allahut, ai turpërohet dhe ka frikë nga kryerja e një veprave të shëmtuar. Ky besimtar është i bindur edhe në faktin se Kurani është shërues i veseve dhe i problemeve shpirtërore, duke u bazuar edhe në lutjet e Pejgamberit (a.s.): "*O Allah, bëje Kuranin pranverë të zemrave tona, ilaç për gjokset tona, shërim për jetën tonë*." etj. Po ashtu duhet pasur gjithmonë në mendje edhe lutja tjetër që Pejgamberi (a.s.) e ka përsëritur shpesh: "*... Zoti im! Kërkoj mbrojtje nga Ti edhe prej nefsit që nuk ngopet...*"

Kur në momentet më të vështira të hapit më të rëndësishëm të tyre myslimanët triumfuan në ekspeditë, gjatë

kthimit të tyre nëpër shtëpia, Muhamedi (a.s.) iu është drejtuar duke i porositur se, nëse ekspedita ka mbaruar, pas kësaj ka filluar një ekspeditë dhe një luftë tjetër edhe më e rëndësishme, e cila është lufta kundër nefsit, egos. Duke e ditur se *nefsi* e humb njeriun nga jeta e tij, Pejgamberi (a.s.) e ka konsideruar këtë luftë në mënyrë të theksuar si "*Xhihadi i Madh*". Nga Xhabir ibni Abdillahi transmetohet se pas kthimit nga ekspedita, Pejgamberi (a.s.) iu është drejtuar luftëtarëve me këto fjalë: "*U kthym shëndosh e mirë, tani nga xhihadi i vogël shkojmë drejt një xhihadi më të madh!*. Ata e pyetën me habi: "*Cili është xhihadi më i madh, o Pejgamber?*". Ai u përgjigj: "*Angazhimi dhe lufta e robit me nefsin- egon dhe vetveten e tij*". (Rijadus-Salihin, Kapitulli mbi xhihadin) Në këtë mënyrë e përkufizoi këtë problematikë Pejgamberi (a.s.), sepse në këtë kënd të njeriut është vështirë të depërtojë dikush tjetër, përveçse nëse ai dëshiron të mbrohet nga këto gabime dhe kjo sëmundje. Duhet ditur se rolin më të madh këtu e ka djalli i mallkuar, i cili i fut dyshime njeriut, duke i zburuar gjërat e gabuara për ta dobësuar imanin e tij. Dobësimi i imanit të njeriut ka lidhje të drejtpërdrejtë me egon e tij, që bën hapin e parë drejt të ligave. Për këtë arsye, me fillimin e çdo pune edhe njeriu kërkon nga Allahu një mbrojtje të sinqertë, në mënyrë që djalli të mos ndërhyjë në punën e tij, që të mos fusë dyshime në mendjen e tij dhe të mos shkaktojë armiqësi mes tij dhe zemrës së vet. Ndoshta mesazhi i hadithit është edhe ky: që shejtani i mallkuar të mos ndërhyjë në mes njeriut dhe vetes së tij.

Me sinqeritet dhe besim të plotë në Allahun (xh.sh.), në atë që i është zbritur Pejgamberit (a.s.) dhe me të gjitha porositë e Muhamedit (a.s.), njeriu do të arrijë të shpëtojë nga të gjitha kurthet e djallit. Nëse ai fundoset në humnerë atëherë kur pason djallin dhe i përmbahet dëshirave të nefsit, duke u bërë kështu më i dobët se kafsha, sipas shprehjes kuranore, në të kundërt nëse njeriu kryen vepra të mira arrin në një nivel të lartë tek Allahu. Me kryerjen e veprave të mira, ai mund të kalojë edhe mbi pozitën e engjëjve dhe në këtë mënyrë do të jetë nga më të dashurit e Allahut (xh.sh.).

Allahu (xh.sh.) na mundësoftë që ta kryejmë programin njerëzor, të mos mbetemi viktimë të djallit dhe të nefsit, të mos na drejtojë pasioni në vepra e të harrojmë Allahun (xh.sh.), po për të gjitha mundimet dhe angazhimet që bëjmë në këtë botë të na shpërblejë me xhenet, me këtë vend që është përgatitur vetëm për bamirësit, adhuresit e Allahut dhe për ata që mbrohen nga çdo e ligë dhe çdo ndalesë. Siç u përmend edhe në hadithin e parë, xheneti është aq i gjerë, sa që kur Xhibrili (a.s.) e pa u habit dhe mendoi se gjithkush do të hyjë në të, por kur e pa edhe zjarrin – xhehenemin, kërkoi mbrojtje tek Allahu dhe tha se kishte frikë se gjithkush do të ishte lëndë djegëse e tij.





# STRUKTURA E JETËS FETARE NË PERIUDHËN E MUHAMEDIT (A.S.)

*Ma. Abdylkader Durguti*

Në rend të parë duhet kuptuar se misioni i Muhamedit (a.s.) është vazhdimësia e pejgamberëve të tjerë që ishin para tij. Prandaj, Muhamedi (a.s.) është dërguar për ta përmirësuar popullin e tij në besimin e tyre thelbësor, në besimin e paraardhësve të tyre, në përmirësimin e vlerave morale, shoqërore dhe jetësore. Këto përmirësime Muhamedi (a.s.) i bëri në mënyrën dhe metodën *graduale*, që ishte metoda më efikase për të arritur suksesin. Për të formuar strukturën e jetës fetare, hapi parë ishte shkëputja e lidhjeve nga besimet e devijuara.

## LARGIMI NGA ZAKONET DHE TRADITAT E INJORANCËS

Hapi i parë i jetës fetare ishte shkëputja e lidhjeve me traditat dhe besimet e devijuara nga koha e injorancës. Natyrisht që Profeti (a.s.) do t'i jepte fund besimeve të devijuara dhe adhurimeve të kota që ishin të pranishme nga koha e injorancës, duke i zëvendësuar me parimet e besimit Islam.<sup>1</sup> Përveçse përmirësoi besimin, ai përmirësoi edhe zakonet e traditat që u binin ndesh parimeve Is-

1. Enbija, 21/25; Nisa, 4/48.

lame, ngase besimtari është i obliguar që besimi, adhurimi dhe morali i tij të jenë brenda kornizave e parimeve Islame. Prandaj, Profeti (a.s.) ka këmbëngulur në thirrjen për largim nga besimet e devijuara, nga bestytnitë e ndryshme dhe është përqendruar në bazat e besimit Islam.

Në lidhje me përmirësimin e besimit të devijuar të idhujtarëve mund të përmendim shembullin e lutjeve të trashëguara gjatë pelegrinazhit të tyre në haxh apo umre. Duke u lutur: “Urdhëro o Allah, urdhëro. Ti je i Pashoq. Ke vetëm një shoq (partner). Edhe ai është nën furnizimin tënd. Ti je sunduesi tij edhe ndaj asaj që zotëron ai.”<sup>2</sup> Sipas një transmetimi nga Ibn Abbasi (r.a.), Profeti (a.s.) iu tërhoqi vërejtjen besimtarëve ndaj lutjeve të idhujtarëve, duke i zëvendësuar me “Të Përgjigjem O Allah, Të Përgjigjem O Allah Ti je i Pashoq, vetëm Ty të përgjigjem, falënderimi të takon Ty, të gjitha begatitë dhe pasuria janë Tuat, Ti je i Pashoq.”<sup>3</sup>

Ndërsa përsa i përket zakoneve, traditave dhe besimeve të trashëguara nga injoranca, të cilat nuk kishin asnjë bazë

2. Ibn Kelbi, *Kitabu'l-Esnâm*, (Putlar Kitabı), Përkth. Beyza Düşüngen, Ankara, 1969, 27.

3. Muslim, “Haxh”, 19.

themelore të islamit, por ishin diskredituar para popullit, mjafton të përmendim ditën kur Profetitet (a.s.) i vdiq djali i tij me emrin Ibrahim, ditë në të cilën ndodhi edhe eklipsi. Kësisoj, sipas një besimi të tyre, njerëzit e ndërlidhën eklipsin me vdekjen e Ibrahimit. Kurse Profetitet (a.s.), në lidhje me këtë tha: *“Dielli dhe hëna nuk errësohen me vdekjen e ndonjë njeriu. Sa herë të shihni që ndodh eklipsi, kryeni falje derisa eklipsi të ketë mbaruar.”*<sup>4</sup>

### BESIMI NË ALLAHUN (XH.SH.)

Një prej arsyeve kryesore pse koha para shpalljes është quajtur “koha e injorancës”, është se ishte përhapur adhurimi me të madhe ndaj idhujve, pemëve, gurrave, varreza-ve etj. Secili nga këto formonin një formë të adhurimit të veçantë, por që të gjitha ishin mëkat.<sup>5</sup> Prandaj, të gjithë që u futën në Islam Profetitet (a.s.) i urdhëroi të dëshmonin -Kelime-i Tevhid, Kelime-i Shehadet- në njëshmërinë e Allahut (xh.sh.), me qëllim largimin nga idhujtaria.<sup>6</sup> Pikënisja e parë, apo shkalla e parë e Islamit është të besohet në monoteizmin apo në njëshmërinë e Krijuesit suprem, i Cili nuk ka rival apo ortak. Besimi Islam është formuar mbi njëshmërinë e Allahut dhe është baza e besimit. Po ashtu, kundërshtimi dhe mosbesimi i këtij parimi, apo edhe të bashkangjiturit e diçkaje tjetër rreth asaj që e kundërshton njëshmërinë e Allahut, llogaritet si mëkati më i madh, të cilin Allahu nuk e fal derisa të bëhet pendim për mëkatin.

Baza e besimit në Allahun është përshkruar në suren Ihlas, që përshkruan momentin kur Kurejshitët e Mekës iu drejtuan Profetitet (a.s.) me pyetje të ndryshme për përshkrimin e Zotit, duke i thënë: “Muhamed, na e përshkruaj Zotin tënd. Vallë, a mos është Ai nga ari apo argjendi?” Pas këtyre pyetjeve zbriti kjo sure, e cila i drejtohet Muhamedit (a.s.) *Thuaj: (O Muhamed) “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”*<sup>7</sup>

Pas besimit në Allahun (xh.sh.) pasojnë adhurimet e lutjet që i duhet kushtuar vetëm Atij, si dhe për ndihmën që duhet kërkuar vetëm prej Tij. Andaj, gjatë emigrimit për në Medine, atëherë kur idhujtarët po i kërkonin për t’i mbytur, Profetitet (a.s.) e këshilloi Ebu Bekrin në shpellën Sevr, duke iu drejtuar me fjalët kuranore: *“Mos u mërzit,*



*(friko) se Allahu është vërtet me ne!”*<sup>8</sup>

### ADHURIM

Islami është fe që së bashku me besimin, i jep rëndësi të veçantë adhurimit. Adhurimi është pjesa e besimit në mënyrë praktike. Adhurimi është çështja më e rëndësishme e besimtarit, ngase ky është qëllimi i krijimit të tij, ashtu siç e përmend edhe Allahu (xh.sh.): *“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”*<sup>9</sup> Ndërsa Profetitet (a.s.) thekson rëndësinë e sinqeritetit në adhurim me fjalët: *“Allahu nuk shikon fytyrat dhe fizionomitë tuaja, por shikon zemrat dhe veprat tuaja.”*<sup>10</sup>

Adhurimi është mjete kryesor për formimin e jetës fetare të shoqërisë, prandaj Profetitet (a.s.) u përqendrua me këmbëngulje në dy pika kryesore:

E para, në formimin e xhematit: adhurimet kryhen në mënyrë kolektive jo në mënyrë individuale, në veçanti namazi. Kjo ngase bashkësia rrit besimin e individëve ndaj njëri-tjetrit dhe e bën të mundur që të shijohet në mënyrë maksimale kënaqësia ndaj adhurimeve.

E dyta, në vazhdimësinë: Profetitet (a.s.) përkujton rëndësinë e vazhdimësisë së veprës, edhe pse ajo mund të jetë e paktë, por përderisa të jetë e vazhdueshme ajo vepër llogaritet ndër veprat më të pëlqyera tek Allahu (xh.sh.).<sup>11</sup> Profetitet (a.s.) e konsideron të domosdoshme që të shfrytë-

4. Nesai, “Kusuf” 16.

5. Nisa, 4/60.

6. Ebu’l-Hasen en-Nedevi, *Rahmet Peygamberi*, f. 3.

7. Ihlas, 112/1-4.

8. Tevbe, 9/40.

9. Dharijat, 51/56.

10. Muslim, Birr, 33, 34; Ibn Hanbel, II/23, 60, 142.

11. Buhari, Tehexhud, 7.



zohen edhe shtëpitë e besimtarëve për adhurim, që të mos shndërrohen në vend varrezash.<sup>12</sup> Adhurimet të kryhen në mënyrë të matur dhe të kujdesshme<sup>13</sup>, sepse kujdesi në adhurim është shkak për prehjen shpirtit. Adhurimet të mos kufizohen vetëm me disa kohë të posaçme, apo të jenë vetëm zakon ditor, ngase qëllimi parësor i adhurimit është që njeriu të largohet nga veprat e shëmtuara dhe mëkatet.<sup>14</sup>

Të gjitha adhurimet, si: namazi, agjërimi, zekati dhe haxhi, zotërojnë specifika dhe drejtime të përbashkëta për formimin e jetës individuale e kolektive. Të gjitha këto adhurime që e pasojnë njëra-tjetrën formojnë një individ të pjekur dhe të shëndoshë në të gjitha pikëpamjet. Po ashtu, këto adhurime, kur bëhen në mënyrë kolektive formojnë një shoqëri unike të përbashkët, ndërsa për të tjerët ofrojnë ndihmë, solidaritet dhe sakrificë.

## ARSIMI DHE EDUKATA

Ndër karakteristikat më të rëndësishme të shoqërisë së Muhamedit (a.s.) janë arsimit dhe edukata. Rëndësinë e arsimit dhe të edukatës mund ta vërejmë me fillimin

12. Ibn Hanbel, II, 284.

13. Ibn Hanbel, III, 226.

14. Ankebut, 29/45.

e shpalljes së Kuranit, që fjala e parë e shpallur e të cilit ishte "Lexo",<sup>15</sup>. " ... andaj pyetni dijetarët e Librit, nëse nuk e dini (këtë),<sup>16</sup> "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?!"<sup>17</sup> Këto janë ajete që i nxisin besimtarët për të kuptuar vlerën dhe rëndësinë e diturisë e të edukatës.

Baza e arsimit dhe e edukatës në periudhën e Profetit (a.s.) ishte në Kuran dhe synet. Profeti (a.s.) i nxiste shokët në drejtim të arsimit, duke filluar nga Kurani dhe syneti i tij, ku thotë: "Më i miri prej jush është Ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson të tjerëve."<sup>18</sup> "Thënia më e mirë është Fjala e Allahut dhe udha më e mirë është ajo e Muhamedit (a.s.)."<sup>19</sup> Në këtë periudhë, arsimit dhe edukimi janë bërë nga këndvështrimi i Kuranit dhe synetit, që ishin të pandarë nga njëri-tjetri, plotësues ndaj njëri-tjetrit. P.sh.: në Kuran urdhëron faljen e namazit, ndërsa syneti futi e zbaton atë në mënyrë praktike. Kështu, namazi është për besimtarët një urdhër kuranor, ndërsa mënyra e të kryerit të këtij urdhri është udha e Muhamedit (a.s.).

Arsimi dhe edukimi, apo kërkimi i diturisë në periudhën e Profetit (a.s.), ishte çështje obligative e çdo besimtarit pa asnjë lloj diskriminimi gjinie apo race. Pejgamberi (a.s.) thotë: "Kërkimi i diturisë është farz (obligim) për çdo mysliman."<sup>20</sup> Obligimi ka karakter kolektiv e jo individual. Veç kësaj, për t'i stimuluar më shumë besimtarët në arsim dhe në edukim, ai i linte të lirë skllëverit e luftës së Bedrit nëse ata u mësonin 10 besimtarëve shkrim-lexim. Ndërsa kjo gjeneratë, përmes kësaj metode mori frytë, kur dolën në skenë persona që mësuan shkrim-lexim nga skllëverit. Midis tyre ishin edhe personat më të shquar të asaj periudhe si Abdullah b. Mes'ud, Muadh b. Xhebel, Ubej b. Ka'b, Ebu Derda, Ummu Varaka, Abdullah b. Amr b. el-As, Ebu Hurejre etj. Për ta nuk kishte vend të posaçëm për arsim, ngase duke qenë nismëtarë të këtij drejtimi, ata i shndërruan edhe shtëpitë e tyre në vende të arsimit dhe edukimit.

Kështu, metoda më efikase për të korrur sukses në thirrjen islame, është ajo graduale apo e doradorshme, pasi kjo është prej metodave që Profeti (a.s.) e ka praktikuar në shoqërinë e tij.<sup>1</sup>

1. Shkrimi është bazuar mbi punimin e M. Ali Kapar-it Hz. Peygamber'in Gerçekleştirdiği Toplum Yapısı ve Özellikleri.

15. Alak, 96/1.

16. Nahl, 16/43.

17. Zumer, 39/9.

18. Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 21.

19. Muslim, Cuma, 43.

20. Ibn Maxhe, "Mukaddime" 17.



# Paralajmërimet e Kuranit në lidhje me dëshirat dhe pasionet e egos

Murat Kaja

**E**goja e njeriut bashkë me devijimin e djallit të mallkuar i dëshiron më shumë gjërat haram se sa ato hallall. Gjërat e ndaluara dhe të shëmtuara janë më të bukura dhe më tërheqëse për të. Egos nuk i pëlqen të durojë vuajtjet e adhurimeve e të mirësive dhe as t'u bëjë qëndresë vështirësive dhe pasojave të tyre. Ajo u drejtohet gjërave të lehta që i pëlqejnë pasionit, argëtimit dhe interesit. Ja këto përbëjnë dëshirën dhe pasionin e egos.

Kurani na bën të ditur se dëshira është shkaku më i afërt i humbjes. Për këtë arsye, ata që shkojnë pas dëshirave të tyre, bien në humbje dhe mbeten të devijuar nga rruga e drejtë. Allahu i Madhëruar thotë:

**“Thuaj: Mua më është ndaluar t’i adhuroj ata, të cilëve ju u luteni në vend të Allahut. Thuaj: “Unë nuk i ndjek dëshirat tuaja të kota, sepse atëherë do të isha i humbur dhe nuk do të isha nga ata që janë në rrugë të**

**drejtë”.** (En’am, 56)

**“...Dije se ata janë skllëvër të dëshirave të veta. E kush është në humbje më të madhe se ata që udhëhiqen nga dëshirat e tyre, pa udhëzim prej Allahut? Sigurisht, Allahu nuk i udhëzon njerëzit keqbërës.”** (el-Kasas, 50)

**“Sikur e Vërteta të ishte sipas dëshirave të tyre, atëherë do të shkatërroheshin qiejt, Toka dhe gjithçka që gjendet në to. Ne u kemi dërguar atyre Këshillën (Kurandin), por ata shmangen nga ajo.”** (el-Mu’minun, 71)

Besimtarëve u takon të largohen prej atyre që janë bërë skllëvër të dëshirave dhe të ndjekin diturinë. Për shkak se burimi i diturisë është zbulesa hyjnore, kjo e fundit është në kontradiktë dhe në kundërshtim me pasionet e verbëra. Allahu i Lartësuar thotë:



*“As hebrenjtë, as të krishterët nuk do të jenë të kënaqur me ty, derisa të pranosh besimin e tyre. Thuaju: Vetëm udhërrëfimi i Allahut është i drejtë! E në qoftë se pas diturisë që të ka zbritur ti ndjek dëshirën e tyre, atëherë askush nuk do të të ndihmonte apo të mbronte nga dënimi i Allahut.”* (el-Bakara, 120)

*“E, nëse ti, pasi që të është zbritur dituria, do të ndiqje dëshirat e tyre, atëherë pa dyshim që do të ishe një nga keqbërësit.”* (el-Bakara, 145)

*“Ja, kështu, Ne e kemi zbritur (Kuranin) në gjuhën arabe (për të qenë) si gjykim (për njerëzit). Por, nëse ti ndjek dëshirat e tyre, pas dijes që të ka ardhur, ti nuk do të kesh as ndihmës, as mbrojtës prej Zotit.”* (er-Ra’d, 37)

Thuaj: *“O ithtarët e Librit! Mos i shkelni kufijtë e së vërtetës në besimin tuaj dhe mos ndiqni dëshirat e një populli që gaboi më parë, nxori prej udhës së drejtë shumë njerëz dhe vetë u shmang nga udha e drejtë.”* (el-Maide, 77)

Edhe “paragjykimi”, që është një cilësi negative dhe

që gjithmonë është në kontradikë me diturinë, e ndihmon dëshirën dhe pasionin. Shpesh këto gjenden bashkë:

*“Këta janë vetëm emra që ua keni ngjitur (idhujve) ju dhe të parët tuaj, kurse Allahu nuk ju ka dërguar për ata asnjë provë. Ata ndjekin vetëm paragjykimet dhe atë që ua ka qejfi, ndonëse u ka ardhur prej Zotit të tyre udhëzimi (për rrugën e drejtë).”* (en-Nexhm, 23)

*“Nëse i bindesh shumicës së njerëzve që gjenden në tokë, ata do të të shmangin nga rruga e Allahut. Ata ndjekin vetëm paragjykimet. Ata vetëm gënjejnë.”* (el-En’am, 116)

Allahu i Madhëruar i paralajmëron robërit e Tij kundrejt dëshirave dhe pasioneve vetiake, për shkak të dëmeve të tyre të mëdha e të përhershme:

*“Dhe mos shkoni pas epsheve tuaja e të shtrembëroni.”* (en-Nisa, 135)

*“Tregoju atyre (hebrenjve) për njeriun, të cilit Ne i mësuam shpalljet Tona, por u largua prej tyre. Kështu, djalli e pushtoi atë dhe ai u bë nga të humburit. Sikur të donim, do ta ngrinin atë (me shpalljet Tona), por ai u mbërthye pas jetës tokësore dhe u dha pas dëshirave të veta. Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh, ai përsëri të nxjerr gjuhën. Ky është shembulli i njerëzve, që mohojnë shpalljet Tona. Tregojua atyre këto ngjarje, në mënyrë që ata të mendojnë.”* (el-A’raf, 175-176)

*“Vallë, a është i njëjtë ai që i përmbahet udhëzimit të Zotit të tij me atë që i zbukurohen punët e veta të shëmtuara dhe lëshohet pas pasioneve të veta?”* (Muhammed, 14)

Dëshirat dhe pasionet e njeriut janë aq të rrezikshme, saqë pas një kohe njerëzit i lartësojnë ato në pozitën e Zotit, pastaj ata bien në gradët e më të ultëve:

*“A e ke parë ti atë që dëshirën e tij e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij? Apo ti mendon se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti. Madje, ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë.”* (el-Furkan, 43-44. Veçanërisht shik. El-Xhathije, 23)

Ja si e shpreh i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) faktin se sa

ligësi e madhe është ta bësh dëshirën zot:

*“Te Allahu nuk ka gjë më të rëndë dhe më të keqe se sa ndjekja e dëshirave vetiake ndërmjet zotërave jo të vërtetë që adhurohen nën qiell.”* (Hejsemi, I, 188)

*“Gjëja prej së cilës frikësohem më shumë në emër të ummetit tim është ndjekja e dëshirave të egos.”* (Shik. Hejsemi, I, 187; Sujuti, I, 12)

*“Një prej gjërave për të cilat frikësohem më shumë në lidhje me ju janë dëshirat e forta vetiake që ju zvarrisin drejt tërbimit në çështjen e stomakut dhe nderit tuaj. Ndërsa tjetri është pasioni dhe epshi, që mund t’ju shpien në humbje.”* (Ahmed, IV, 420, 423; Hejsemi, I, 188; Ebu Nuajm, Hilje, II, 32)

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) ka thënë:

*“Xhehenemi është i rrethuar me gjëra që i pëlqejnë egos, ndërsa xheneti është i rrethuar me gjëra që egoja nuk i dëshiron.”* (Buhari, Rikak, 28; Muslim, Xhennet, 1. Veçanërisht shik. Ebu Davud, Sunnet, 22; Tirmidhi, Xhennet, 21; Nesai, Ejman, 3)

Cila është zgjidhja? Zgjidhja është devotshmëria:

***“Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.”*** (en-Naziat, 40-41)

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) thotë:

*“Njeri i mençur është ai që e sundon veten dhe që punon për botën tjetër pas vdekjes. Ndërsa njeri i mjerë është ai që e lë veten të ndjekë dëshirat e tij dhe që kërkon nga Allahu duke iu lutur (dhe që këtë e shikon si të mjaftueshme).”* (Tirmidhi, Kijamet, 25/2459. Veçanërisht shik. Ibn Maxhe, Zuhd 31; Ahmed, IV, 124; Hakim, IV, 251)

### **MBURRJA KUNDREJT AJETEVE TË ALLAHUT**

***“Në çdo vendbanim që Ne kemi nisur ndonjë të dërguar, ata që bënin jetë luksoze thonin: ‘Me të vërtetë, ne nuk besojmë në mesazhin që keni sjellë!’ Dhe thanë: ‘Ne kemi më shumë pasuri dhe fëmijë, prandaj ne nuk do të jemi të dënuar.’*** (Sebe, 34-35)

***“Ne i dhamë Musait Librin dhe pas tij çuam të dërguarit njërin pas tjetrit. Ne i dhamë Isait, të birit të Merjemes, mrekulli të qarta dhe e mbështetëm atë me Shpirtin e Shenjtërisë (Xhebrailin. Sa herë që ndonjë i dërguar ju sillte atë që nuk ju pëlqente,***



***ju kapardiseshit, prandaj disa i quajtët gënjeshtarë e disa i vratë.”*** (el-Bekara, 87)

***“Me të vërtetë, atyre që i mohuan shenjat Tona me mendjemadhësi, nuk do t’u hapen dyert e qielit dhe as që do të hyjnë në Xhenet, derisa të kalojë deveja në vrimën e gjilpërës. Kështu i ndëshkojmë gjynahqarët!”*** (el-A’raf, 40)

***“Mjerë gjynahqari gënjeshtar! Ai i dëgjon shpalljet e Allahut që i lexohen e përsëri ngulmon në mendjemadhësi, sikur nuk i ka dëgjuar ato; atij jepi lajmin për dënim të dhembshëm!”*** (el-Xhathije, 7-8)

***“Të gjithë do të dalin para Allahut. (Atëherë), ata që kanë qenë të përulur, do t’u thonë atyre që kanë qenë kryelartë: ‘Ne kemi qenë ithtarët tuaj. A do të mund të lehtësoni ju prej nesh diçka nga dënimi i Allahut?’ Ata do të thonë: ‘Sikur të na kishte udhëzuar Allahu në rrugën e drejtë, edhe ne do t’ju kishim udhëzuar ju. Rënkojmë apo durojmë, për ne njësoj është, nuk do të ketë shpëtim.”*** (Ibrahim, 21)



# *Një ditë e paharruar që bashkoi dy festa të shënuara...*

*Muhamed Sytari*

16 nëntor 2010. Kjo datë e shënuar do të mbetet e skallitur në mendjet dhe zemrat e myslimanëve të Shkodrës. Ajo e martë, mbledhi në gjirin e saj madhështinë e Kurban Bajramit dhe përkujtimin e datës jubilarë të 20 vjetorit të rihapjes së Xhamisë Plumbit. E, s'kishte se si të festohej ndryshe kjo datë e shënuar që mbledhi dy data të veçanta në një ditë të mbarë Feste...

Për të parën herë në historinë 20 vjeçare të kësaj lirie të bekuar të besimit, ishim mbledhur të gjithë në atë shesh, bri xhamisë "Ebu Bekër". Lartësohej në hapësirat qiellore përreth, zëri ynë me tekbire e dhikre pafund... Vetëm koka të zeza të zinin sytë gjithandej. Nga të katër anët e Shkodrës, myslimanët ishin zgjuar që herët për të ardhur në sheshin e faljes, për të zënë një vend e për t'u bërë gati për ceremoninë e Kurban Bajramit, më të paharrueshmit Kurban Bajram!

Hoxhallarët ishin të gjithë aty, së bashku, me fytyrën e ndriçuar, me kokën e zbukurur nga çallma e bardhë, krah për krah, tamam si u shkon prijësve të urtë të një ymeti të bashkuar e të bekuar nga Zoti Një!

Muezini i xhamisë "Ebu Bekër", (E. Dibra), me ikametin që po këndonte, na bëri shenjë të rreshtoheshim sup më sup për të falur namazin e sabahut. Ndërkohë, imami i xhamisë Perash, (teologu A. Pizga), bëri një hap më përpara dhe me tekbirin fillestar, na mori për dore drejt atmosferës së namazit të sabahut me xhemat, aty, të gjithë së bashku në sheshin bri xhamisë "Ebu Bekër"...

Tekbiret e teshrikut u ngritën deri në qiell, teksa e gjithë masa e të pranishmëve madhëronin Zotin e Vetëm të gjithësisë. I ngjasonin haxhilerëve, të cilët në kësi ditësh e tubimesh, me tekbiret në gojë, bëjnë që e gjithë Mekka të zbukurohet me zërin e tekbirit. Edhe Shkodra sot, në këtë mëngjes të ri të kësaj Feste të madhe, po zgjohej me zërin e tekbirit nga goja e mijëra besimtarëve myslimanë, të rreshtuar në safet e përkushtimit e përluljes... Edhe Shkodra sot, ishte bërë si një Mekë e bekuar...

Imami i xhamisë "Ebu Bekër", (teologu I. Plaku), mori të fliste i pari mbi mesazhet e Kurban Bajramit. Në sytë e tij vështroja dritën e atij tubimi të paharruar. Emocionet përhapeshin gjithandej. Historia e Hz. Ibrahimit, Hz. Ismailit, nënës së tij dhe krejt personazheve të "Kurbanit", na mori, si me një mirazh hyjnor, drejt një vendi e një kohe, ndryshe nga ky vend e kjo kohë... Plaku i urtë Ibrahim e djali i bindur Ismail, ishin aty, të dy së bashku në altarin e bindjes ndaj Zotit të Vetëm... E, nëpërmjet zërit të imamit vaiz, dukej se historia e tyre po shfaqej si me një shirit të mrekullueshëm përpara syve tanë...

Më pas, në podiumin e vasit, u shfaq imami i xhamisë Parrucë, (teologu N. Drijaj). Ishte i emocionuar. Me siguri, ato mijëra koka të zeza që ishin ulur e rreshtuar para syve të tij, ishin pamja më mahnitëse që mund të kishte parë ndonjëherë... Mori të uronte e të shpjegonte madhështinë e kësaj dite dhe vlerën e tekbirit, harmonisë dhe vëllazërisë së shenjtë islame.

Teksa vaizët e nderuar flisnin e përcillnin emocione e dritë besimi, drita e rrezeve të diellit bënte me shenjë se koha e namazit të Kurban Bajramit po afronte. Ajo kishte hyrë tashmë...

Nga podiumi, teologu A. Halluni, u shpjegoi besimtarëve mënyrën e faljes së namazit të Kurban Bajramit. Shumë i emocionuar, ai uroi këtë ditë të madhe dhe përkujtimin e dy ngjarjeve të shënuara që kishte mbledhur në oazin e saj të begatë kjo ditë e pashembullt.

Momenti i namazit të Bajramit kishte mbërritur. Aty, para asaj turme të bardhë besimtarësh, më dukej se toka dhe qielli ishin bërë një. Ishin shkrirë e ishin bërë si një shpirt i papërlyer që rrezaton dashuri të pastër e të sinqertë, thirrje besimi të paluhatsëm, forcë Njësie, fuqi bashkimi e vëllazërimi, çdo të mirë... Aty, në mih-rabin e ditës së Bajramit të sakrificës, e ndjeja veten si imami më fatlum i botës në ato momente! Ndjeja se çdo gjë përreth nesh ishte rreshtuar e bërë një me ne... Dhe realisht, ashtu ishte..! Ato momente, në të cilat më ishte shkruar të isha prijësi i vëllazërve të mi në atë namaz bajrami, ishin çaste nga më të mrekullueshmet, që mund të jetohen në këtë tokë...

I shoqëruar nga tekbiret e shumta, u ngjita në minber. Mahnitëse ajo pamje! Turma e besimtarëve ishte e pafund. Përveç atyre mijëra myslimanëve që qëndronin të ulur bri njëri-tjetrit, me qindra të tjerë rrinin në këmbë dhe prisnin, me fytyrë nga kibla e kësaj dite fatlume... Ishte një pamje e papërshkrueshme. Ishte një emocion që nuk përjetohet çdo ditë...

Në jetën time ka patur momente të shumta, të mbushura me emocione dhe bardhësi. Pa dyshim, ky moment ishte njëri ndër ata çaste që nuk harrohen kurrë..! Nuk mund të harrohen ato fytyra të ndriçuara nga drita e besimit, që afër njëri-tjetrit, dëshmonin shfaqjen më të mrekullueshme të botës, atë të vëllazërisë së shenjtë islame, të përlulur para All-llahut, Zotit të botërave!

M'u kujtua tubimi i 16 nëntorit 1990. Atë ditë, e gjithë Shkodra ishte në këmbë. Atë ditë, e gjithë Shkodra dëgjonte Hafiz Sabri Koçin në hytben më fatlume të jetës së tij. Atë ditë... "Gëzimi më i madh i imi ka qenë më 16 nëntor... sikur linda përsëri. Kur shkova te xhamia, ç'të shihja? Ishte mbushur zi me njerëz. Vargu i tyre zgjatej deri në kala. Altoperlantet rreth e përreth... Të gjithë filluan të bien tekbir. Brohoritnin. Masa gjithnjë e më tepër merrte flakë... Kam hipur në një tribunë të ngritur për atë qëllim. Mezi e përmbaja veten dhe s'mundja t'ju besoja syve të mi... S'kisha parë në jetën time aq të tu-



buar, mbi 55 mijë vetë... E pashë veten aq të lumtur, sa që nuk kisha gajle edhe sikur të bija edhe kurban. Nuk kish-te gëzim më të madh për jetën!"<sup>1</sup>...

Para syve të mi, ishin përzier madhështia e kësaj dite me emocionet e asaj dite. Ishin bërë një, në këtë ditë të begatë, që mblodhi në zemrën e saj dy data të shënuara për çdo mysliman shqiptar.

Teksa shihja me shumë dashuri e emocion atë turmë të madhe besimtarësh, lumturohesha brenda vetes për faktin e thjeshtë se myslimanët e Shkodrës, po demonstro-nin në mënyrë shumë paqësore e demokratike një tipar të veçantë që i karakterizon; njësimin e plotë me fenë, besimin dhe shpirtin e tij, përtej rrethanave historike të këtij vendi! Si të thuash, tërë ato thirrje me zë të ngjirur të njerëzve-altoperlantë për t'u distancuar nga kjo fe e ky besim, me tubimin e sotëm, ishin bërë një hiç i madh, një shpenzim mjeran! E, në atmosferën e "dhoratave" politike, në prag të zgjedhjeve lokale të majit, forca e këtij tubimi ishte bashkuar me atë të Tiranës (e të shumë qyteteve të tjera), për të trupëzuar një thirrje më se legjitime, për zbukurimin e kryeqytetit shqiptar me faltoren e munguar të myslimanëve, edhe përtej vokacionit të çthurrur intelektual e besimor të një klase politikane pragmatiste...

Isha i lumtur që nga minberi në sheshin bri xhamisë "Ebu Bekër", shihja të shkrirë në një, shpirtin që zgjoi ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve, më 16 nëntor 1990, me vullnetin për të shikuar përpara, drejt një të ardhmeje më të mirë, me besim e përlulje para Allahut, më 16 nëntor 2010... me një ndërgjegje kombëtare, të kulluar...

1. Faik Luli, Islam Dizdari: "Një jetë në shërbim të fesë", Tiranë 1996, fq. 59.



# (Fo) kultura e trafikut dhe Islami

Rrustem Spahiu

Në hytben e vet të lamtumirës, mes tjerash Muhamedi (a.s.) tha edhe këto fjalë: “O njerëz, jeta juaj, pasuria juaj dhe nderi juaj janë të pacënueshme deri sa nuk takoheni me Zotin tuaj, ashtu siç është i pacënueshëm ky muaj, në këtë vend të shenjtë. A më keni kuptuar o njerëz?” Në bazë të këtyre thënieve të Muhamedit (a.s.) dhe thënieve të tjera të ngjashme me këto, dijetarët islamë kanë krijuar hierarkinë e vlerave, të cilat duhet të ruhen dhe të çmohen patjetër. Në vend të parë janë ato të domosdoshmet - eddarurijat, në të cilat bëjnë pjesë eddinu-feja, el-hajatu - jeta, el-aklu - logjika, el-irdu - nderi dhe el-mal - pasuria. Kur të sigurohen këto gjëra të domosdoshme, atëherë mund të mendojmë për aspekte të tjera të jetës siç janë haxhiat - gjërat e nevojshme për jetë normale dhe tahsiniat - gjërat luksoze. Në bazë të kësaj që u tha, mund të dalim në përfundimin se sipas islamit, jeta e njeriut është vlera më e lartë, e cila duhet të ruhet me shumë kujdes si dhurata më e madhe e Allahut. Se sa rëndësi i jep islami jetës, këtë e tregon edhe ky ajet, i cili në një farë mënyre është himni i jetës: “Nëse dikush mbytet një njeri që nuk ka mbytur askënd, ose që nuk ka bërë trazira në tokë, është njëlloj sikur të kishe mbytur tërë njerëzimin. Nga ana tjetër, nëse dikush bëhet shkaktar për ta ruajtur jetën e dikujt, është njëlloj sikur të ketë ruajtur të gjitha jetët”. Sot është fakt i pamohueshëm se jeta e njeriut është gjëja më e lirë, madje edhe pa vlerë. Gjërat janë kthyer aq shumë nga e mbrapshta, sa që luksit i japim përparësi mbi gjërat elementare, ndërsa statusit material i japim rëndësi mbi jetën. Kjo është diçka vërtet e rëndë, po të kemi parasysh faktin se dhjetëra aksidente udhëtimi që ndodhin çdo ditë sakrificat njerëzore është e domosdoshme. Këto fatkeqësi tragjike kryesisht janë rezultat i

faktorit njeri, gjegjësisht pakujdesia dhe mospërgjegjësia e vozitësit, vozitja nën ndikimin e alkoolit, shkelja e rregullave të qarkullimit dhe mungesa e kulturës elementare të komunikacionit. Kështu, vitet e fundit në rrugët tona ka me qindra aksidente të komunikacionit, në të cilat humbin jetën dhjetëra e qindra njerëz të pafajshëm. Me të vërtetë është shumë e çuditshme se si timoni dhe komunikacioni e deformatojnë moralin njerëzor. Nuk është rast i rrallë kur një njeri, i cili mund të jetë shumë i qetë në jetën e përditshme, sapo është në timon shndërrohet në njeri të papërmbytur, të papërgjegjshëm dhe të pandjeshëm ndaj pasojave që mund të shkaktojë. Dhe nuk është e domosdoshme që pasojat të ndodhin çdo ditë, sespe mjafton një çast i vetëm që jeta jonë ose jeta e të tjerëve të shkatërrohen nga një pakujdesi e rastit. Dikush ka thënë se mënyra më e thjeshtë për ta parë kulturën e një populli është që ta shikojmë atë popull se si sillet në komunikacion. Edhe fjala popullore thotë “Je i atillë siç edhe vozit” do të thotë se njeriu e tregon më së miri karakterin e vet në timon. Na është e qartë se shpirti i njeriut nuk mund të shihet, por mund të ndihet. Shpirti dhe karakteri i njeriut mund të manifestohen në dorëshkrim, veshmbathje, gjithsesi edhe në atë se çfarë makine vozit dhe si e vozit. Gjatë vozitjes pasqyrohet tërë ndyrësija njerëzore, e këtë e vërteton edhe fjala popullore “Shan si arabaxhi”, pra vozitësit janë të njohur si njerëz që shajnë dhe fyejnë. Sot në SHBA ekzistojnë institute që hulumtojnë se çfarë ndodh me njerëzit, të cilët duke qenë



tipa të qetë, kur udhëtojnë në autostradë dhe kur ndokush i tejkalon apo i bie borisë, krejt papritur janë të gatshëm ta mbysin tjetrin vetëm për kaq pak gjë. Do të kishim thënë se karakteri i vozitësit mbetet i njëjtë, vetëm është shtuar shpejtësia dhe fuqia e motorit.

Shtrohet pyetja si është e mundur që njerëz të tillë të ketë edhe mes myslimanëve, të cilët janë të thirrur që të jenë krijesa të rendit dhe ligjit. Të përkuqtojmë se respektimi i rendit dhe i ligjit është obligimi i parë fetar, pra farz: *“Thuaj: nënshtroni Allahut e Pejgamberit dhe atyre që kanë autorizim të urdhërojnë në mesin tuaj”*. Si mund të ndodhë që në një bashkësi ku vendin qendror e zë sheriatu gjegjësisht ligji, të mos respektohet rendi dhe ligji? Se sa shumë këmbëngul islami në lidhje me zbatimin e rendit dhe të ligjit, këtë na e dëshmojnë shumë thënie të Muhamedit (a.s.) mbi safat e xhamive, ku flitet deri në imtësi për respektimin e rendit brenda në xhami, rend i cili duhet të respektohet edhe brenda shoqërisë në përgjithësi. Kushdo që tenton t’i shkelë rregullat e komunikacionit duhet ta ketë të qartë se mund të shkaktojë rrezik për jetën e vet dhe për jetën e të tjerëve, gjëra që janë të barszvlëshme me vrasjen dhe vetëvrasjen. Konsiderojmë se nuk mund të qyhet normale shpejtësia në 140 km/h në një rrugë, ku shpejtësia kufizohet 60 km/h. Ky problem merr dimensione më të gjera kur këtë e bëjnë ata që mendojnë se janë myslimanë të mirë. Ky fakt, i cili nisët nga parashikimi se është e mundur të shkohet në xhami të agjërohet madje edhe të shkohet në haxh, por në të njëjtën kohë të mos kemi kujdes se si gjendemi në komunikacion, tregon se jemi të sëmurë në zemrat tona, gjë që mund t’u ndodhë shumë popujve e feve. Veçanërisht kjo është e shprehur sot pas periudhës së ateizmit agresiv dhe materializmit dhe kur njerëzit i rikthehen fesë pas disa dekadash në ateizëm. Nuk mund të mos kemi parasysh faktin se njerëzit nuk mund të kthehen aq lehtë në atë që e kanë humbur për dekada të tëra; kështu njerëzit i kthehen fesë në ibadete formale e i lënë pas dore segmentet e tjera të saj siç janë morali, ndershmëria, sinqeriteti etj. Morali është një gjendje tjetër agregate që çon besimtarin në lutje-rite, apo në të vërtetë është shenjë e deformimit të tij. Myslimanët shpeshherë citojnë ajete në të cilat Allahu (xh.sh.) flet mbi ehli kitabët, pasuesit e librave, të cilët i praktikojnë disa ajete e të tjerat i hedhin, duke konsideruar se kjo ka të bëjë me të tjerët, me hebretë dhe krishterët. Por mufesirët bashkëkohorë thonë se kjo ka të bëjë edhe me myslimanët, sepse edhe në mes tyre ka nga ata që disa rregulla i praktikojnë e disa të tjera i hedhin. Për interesat e veta, ata ia përshtatin islamit vetes, e jo veten islamit. Duhet ditur nëse je apo jo me Zotin, por nuk mund ta ndash veten në atë mënyrë që të jesh pak besimtar, e pastaj diçka tjetër, në xhami të jesh mysliman e në timon bishë etj. Islami është fe universale, një fe që u përshtatet të gjitha kohërave, vendeve e

situatave. Ti përkuqtojmë fjalët e Kuranit: *“O besimtarë, hyni në islam plotësisht”*. Ky ajet na urdhëron qartë se në islam duhet të hyhet me tërë qenien tonë dhe t’ia përshtatim fesë çdo segment të jetës sonë. Kështu që është shumë e logjishme që besimtari të mund ta tregojë fuqinë e besimit të vet edhe në timon, në mënyrë që të fitojë sevape e gjynahe duke u vozitur me automobilin e tij. Mund të përfundojmë se zbatimi selektiv i fesë është shkaku kryesor i mungesës së kulturës në komunikacion tek myslimanët.

Kështu, do t’ju japim disa këshilla që do t’ua rrisin sigurinë dhe kënaqësinë e vozitjes në tollovinë e përditshme të rrugës, që për çdo ditë shtohet e nuk pakohet.

*“O besimtarë, kërkoni shpëtimin në durim”*, thuhet në Kuran. Durimi është shpëtim dhe virtyt për njerëzit e mëdhenj e të zgjedhur, të cilët do të arrijnë larg, sepse uji i qetë i rrënon brigjet.

“Ngutja është punë e dreqit”, thotë Pejgamberi (a.s.), pra mos u ngut, sepse gjatë përpjekjeve që bën për të arritur me ngut, mund të humbësh atë që nuk mund ta kompensosh asnjëherë.

-Mos u hidhëro për atë që nuk mund ta ndryshosh.

Është e kotë të nervozohesh nëse del drita e kuqe në semafor ndërkohë që të ka ardhur radha për të kaluar ty ose dikujt para teje që po vozit ngadalë, pavarësisht se ti mund të jesh duke nxituar. Me këtë e kursen veten, sepse nuk ke kurrfarë dobie nga neuroza.

- Në vozitje apliko devizën islame *“Atë që nuk dëshiron që të tjerët të ta bëjnë ty, mos ua bëj të tjerëve”*. Edukata e mirë tregohet edhe në komunikacion.

- Kur tollovia është e madhe, jepi përparësi kalimi edhe të tjerëve, ndërsa kur dikush të jep ty përparësi, falënderoje qoftë edhe duke e përshëndetur me dorë, sepse falënderimi është cilësi e besimtarit.

- Ndërkohë që tollovia vazhdon dhe ti pret në makinë, bëj ndonjë dhikër. Do të shohësh se gjatë kësaj kohe me qindra herë mund të shqiptoni Estagfirullah, Elhamdulillah ose salavat mbi Pejgamberin, gjë e cila do të largojë nga stresi. Kësisoj koha do të të kalojë shumë më mirë se sa duke e harxhuar në nervozizëm të padobishëm.

- Mbështetu tek Allahu, sepse sa do të mundohesh t’i bësh gjërat si duhet, fatkeqësitë janë të mundshme. Kini parasysh fjalët e Muhamedit (a.s.): *“Ajo që të ka ndodhur nuk ka qenë e mundur të shmangej, ndërsa ajo që është shmangur nuk ka mundur të të ndodhte.”*

Në fund, duhet të kuptoni se me respektimin e rregullave të qarkullimit bëheni besimtarë dhe njerëz më të mirë. Nëse mund ta bindim dikë që të bëhet i përgjegjshëm në timon, ndoshta kemi shpëtuar jetën e tij dhe jetë të tjera.



# Vendet më të dashura tek Allahu janë xhamitë

*Gilman Kazazi*

**A**llahu me madhësinë e Tij krijon dhe zgjedh nga krijesat atë çka dëshiron. Ka krijuar xhenetet dhe ka zgjedhur Xhenmetul-Firdeus. Ka krijuar melaiket dhe ka zgjedhur Xhebrailin, Mikailin dhe Israfilin. Ka krijuar njerëzimin dhe ka zgjedhur ndërmjet tyre pejgamberët, e nga vetë pejgamberët ka zgjedhur Muhamedin (s.a.). Ka krijuar ymetet (popujt) dhe ka zgjedhur prej tyre ymetin e profetit Muhamed. Ka krijuar kohërat (kohët), muajt, ditët dhe netët dhe ka veçuar nga muajt Ramazanin, nga ditët e vitit ditën e Kurban Bajramit, nga ditët e javës, Ditën e Xhuma, ndërsa nga netët, Natën e Kadrit. Ka krijuar vendet dhe zonat dhe ka zgjedhur nga mesi i tyre Meken, Medinen dhe Shamin.

Nga vendet që i ka zgjedhur Allahu janë edhe xhamitë. Prandaj profeti Muhamed thotë: *“Vendet më të dashura tek Allahu janë Xhamitë”* (Muslimi). Kështu që askush të mos i vlerësojë klubet, rrugët, stadiumet, tregjet, sheshet apo bulevardet më shumë sesa xhamitë.

Për të treguar vlerën e xhamive dhe rëndësinë e tyre, flasin disa ajete kuranore dhe shumë hadithe të profetit Muhamed. Në Kuranin Famëlartë Allahu thotë:

*“E drejta e përkujdesjes së xhamive të Allahut është vetëm e atij që ka besuar Allahun dhe ditën e mbramë, e që e fal namazin, jep zekatin e nuk i frikësohet askujt përveç Allahut. Ato do të jenë të udhëzuarit (në rrugën e drejtë).”* (et-Teubeh, 18).

Profeti Muhamed thotë:

*“Kush ndërton një xhami për hir të Allahut, Ai do t’i ndërtojë atij një shtëpi në xhenet.”* (Buhariu)

*“Nga veprat, sevapi i të cilave nuk ndërpritet edhe pas vdekjes janë: ... ndërtimi i një xhamie ...”* (Ibn Maxheh)

*“Shtatë kategori njerëzish do t’i mbulojë hija e arshit të Allahut në ditën e gjykimit: ... ai person zemra, e të cilit është e lidhur me xhaminë ...”* (Buhariu)

## **RËNDËSIA E XHAMISË**

Rëndësia dhe vlera e xhamive shfaqet në arsyet e mëposhtme:

1. Xhamia është faltorja e myslimanit. Vendi në të cilin myslimani i përulet Allahut me zemër të pastër. Në Kuranin Famëlartë thuhet: *“Dhe (mua më shpallet) se vërtet xhamitë janë veçanti për ta adhuruar Allahun, e mos adhuroni në*

to askënd tjetër me Allahun". (el-Xhinn, 18)

2. Xhamia është kuvendi i myslimanëve. Vendi në të cilin myslimanët vijnë për t'u bashkuar e jo për t'u hidhëruar, për t'u ndihmuar e këshilluar e jo për t'u përçmuar, për të treguar unitetin e tyre në përvulljen dhe nënshtrimin ndaj Allahut e jo për të treguar kryelartësinë dhe mendjemadhësinë ndaj njeri-tjetrit.

3. Xhamia është shkolla e parë e myslimanëve. Vendi në të cilin merren bazat e edukatës Islame, djepi në të cilin ushqehet dashuria për dituri dhe kulturë. Nga xhamitë kanë dalë dijetarët dhe imamët e mëdhenj, kolosët e dijeve Islame. Në xhamia janë diskutuar, debatuar dhe shpjeguar dituritë e ndryshme islame, shkencore dhe shoqërore.

4. Xhamia është simbol i vëllazërisë islame. Ajo është zanafilla e bashkimit mes myslimanëve, është themeli i barazisë së myslimanëve para Allahut. Nga gjërat e para për të cilat u interesua Pejgamberi sapo mbërriti në Medine ishte ndërtimi i xhamisë, sepse ajo është vendi i namazit, e namazi është lidhja më e fortë mes robit dhe Krijuesit.

Xhamia ishte vendi ku profeti Muhamed (s.a.) tubohej me sahabet e tij, vendi ku i edukonte dhe këshillonte ata, vendi ku priste dërgatat e fiseve të ndryshme, vendi në të cilin gjykonte dhe zgjidhte problemet jetësore mes njerëzve, vendi ku grumbullonte zekatin dhe sadakanë e myslimanëve, vendi ku strehonte sahabet e varfër, vendi i parë në të cilin Profeti ndalonte kur kthehej nga ndonjë udhëtim.

Thënë shkurt, xhamia ka qenë institucion shumë funksional. Ndonëse e thjeshtë, e ndërtuar me baltë dhe e mbuluar me gjethe hurme e palme, roli i saj në shoqërinë e profetit Muhamed ka qenë madhështor.

"... Një xhami, e cila që prej ditës së parë është themeluar në respekt dhe devotshmëri ndaj Allahut, është më e drejtë të falesh në të, aty ka burra që dëshirojnë të pastrohen, e Allahu i do të pastërtit." (et-Teubeh, 108)

## RREGULLAT E XHAMISË

1. Kur myslimani hyn në xhami, është e pëlqyeshme që të hyjë me këmbën e djathtë duke thënë:

"Bismil-lah, All-llahum-me sal-li ala Muhammed, All-llahum-meftah li ebvabe rahmetike."

që do të thotë: "Me emrin e Allahut, o Allah dërgo salavate mbi Pejgamberin, o Allah mi hap dyert e mëshirës Tënde."

2. Kur myslimani del nga xhamia, është e pëlqyeshme të dalë me këmbën e majtë dhe të thuhet:

"Bismil-lah, All-llahum-me sal-li ala Muhammed, All-llahum-me in-ni es-eluke min fadlike."



që do të thotë: "Me emrin e Allahut, o Allah dërgo salavate mbi Pejgamberin, o Allah unë kërkoj nga mirësitë Tuaja."

3. Qëndrimi në xhami është ibadet, gjë e pëlqyeshme, e sidomos kur shoqërohet me leximin e Kuranit, me përmendjen e Allahut, me qëndrimin në I'tikaf, me prezantimin në një ligjëratë, apo me pritjen e namazit. Profeti Muhamed thotë:

"Me të vërtetë xhamitë kanë frekuentues të rregullt, me të cilët melaiket qëndrojnë me ta, e nëse mungojnë, melaiket pyesin për ta, e nëse sëmuren melaiket i vizitojnë ata, e nëse janë në nevojë, melaiket i ndihmojnë ata." (Ahmed)

"Për një mysliman që e zë xhaminë si vend për të falur namaz dhe për të përmendur Allahun, përveçse Allahu gëzohet me të që kur del nga shtëpia, ashtu siç gëzohet familja kur i kthehet një anëtar i saj nga larg." (Ahmed)

"Për myslimanët që mbledhen në një nga shtëpitë e Allahut (xhamiat) për ta lexuar Kuranin dhe për t'ia mësuar atë njeri-tjetrit, përveçse mbi ta zbret qetësia dhe paqja, ata i kaplon mëshira, rrethohen nga melaiket dhe Allahu i përmend ata." (Muslim)

Ebu Derdaja e ka këshilluar djalin e tij me këto fjalë: "O djali im, xhamia duhet të jetë shtëpia (vendqëndrimi) yt, sepse e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: "Xhamitë janë vendqëndrimet e njerëzve të devotshëm. Ai që e ka xhaminë për vendqëndrim, Allahu i garanton atij mëshirën dhe kalimin e sigurt mbi Urën e Siratit". (et-Taberani)



A nuk dëshiron secili prej nesh të jetë i ftuari dhe miku i Allahut?

Xhamia është shtëpia e Allahut dhe ne jemi mysafirët e Tij për sa kohë që qëndrojmë në xhami. Profeti Muhamed thotë: *“Kush merr abdes në shtëpi dhe e plotëson abdesin e tij, pastaj vjen në xhami, ai konsiderohet mysafir i Allahut. Dhe është e drejtë e Allahut (i takon Atij) ta nderojë mysafirin.”* (et-Taberani)

4. Është e pëlqyeshme që të pritët namazi duke qëndruar në xhami dhe jo duke pritët në klub apo rrugë. Profeti Muhamed thotë:

*“Çdonjëri nga ju do të vazhdojë të ketë sevapet e të qëndruarit në namaz, përderisa është duke pritët namazin. Nuk e pengon atë që të kthehet në shtëpinë e tij veçse namazi.”* (Buhariu)

“Melaiket do të vazhdojnë të luten duke thënë: O Allah fale, o Allah mëshiroje për çdonjërin nga ju, përderisa ai qëndron në vendin që u fal derisa ta ketë prishur abdesin.” (Buhariu)

Allahu me mirësitë dhe mëshirën e Tij shpërblen ata persona që ecin për në xhami, e mos pyet për ata që qëndrojnë në xhami!

Profeti Muhamed iu drejtua shokëve të tij: “A dëshironi t’ju tregoj për ata vepra me anë të të cilave Allahu i shlyen

gjynahet dhe i lartëson gradët në xhenet?”. Iu përgjigjën: Po. Tha: *“Plotësimi i abdesit në vështirësi, shumimi i hapave për në xhami dhe pritja e namazit pas namazit.”* (Muslim)

*“Përgëzoji me dritë të plotë Ditën e Gjykimit, ata të cilët ecin për në xhami në errësirë.”* (Tirmidhi)

5. Është traditë e profetit Muhamed (a.s.) që të falen dy rekat namaz për atë që hyn në xhami, në shenjë respekti dhe nderimi për xhaminë. Profeti Muhamed thotë:

“Nëse hyn dikush nga ju në xhami, le t’i falë dy rekat namaz para se të ulet.” (Buhariu)

Ebu Katade thotë: “Kam hyrë në xhami dhe Pejgamberi po qëndronte ulur mes njerëzve, kështu që u ula edhe unë. Profeti m’u drejtua dhe më tha: “Ç’te pengoi që t’i falësh dy rekat para se të uleshe?” I thashë: O i Dërguari i Allahut, ju pashë juve dhe njerëzit ulur. Më tha: “Nëse hyn dikush nga ju në xhami, të mos ulet pa i falur dy rekat.” (Muslim)

6. Xhamitë duhet të ruhen të pastra dhe të mirëmbahen. Të gjithë krenohemi se Islami është fe e pastërtisë, se Islami na mëson të jemi të pastër në trupin, veshmbathjet dhe shtëpitë tona. Dhe normalisht, ajo pastërti me të cilën na urdhëron Islami duhet të pasqyrohet edhe në xhamitë tona.

Mirëmbajtja e xhamisë nuk është obligim vetëm për një person, por të gjithë myslimanët janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pastërtinë e saj. Nëse të gjithë jemi të kujdesshëm për pastërtinë e shtëpive tona, duhet patjetër që të jemi të interesuar edhe për pastërtinë e shtëpisë së Allahut, xhamisë.

Është i njohur në mesin e myslimanëve rasti, kur një beduin (endacak shkretëtire) në kohën e profetit Muhamed (a.s.), hyri dhe urinoi në xhami. Shokët e Profetit menjëherë u ngritën dhe filluan t’i bërtisnin. Profeti Muhamed, me urtësinë dhe butësinë e tij, i qetësoi ata dhe i urdhëroi që të hidhnin ujë e të pastrohej xhamia nga ndotja. Pastaj iu drejtua bedunit duke e këshilluar: *“Xhamitë nuk janë vend për papastërti, ato janë vende ku përmendet Allahu dhe lexohet Kurani”.* (Muslim)

Në një rast tjetër, profeti Muhamed duke u falur me shokët e tij, i hoqi pantoflat e tija dhe i vendosi në të majtë të tij. Sahabet kur e panë një vepër të tillë, i hoqën edhe ata pantoflat e tyre. Pasi mbaroi namazi, Profeti i pyeti ata: “Pse i hoqët pantoflat tuaja? I thanë: Ju pamë juve t’i hiqnit dhe i hoqëm edhe ne. Profeti tha: Mua më lajmëroi Xhebraili se pantoflat e mia ishin të papastra. Pastaj tha: *“Nëse vjen dikush në xhami, le t’i shikojë pantoflat e tija, nëse janë të papastra le t’i fshijë (pastrojë) ato, pastaj le të falet me to”.* (Ebu Davud)

Xhamia e Profetit ka qenë e shtruar me zall dhe myslimi-

manët në atë kohë janë falur me pantofla apo këpucë. Sot ne falemi me çorape, prandaj edhe le t'i shikojmë çorapet tona nëse janë të papastra apo jo. Çorapi i papastër e prish higjenën e xhamisë.

Aishja (r.a.) tregon se: "Profeti Muhamed ka urdhëruar të ndërtohen xhami nëpër fiset arabe, të mbahen pastër dhe të lyhen me erë të mirë". (Ebu Davud)

7. Islami nuk e ka ndaluar bisedën në xhami, sepse vetë Profeti ka biseduar dhe diskutuar me sahabet e tij në xhami. Normalisht bëhet fjalë për bisedë të lejuar, sepse biseda e ndaluar nuk lejohet, pa marrë parasysh se a jemi në xhami apo jashtë saj. Me bisedë të ndaluar kam (kemi) për qëllim: thashethemet, përgojimet, mashtrimet, fyret, sharjet etj. Gjithashtu biseda e kotë, e pavlerë dhe e padobishme nuk është e pëlqyeshme në xhami, por as edhe jashtë xhamisë. Allahu i ka cilësuar myslimanët e devotshëm në Kuran:

*"Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët. Ata të cilët janë të përlulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit dhe ata, të cilët i shmangen të kotës (fjalë a punë)." (el-Mu'minun, 1-3)*

*"(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur (rastësisht) kalojnë pranë të kotës, kalojnë duke e ruajtur karakterin e tyre." (el-Furkan, 72)*

*"Dhe kur dëgjojnë ndonjë llomotitje marrëzie i kthejnë shpinën dhe thonë: Ne kemi veprat tona e ju tuajat, qofshi larg nesh, ne nuk na duhen injorantët." (el-Kasas, 55)*

Po ashtu, përjashtohet biseda ditën e xhuma, kur imami është duke mbajtur hutben, sepse në këtë moment nuk lejohet biseda.

Kurse zhurmat apo bisedat e panevojshme e me zë të lartë në xhami, për më tepër kur ndokush është duke u falur, nuk lejohet.

Es-Saib ibn Jezid thotë: "Isha duke qëndruar në xhami, kur më thirri Umeri dhe më urdhëroi: Shko m'i sill ato dy persona (që po qëndronin në xhami). Pasi ia solla, Umeri iu drejtua atyre me këto fjalë:

- Nga jeni?

- Nga banorët e Taifit.

Umeri i tha:

- Sikur të ishit nga banorët e Medines do t'ju kisha dënuar (goditur), sepse po ngrinit zërin në xhaminë e Pejgamberit." (Buhariu)

Teksa qëndronte në l'tikaf në xhaminë e tij, Profeti Muhamed (a.s.) dëgjoi sahabet teksa ngrinin zërin duke lexuar Kuran. Në këtë rast, Profeti iu drejtua atyre: "Gjithsecili nga ju e thërret dhe i lutet Zotit të tij, prandaj mos e shqetësoni dhe mos e ngatërroni njëri-tjetrin. Mos e ngrini zë-



rin duke lexuar Kuran". (Ebu Davud)

Nëse me Kuran është e ndaluar të ngrihet zëri ngaqë ndokush mund të shqetësohet, normalisht as zhurmat dhe bisedat e kota që prishin qetësinë nuk lejohen në xhami. Xhamia është vend ibadeti dhe jo vend muhabeti.

8. Nuk lejohet shitblerja në xhami. Xhamia nuk është pazar apo vend tregtie mes njerëzve. Profeti Muhamed ka thënë: "Nëse e shikoni një person që shet apo blen në xhami, i thoni atij: Mos të dhëntë Allahu bereqet në shitblerje..." (Tirmidhi)

9. Nuk është e pëlqyeshme kryqëzimi i gishtave në xhami. Ka'b ibn Malik tregon se: "Kam qenë duke qëndruar në xhami me gishtat e dorës të kryqëzuar, kur profeti Muhamed më tha: O Ka'b, nëse je në xhami mos i kryqëzo gishtat e duarve, sepse ti konsiderohesh në namaz, përdërisa je duke pritur namazin në xhami". (Ahmed)

Lexues i nderuar, së fundi, xhaminë e myslimanëve e karakterizon thjeshtësia, qetësia dhe pastërtia. Xhamitë duhet të ndërtohen dhe zbukurohen me xhemat, me kurse, me ligjërata, me dituri dhe me ibadete.

Ibn Abasi thotë: "Do t'i zbukuroni xhamitë tuaja ashtu siç i zbukurojnë jomuslimanët faltoret e tyre." (Ibn Hiban)



# Një Ajet

## *Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht.” (Nisa, 65)

Në këtë ajet, Allahu i Lartmadhëruar urdhëron sahabet e prej këtu të gjithë myslimanët që në rast mosmarrëveshesh ndërmjet njëri-tjetrit të thërrasin në ndihmë gjykimin e të Dërguarit të Allahut. Ndërsa detyra e një myslimani që konsultohet me gjykimin e Hazreti Pejgamberit është dorëzimi me gjithë zemër i këtij gjykimi profetik. Vetëm në sajë të këtij dorëzimi arrihet grada e muminit.

Myslimanët që do të vijnë pas sahabeve, pra ne, si mund të thërrasim në ndihmë gjykimin e Hazreti Pejgamberit? I Dërguari i Allahut në një hadith është shprehur:

“Po ju lë dy gjëra. Nëse kapeni fort pas tyre nuk do të humbisni asnjëherë rrugën e drejtë. Librin e Allahut dhe Sunnetin e të Dërguarit të Tij.” (Muvatta’, Kader 3)

Prandaj problemet tona jemi të detyruar t’i zgjidhim me dritën e Kuranit dhe Sunetit. Kjo do të thotë që çështjet në lidhje me të cilat ka gjykime të qarta në Kuran dhe në Sunet do t’i zgjidhim pikërisht ashtu siç na urdhërohet në Kuran dhe në Sunet. Por në qoftë se çështja (tema) nuk haset as në Kuran e as në Sunetin e të Dërguarit të Allahut atëherë do të marrim një vendim në frymën e urdhëresave dhe të këshillave të Kuranit dhe të Sunetit.

Zubejr Ibn Avvam debatoi me njërin prej Ensarëve në lidhje me ujitjen e një sipërfaqe toke jashtë Medines. Pasi ato nuk arritën t’i jepnin zgjidhje erdhën së bashku tek Hazreti Pejgamberi për të kërkuar gjykimin e tij. Mirëpo gjykimi që Hazreti Pejgamberi dha nuk i pëlqeu fare myslimanit prej ensarëve, madje ai e akuzoi Hazreti Pejgamberin se po bëhej palë me Zubejr ibn Avvamin. Kjo situatë u bë shkak për zbritjen e ajetit që kemi shkruar në krye të faqes. (Buhari, Tefsiri i sures (4), 12, Musakat 8, Sulh 12)

Sqarimi i disa pikave që lidhen me ajetin në fjalë do të sillte kuptimin më të thellë të çështjes si dhe rëndësinë që ka kjo temë.

Allahu i Lartmadhëruar e ka lidhur të qenurin besimtar i vërtetë (mu’min) me disa kushte:

1. Besimtarët janë të detyruar që për problemet e ndryshme që ato hasin në jetën e tyre të marrin Hazreti Pejgamberin si gjyqtar në mesin e tyre. Ai që nuk pranon gjykimin e të Dërguarit të Allahut nuk mund të jetë mu’min (besimtar i vërtetë).

2. Besimtarët nuk duhet të preken apo të fyhen së brendshmi nga gjykimet apo vendimet e të Dërguarit të Allahut. Një njeri mund të shprehë pëlqimin e tij në dukje ose së jashtmi dhe të mjaftohet me kaq, por ajeti konsiston në domosdoshmërinë e pëlqimit të çdo gjykimi të Profetit edhe me zemër.

3. Besimtarët e vërtetë duhet t’i dorëzohen tërësisht gjykimeve të të Dërguarit të Allahut. Ndoshta edhe një njeri që beson me zemër vërtetësinë e gjykimit në fjalë, mund të dyshojë apo të jetë kokëfortë së jashtmi në lidhje me pranimin ose jo të këtij gjykimi. Mirëpo Allahu i Lartmadhëruar në ajetin e mësipërm kërkon prej besimtarëve që ato jo vetëm të kenë iman të sinqeritë në zemër, por të dorëzohen tërësisht edhe se jashtmi.

# Vjë Hadith

Transmetohet nga Ebu Hurejre radijallahu anhu se

*Resulullahu sallallahu alejhi ve sellem ka thënë:*

**“I gjithë ymeti im do të hyjë në xhenet, përveç atyre që nuk dëshirojnë”**

Pejgamberi (a.s.) u pyet:

O i Dërguari i Allahut, po kush nuk dëshiron të hyjë në xhenet?

Pejgamberi (a.s.) tha:

**“Ata që do të më binden mua do të hyjnë në xhenet, ndërsa ata që nuk më binden janë ata që nuk dëshirojnë të hyjnë në xhenet.”**

(Buhari)

Ata që nuk dëshirojnë të hyjnë në xhenet mund t'i grupojmë në dy kategori ose mund t'i kuptojmë në dy mënyra. Njëri prej këtyre grupeve është ai që emëtohet **“ummet-i davet”**, të cilëve i ka shkuar ftesa për të hyrë në islam, nëse nuk e pranojnë, pra nuk bëhen mysliman atëherë quhen kafir. Ndërsa grupi tjetër që emërtohet **“ummeti ixhabet”** janë ato individ që kanë pranuar islamit dhe të cilët duhet të jenë shembull për të tjerët. Në mesin e këtyre të fundit ka nga ato që nuk i binden asaj çfarë i është shpallur Pejgamberit (a.s.) duke mos i kryer obligimet fetare, e kështu ato meritojnë të quhen rebel ose gjynahqar. **Kafirët nuk do hyjnë kurrë në xhenet. Ndërsa rebelët, gjynahqarët do të hyjnë në xhenet, por pasi të shlyejnë mëkatet në xhehenem.** Kjo do të thotë që gjynahet nuk e zhdukim imanin (besimin) por e shpien njeriun në xhehenem. Duhet theksuar se qëndrimi i këtyre të fundit në xhehenem nuk do të jetë i përjetshëm, si ai i kafirëve.

Sahabet u habitën dhe u bënë kurioz në lidhje me atë grup individësh të cilët nuk dëshironin të hynin në xhenet, prandaj e pyetën Pejgamberin (a.s.) për t'u informuar. Përgjigjja e Pejgamberit (a.s.) që e shkurtër, por shume kuptimplotë, sipas së cilës ai që do t'i bindet atij do të hyjë në xhenet, kurse ai që do t'i kundërvihet atij do të thotë se dëshiron xhehenemin. T'i bindesh Pejgamberit (a.s.) do të thotë të lidhesh me tërë forcën tënde me Kuranin dhe Sunetin e Pejgamberit, e ato që do të veprojnë kështu do të hyjnë në xhenet si besimtarë të devotshëm. Ndërsa të rebelohesh ndaj Pejgamberit (a.s.) do të thotë të mos pranosh ftesën për të hyrë në fenë islame, e kështu të jetosh si kafir e të përfundosh përjetësisht në xhehenem, ose ta pranosh ftesën për të hyrë në fenë islame, por të mos veprosh sipas asaj çfarë urdhërohet nga kjo fe e nderuar, e kështu të jetosh si gjynahqar, që do të thotë të shkosh në xhehenem për t'i shlyer gjynahet e më pas të arrish të shkosh në xhenet.

**Mësimet që nxjerrim nga hadithi:**

1. Bindja ndaj të Dërguarit të Allahut bëhet shkak për hyrjen e besimtarit në xhenet.
2. Të kundërshtosh Pejgamberin (a.s.) do të thotë të mos pranosh fenë e cila i është shpallur atij, e kështu të përfundosh në xhehenem përjetësisht. Ai që ka pranuar Islamit dhe vazhdon të kryejë gjynahe do të hyjë në xhehenem, por nuk do të qendrojë gjithmonë aty.



# HZ. OSMANI (R.A.)

Osmani (r.a.) është njëri prej katër halifeve të mëdhenj dhe gjithashtu njëri prej sahabeve të zgjedhur që i ka shërbyer Profetit (a.s.) me tërë shpirtin dhe pasurinë e tij, por i cili ka patur edhe fatin të jetë dhëndëri i Profetit. Ai ka kryer shërbime të mëdha si në kohën e Profetit (a.s.), ashtu edhe në kohën e Ebu Bekrit, Omerit, si dhe në kohën kur ishte vetë halife.

## ZOTËRUESI I DY DRITAVE

Osmani (r.a.), i cili pati nderin e madh të martohej me vajzën e Profetit tonë (a.s.), të nderuarën Rukije (r.a.), u hidhërua shumë kur ajo ndërroi jetë. Kur Profeti ynë i dashur (a.s.) e pyeti se përse ishte hidhëruar aq shumë, Osmani (r.a.) e shprehu kështu shkakun e hidhërimit të tij:

*“O Resulallah! Ajo që më ka ndodhur mua, nuk i ka ndodhur askujt. Me*

*vdekjen e vajzës tuaj Rukije, u pre edhe lidhja fa-refisnore që kisha me ju...!”*

Me gjithë propozimet e të afërmeve të tij për t’u martuar përsëri, Osmani (r.a.) thoshte: *“E kë mund të shoh më si vjehërr përveç Profetit!? Pas martesës me bijën e tij, me kë të martohem përsëri!?”*

Duke menduar kështu nga shkakun e shkëputjes së lidhjes familjare me atë familje të bekuar, ai zhytej në hidhërim të thellë.

Profeti ynë (a.s.), i cili e shihte gjendjen e Osmanit (r.a.), u kënaq shumë nga dashuria dhe lidhja e veçantë që ai tregonte. Si rrjedhojë, ai i dha për bashkëshorte edhe vajzën e tij të vogël Ummu Gulsumin. Pas disa kohësh, kur edhe Ummu Gulsumi ndërroi jetë, Resulullahu (a.s.) tha:

*“Nëse do të kisha një vajzë tjetër, padyshim që do ta jepja ty.”<sup>1</sup>* Me këto fjalë, Profeti ynë (a.s.) shprehu edhe njëherë dashurinë e veçantë që kishte ndaj Osmanit (r.a.).

Osmani (r.a.), i cili ishte i ditur, i sjellshëm, bujar, zemërbutë, i urtë, i turpshëm, njeri i zemrës, modest dhe i dashur, sipas shprehjes së vetë Profetit tonë (a.s.), ishte *“ndër të gjithë ashabet e tjerë sahabiu, karakteri i të cilit i ngjante më së shumti atij (profetit)”<sup>2</sup>*. Përsëri, nuk ishte parë midis ashabeve ndonjë që të fliste aq bukur sa Osmani (r.a.). Por

1. Shih. Hz. Osman Zinnureyn, Ramazanoğlu Muhamud Sami, sf. 12.

2. Shih. Hz. Osman Zinnureyn, Ramazanoğlu Muhamud Sami, sf. 13.

**E si të mos turpërohem nga njeriu prej të cilit turpërohen edhe engjëjt!? Beto hem në Allahun se engjëjt turpërohen prej Osmanit, ashtu siç turpërohen prej të Dërguarit të Allahut.**

për fat, ai fliste shumë rrallë.

### SIMBOLI I NJERIUT TË TURPSHËM

Osmani (r.a.), ishte personalitet shembullor edhe nga ana e ndjenjës së turpës. Edhe engjëjt kishin turp prej tij.<sup>3</sup> Një ditë, kur Resulullahu (a.s.) ishte ulur me nënën tonë Aishen (r.a.), Ebu Bekri (r.a.) kërkoi leje dhe hyri brenda. Pas tij hyri Omeri (r.a.) dhe Sa'd ibni Maliku. Por në çastin kur Osman (r.a.) kërkoi leje për të hyrë brenda, Profeti ynë (a.s.) ndërroi pozicionin e uljes dhe i tha Aishes (r.a.): "Tërhiq! (Largohu prej këtu)".

Osmani (r.a.) hyri brenda dhe pasi biseduan për pak kohë, kërkoi leje dhe doli. Kur Aisheja (r.a.) pyeti:

-Kur hyri babai im Ebu Bekri dhe sahabet e tjerë, nuk e ndërruat pozicionin e uljes dhe nuk më the 'tërhiq (largohu)'. (Përse vepruat ndryshe kur erdhi Osmani)?

Resulullahu (a.s.) tha:

- *E si të mos turpërohem nga njeriu prej të cilit turpërohen edhe engjëjt!? Beto hem në Allahun se engjëjt turpërohen prej Osmanit, ashtu siç turpërohen prej të Dërguarit të Allahut. Nëse ti do të ishe pranë meje kur të hynte, ai as do të fliste dhe as që do ta ngrinte kokën derisa të dilte.*<sup>4</sup>

Osmani (r.a.), i cili ishte simbol i ndjenjës së tur-

pit thoshte: "Ruajtja e syrit prej haramit është perde e mirë ndaj epshit." dhe gjithmonë mundahej të udhëzonte njerëzit në këtë çështje.

Sipas një transmetimi të Enesit (r.a.), një ditë, kur ai po shkonte tek Osmani (r.a.), pa në rrugë një grua. Bukuria e gruas i mbeti në mendje. Duke e pasur mendjen tek ajo, arriti tek Osmani (r.a.). Kur pa Enesin (r.a.), Osmani (r.a.) tha:

- O Enes! Po hyn këtu në një kohë kur në sytë e tu ka gjurmë zinaje.

Enesi (r.a.) i habitur dhe i turpëruar prej këtyre fjalëve, pyeti:

- Vallë, a mos vjen shpallje edhe pas profetit?

Ndërsa Osmani (r.a.) tha:

**"Jo, ky është një perceptim dhe intuitë e saktë."**<sup>5</sup>

Vlera e lartë që ka pranë Allahut morali i bukur i këtij sahabiu të nderuar, shprehet shumë bukur në këtë hadith:

Një ditë, Aliu (r.a.), i solli ujë Profetit (a.s.) me qëllim që ai të merrte abdest. Ndërkohë e pyeti:

- O i Dërguar i Allahut! Kush do të jetë personi i parë që do të thirret për llogari në ditën e kiametit?.

Profeti ynë (a.s.) iu përgjigj:


- *Unë. Unë do të qëndroj përpara Allahut sa të dua. Pastaj do të dal prej aty duke mu falur të gjitha gjynahet".*

Aliu pyet përsëri:

5. Kushejri, Risale, Bejrut 1990, faq. 238.

3. Ahmed, 1, 71; VI, 155

4. Shih. Hz. Osman Zinnureyn, Ramazanoğlu Muhamud Sami, sf. 143-144.



- Po pastaj kush?

Profeti ynë (a.s.) tha:

- Pastaj Ebu Bekri, (edhe ai) do të qëndrojë para Allahut sa të dojë dhe do të dalë prej aty duke iu falur të gjitha gjynahet.

Aliu (r.a.) pyet përsëri:

- Po pastaj kush?" Profeti ynë (a.s.) u përgjigj:

*"- Pastaj Omer bin Hattab. (Edhe ai) Do të qëndrojë përpara Allahut dhe do të dalë prej aty duke ju falur të gjitha gjynahet."* Aliu sërish pyeti:

"- Po pastaj kush?

Këtë herë, Profeti (a.s.) thotë:

- Pastaj ti.

Aliu (r.a.) thotë:


- Po Osman bin Affan ku është?

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) u përgjigj:

*"Osmani zotëron ndjenjën e turpit. Dëshirova prej Zotit tim që të mos e marrë në llogari dhe Ai e pranoi dëshirën time".<sup>6</sup>*

### NË VENDIN KU NUK PRANOHE I DËRGUARI I ALLAHUT NUK VIJ AS UNË!..

Osmani (r.a.) e donte Resulullahun (a.s.) më shumë se shpirtin e tij. Edhe një shenjë që ai bënte e konsideronte si urdhër dhe sakrifikonte çdo gjë për ta zbatuar. Kur ishin në Hudejbije,



ai shkoi në Mekke si i dërguar i Profetit dhe ju tregoi mushrikëve se qëllimi i tyre ishte vetëm të bënin umre. Mushrikët nuk dhanë leje, por i thanë Osmanit (r.a.) se nëse dëshironte, vetëm ai mund të bënte tavafin në Kabe. Por Osmani (r.a.), duke e treguar edhe njëherë besnikërinë ndaj të Dërguarit të Allahut, ju dha këtë përgjigje të mrekullueshme:

*"Nëse Profeti nuk e bën tavaf Kaben, as unë nuk mund ta bëj! Unë e vizitoj Bejtullahun (Shtëpinë e Allahut) vetëm pas tij. Në vendin ku nuk pranohet i Dërguari i Allahut nuk vij as unë!.."*

Në momentin kur në Hudejbije u përhap fjala se Osmani (r.a.) ra dëshmor, Profeti ynë (a.s.) mori besën prej sahabeve se nëse ishte nevoja do të luftonin me mushrikët. Pastaj, vuri një dorë mbi tjetrën dhe duke shprehur dashurinë dhe rëndësinë që i jepte atij (Osmanit) tha: *"Allahu im, kurse kjo besë është për Osmanin. Padyshim që ai është në shërbimin Tënd dhe të Dërguarit tënd."*<sup>8</sup> Në ato çaste vjen një i dërguar prej mushrikëve, me qëllimin për të lidhur një marrëveshje. Pak më vonë, Osmani (r.a.) kthehet shëndosh e mirë.

### DIELLI I BUJARISË

Osmani (r.a.), i cili zotëronte këtë besnikëri shebulllore, shquhej edhe për bujarinë e tij të madhe. Ishte aq bujar sa thoshte: *"Sundimi i pasurisë është falënderimi. Ndërsa falënderimi është të*

7. Ahmed, IV, 324

8. Buhari, Ashabu'n-Nebi, 7.

el-Kazvini, et-Tedvin fi Ahbari Kazvin,

**“O ti shpirt i qetësuar!  
Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur  
me Atë dhe Ai kënaqur me  
ty! Bashkohu me robërit e Mi  
dhe hyr në Xhenetin Tim!”**

**(el-Fexhr, 27-30)**

*dhurosh me bollëk*”. Kështu që ai bëhej shembull personalisht në këtë çështje. Gjithashtu, për hir të Allahut ai liroi dhe u bë shkak lirimi i qindra sklllevërve.<sup>9</sup>

Në një fushatë lufte të vështirë si lufta e Tebukut, Osmani (r.a.) i dhuroi ushtrisë 300 deve të pajisura për luftë, e për më tepër fali edhe një mijë dinarë. Për këtë arsye, Profeti (a.s.) e lavdëroi dhe i dha myzhdenë se: *“Këtej e tutje Osmanin nuk do ta dëmtojë asgjë nga ato që do të veprojnë!”*<sup>10</sup>

Një herë tjetër, kur Osmani (r.a.) emigroi në Medine pa se myslimanët po vuanin për ujë. Përveç ujit të pusit Rume, që i përkiste një hebreu, uji i të gjitha puseve të Medines ishte i hidhur. Ky hebreu jetonte duke shitur këtë ujë.

Profeti ynë i dashur (a.s.) urdhëroi:

*“Kush prej jush dëshiron të fitojë një pus më të mirë në xhenet, duke e blerë Pusin Rume dhe duke barazuar kovën e vet me atë të myslimanëve të tjerë?”*. Pra, që do ta blejë pusin dhe që do të mund të përfitonte prej tij në mënyrë të barabartë me myslimanët e tjerë.

Osmani (r.a.), kërkoi menjëherë që ta blinte këtë pus. Mirëpo hebreu nuk pranoi. Më në fund arriti të merrte gjysmën e të drejtës së pusit duke përdorur një ditë myslimanët dhe një ditë hebreu. Më vonë ia doli mbanë ta blinte të gjithin. Profeti (a.s.)

9. Shih. Hz. Osman Zinnureyn, Ramazanoğlu Muhamud Sami, sf. 163.

10. Tirmidhi, Menakib, 18/3700; Ahmed, V, 63

e pyet Osmanin (r.a.):

“A e dhuron atë (pusin) me qëllim që njerëzit të pijnë ujë prej tij?”. Ndërsa ai me gjithë zemër e dhuroi pusin. Kështu që, prej mirësisë së Osmanit (r.a.), myslimanët e Medines shpëtuan nga vuajtjet për ujë.

Sipas një transmetimi, për të marrë ujë nga pusi që vetë dhuroi, Osmani (r.a.) priste në radhë si gjithë të tjerët. Përsëri sipas këtij transmetimi, për shkak të sakrificës që tregoi Osmani (r.a.) u zbrit ky ajet i Kuranit Famëlartë:

**“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!”** (El-Fexhr, 27-30)

Me përhapjen e shpejtë të Islamit dhe me shtimin e numrit të atyre që vinin në Medine, Mesxhidi Nebevi (Xhamia e Profetit) u bë e pamjaftueshme. Për këtë shkak, një pjesë e njerëzve kishte ngritur çadra përreth mesxhidit. Prandaj Profeti ynë (a.s.) urdhëroi e tha:

*“Ai që e zgjeron mesxhidin qoftë edhe një krah hyn në xhenet.”*<sup>11</sup>

Osmani (r.a.) tha:

“O Resulullah! Të qoftë falë pasuria dhe malli im. Zgjerimin e mesxhidit e marr unë përsipër.” Lidhur me këtë zbriti ky ajet i Kuranit:

**“Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin**

11. Rreth 75 cm.

*namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.”* (Et-Teube, 18)<sup>12</sup>

Aliu, kur kërkoi të martohej me Fatmën, e pati dërguar blindën e tij në pazar për shitje. Paratë e blindës do i përdorte për shpenzimet e dasmës. Osmani e njohu menjëherë blindën e Aliut në pazar. E pyeti tellallin se sa kërkonte i zoti i asaj blinde dhe me të mësuar se kërkonte katërqind dirhem mori blindën dhe i dorëzoi paratë. Më pas i shtoi dhe katërqind dirhem të tjerë dhe ia dërgoi Aliut duke i thënë:

Kjo blindë nuk i përket askujt tjetër veç teje. Ndërsa këto katërqind dirhem shpenzoi për dasmën dhe na fal këtë herë.

Është shumë domethënëse edhe ngjarja e mëposhtme, e cila pasqyron moralin e lartë të atyre shpirttrave ndriçues:

Në kohën e halifatit të Ebu Bekrit, qe një periudhë kur në Medinë u shfaq dukshëm skamja. Në atë kohë, nga Shami erdhi një karvan i Osmanit prej njëqind devesh të ngarkuara me grurë. Kur e panë karvanin, vrapuan menjëherë të gjithë për të blerë grurin. Madje kërkuan të jepnin edhe shtatë dirhem për një masë gruri që kush-tonte një dirhem. Osmani ndërhyri dhe tha: Jo! Ka të tjerë që japin më shumë, do t’ua shes atyre.

Të pikëlluar, ashabet u

**“Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.”**

**(et-Teube, 18)**

larguan dhe shkuan te Ebu Bekri për t’u ankuar. Ebu Bekri e kuptoi dhe tha: - Mos mendoni menjëherë keq për Osmanin... Ai është dhëndëri i të Dërguarit të Allahut dhe miku i tij në Xhenetin Me’va. Me sa duket, ju e keni kuptuar gabim fjalën e tij. Më pas, të gjithë së bashku shkuan te Osmani. Ebu Bekri iu drejtua Osmanit:

- O Osman! Ashabet janë mërzitur nga një fjalë e jotja. Osmani vijoi:

-Po, o halifja e të Dërguarit! Ata japin shtatë për një, por ka të tjerë që japin shtatëqind për një Ne ua dhamë grurin atyre që dhanë shtatëqind për një.

Më pas grurin e ngarkuar në njëqind deve ua shpërndau të varfërve në Medinë për hir të Allahut. Ndërsa njëqind devetë i bëri kurban. Ebu Bekri u gëzua shumë për këtë gjest të tij dhe e puthi Osmanin në ballë, duke i thënë: E kam pikasur që në fillim se ashabet nuk e kishin kuptuar domethënien e fjalës tënde.

## I DASHURUARI I KURANIT

Në themel të këtij morali të lartë të Osmanit qëndron padyshim frymëzimi që ai kishte marrë nga i Dërguari i Allahut dhe Kurani Famëlartë. Me të vërtetë Osmani ishte plotësisht një **i dashuruar i Kuranit**.

Tri gjëra më janë mësuar t’i dua në këtë botë: të ushqej të uriturit, të vesh këmbëzbathurit dhe të lexoj Kuran, - tha Osmani, i cili ndërkohë realizoi

<sup>12</sup> Njëk. Hz. Osman Zinnureyn, Ramazanoğlu Muhamud Sami, sf. 45.



një nga detyrat më madhore. Ai mori Kuranin e mbledhur në kohën e Ebu Bekrit dhe, në kohën e halifatit të vet e radhiti sipas sureve, duke e shumëfishuar dhe shpërndarë. Në vitin 30 hixhri ai u shpërndau qendrave të rëndësishme nga ky mus'haf. Kështu, ai u dha fund të gjitha dyshimeve që mund të dilnin në atë kohë për Kuranin.

Osmani e kishte bërë zakon që çdo mëngjes, me t'u ngritur nga shtrati, të puthte Kuranin. Thoshte: Nuk dua të kaloj qoftë dhe një natë të vetme apo edhe një ditë pa lexuar librin e Allahut. (Kenz, I, 225). Kështu, si rezultat i leximeve të shpeshta që bënte, i qenë vjetëruar dy Kurane.

Abdurrahman bin Osman et-Tejmi thotë:

Një natë, Osmani e përfundoi namazin duke e bërë hatim Kuranin në një natë.

### ZUHD DHE MODESTIA

Ja pra, të tilla ishin parimet e veçanta të jetës, të cilat kanë bërë që sahabet e bekuar të shndërrohen në yje të qiellit shpirtëror. Me gjithë mundësitë materiale që kishin, ata bënë një jetë modeste duke u përpjekur t'i përngjanin të Dërguarit të Allahut.

Osmani vishte rroba mjaft të thjeshta dhe të lira. Në mesditë flinte në tokë dhe kur ngrihej i ngeleshin gjurmët e gurëve. Ndërkohë që njerëzve u jepte ushqimet më të këndshme, në shtëpi s' kish gjë tjetër veçse uthull e vaj ulliri. Ditën agjëronte, ndërsa netët i kalonte me namaz. Me mendimin

se natën është kohë pushimi për shërbyesit, netëve e përgatiste vetë ujin për abdest, për të mos i shqetësuar ata.

Ebu Furat tregon një ndodhi që transmeton përpikmërinë e madhe të Osmanit i cili ishte tepër strikt në respektimin e të drejtës së njeriut.

Osmani i drejtohet robit të tij duke i thënë:

Një herë e një kohë të kam tërhequr veshin, e tani e ke radhën ti. Robi i tij e kapi për veshi. Osmani i thoshte skllavit shtrëngoje mirë biri im! Hakmarrja është në këtë botë, në ahiret nuk ka.

### DËSHMORI I PAFJALË

Halifati i Osmanit, ka kaluar shumë begatshëm edhe nga pikëpamja e çlirimeve. Ishin marrë vende të tilla si Qiproja, Trablus, Taberistani, Ermenistani, kishte nisur tregtia detare, ishin organizuar udhëtime në ishujt Rodos, Maltë e Stamboll. Fortifikimi më i madh i Bizantit ishte asgjësuar në detin Mesdhe. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, thesari i popullit dhe i shtetit ishte pasuruar.

Me rritjen e pasurisë, në shpirtin e disave ishte bërë e dukshme dëshira për anën materiale të kësaj bote. Shpifjet e munafikëve, rrënjët e të cilëve ishin në qëndrimin e Jahudinëve, sikurse ishte rasti i Abdullah bin Sebe, kishin rrethuar botën Islame. Osmani ish rrethuar në mënyrë të atillë në shtëpinë e tij në Medinë nga rebelët e

mbledhur prej zonave të ndryshme, sa as ujë për të pirë s'kishte, sepse pusin e ujit e kishte blerë vetë por ua kishte lënë myslimanëve ta shfrytëzonin. Ja si e tregon halifeja i myslimanëve periudhën e vështirë në të cilin ndodhej dhe çastet e vështira që kishte jetuar përballë rebelëve, duke theksuar shpifjet që do mund të dilnin më vonë.

Unë jam si babai i fëmijëve që nuk e dëgjojnë fjalën e të atit për sa kohë që ai jeton, dhe të cilët janë aq të prapë sa edhe kur është duke vdekur nuk e lënë të qetë.

Osmani nuk i lejonte sahabet të derdhnin gjak për shkakun e tij. Ata i kishin kërkuar të përdornin forcën kundër kryengritësve, por ai u kishte thënë: Më mirë të vdes para se të derdhet gjak, se sa të vdes pasi është derdhur gjak për mua.

Ndonëse i këshilloi shumë herë rebelët, ai përsëri nuk arriti t'i bindte. Derisa një ditë, teksa ishte agjërueshëm dhe po lexonte Kuran në shtëpi, Osmani ra dëshmor, duke u vrrarë nga kryengritësit.

Gjaku i këtij dëshmori që i kish kaluar të tetëdhjetat, pikoi mbi ajetin kuranor që po lexonte:

**"... Allahu të mjafton përballë tyre. Ai dëgjon dhe sheh çdo gjë." (Bakare, 137)**

Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

*"Betohem në Allah se Osmani do të ndërmjetësojë për shtatëdhjetë mijë persona të ymetit*



*tim, që ata të hyjnë në xhenet." (Dejlemi, Firdeus, 4/360)*

Le t'u kushtojmë pak vëmendje këtyre fjalëve domethënëse e të urta të Osmanit, i cili është një ndër sahabet më të ndershëm, duke shpresuar kështu që të përfitojmë sado pak dituri dhe urtësi nga bota e tij shpirtërore:

### FJALË TË URTA NGA OSMANI

*Njeriu më i mençur është ai, i cili i kërkon llogari vetvetes, që arrin ta menaxhojë mirë atë, që punon për jetën e përtejme dhe që do të meritojë dritën e Allahut në errësirën e jetës së varrit.*

*Le të frikësohet çdo njeri nga ringjallja e tij si i verbër, megjithëse sytë e tij kanë parë në këtë botë! Kush kupton nga urtësia, i mjafton një fjalë e urtë. Të shurdhrit shpirtëror nuk e dëgjojnë të vërtetën.*

#### **Pesë shenja të njerëzve të devotshëm:**

1. Të qendruarit së bashku me ata përpiqen në çështjet fetare.

2. Pastrimi i nefsit dhe kontrollimi i gjuhës.

3. Të qenurit i vetëdijsëm se çdo gjë që i përket kësaj bote dhe që sjell harresën e Zotit është diçka e dëmshme që të shpie në humbje, ndërsa çdo gjë nga feja e tij është pasuria e vërtetë.

4. Të mos e mbushë stomakun me gjëra të dyshimta, qofshin këto edhe hallall (të jetë sa më i përpiktë dhe i kënaqur në këtë drejtim).

**“...Jeta e kësaj bote  
s’është gjë tjetër veçse një  
vend mashtrimi.”**

**(Ali Imran, 185)**

5. Të mendojë se të gjithë njerëzit kanë shpëtuar, ndërsa vetëm ai ka humbur.

Besimtari i vërtetë i frikësohet gjashtë gjërave:

a. Frika se mos humb besimin.

Në ajet thuhet: **“Zoti ynë! Mos na i përthyej zemrat pasi të na udhëzosh në rrugë të drejtë!”** (Al-i Imran, 8)

**“O ju që besuat! Frikësohuni Allahut sikur të garoni me të dhe jepni shpirt vetëm si myslimanë!”** (Al-i Imran, 102)

b. Frika se në ditën e gjykimit do t’i shpalosen nga melekët gjërat që do ta turpërojnë. Në ajet thuhet: **“Dhe pikërisht atë ditë, me njoftimin e Zotit i tregon të gjitha ndodhitë.”** (ez-Zilzal, 4-5)

c. Frika se mos puna e bërë shkon dëm për shkak të shejtanit. Në Kuran thuhet: **“Iblisi tha: ‘Zoti im, për shkak se më përzure (më largove) unë do t’ua zbukuroj të këqijat atyre sa të jenë në tokë dhe të gjithë ata do t’i largoj nga rruga e drejtë. Përveç robërve të tu, të cilët i ke bërë të sinqertë.”** (el-Hixhr, 39-40)

d. Frika se do ta gjejë meleku i vdekjes, Azraili, të papërgatitur në çdo çast. Në Kuran thuhet: **“Adhuroje Zotin tënd deri sa të afrohet vdekja!”** (el-Hixhr, 99)

Në hadith thuhet:

**Njeriu vdes ashtu siç ka jetuar dhe ringjallet siç ka vdekur!** (Muslim, Xhenet, 83; Munavi, V, 663)

Nisur nga kjo, edhe Osmani (r.a.) jetoi me Kuranin, e vuri atë në jetë dhe ra dëshmor bashkë me të.

e. Frika se mos e habit kjo botë deri në atë masë sa të harrojë ahiretin. Në Kuran thuhet: **“...Jeta e kësaj bote s’është gjë tjetër veçse një vend mashtrimi.”** (Al-i Imran, 185)

f. Frika se mos neglizhon dhikrin teksa merret me familjen e tij. Në Kuran thuhet: **“Ta dini që fëmijët dhe pasuria janë një provë për ju. Shpërblimi i madh është nga Zoti.”** (el-Enfal, 28)

**“Nuk ka dyshim se kjo botë është e përkohshme ndërsa përjetësia është në botën tjetër. Mos t’ju mashtrojë e përkohshmja duke ju shmangur nga e përhershëmja. Ju zgjidhni të përhershmen në vend të së përkohshmes. Bota është e fundme dhe kthimi pa rikthim është vetëm tek Allahu. Frikësojuni Atij.”** (Ibn-i Ebi Dunya, Mevsua, 1, 77)

6. Bëjeni menjëherë të mirën që keni në mendje sa është pa ju ardhur exheli.

Zoti na mundësoftë të veprojmë sipas këtyre këshillave plot urtësi, dhe të jemi pjesë e asaj besnikërie. Zoti na mundësoftë miqësinë e ngushtë dhe afrimitetin në ahiret, duke e qëndisur dashurinë e Tij në shpirtat tanë!

**Amin!**



*Ma. sci. Flamur Sofiu*

## Përkujdesja dhe edukimi i fëmijës në të drejtën Islame

**S**hpërthja el-hadanetu, në kuptimin etimologjik do të thotë përkujdesje, edukim, ndërsa në shkencën e fikut, me përkujdesjen dhe edukimin e fëmijës (**el-hadanetu**) kuptohet: “Edukimi dhe përkujdesja e fëmijës për atë që ka të drejtë të kryejë këtë obligim”. Përkujdesja dhe edukimi vlen për atë fëmijë, i cili nuk është në gjendje të dijë të dallojë të keqen dhe të mbrohet nga ajo, që nuk di të zgjidhë çështjen e ushqimit, pijes, veshmbathjes, pastrimit të trupit, pastrimit të rrobave etj. Pra, përkujdesja dhe edukimi i fëmijës (**el-hadanetu**) ka të bëjë vetëm për fëmijën, i cili nuk di të dallojë të mirën nga e keqja, si dhe për njeriun e çmendur, pavarësisht faktit nëse është në moshë të rritur apo jo.

Norma e përkujdesjes dhe e edukimit të fëmijës është diçka e domosdoshme, sepse lënia pas dore e

këtij obligimi do të shkaktonte dëmtimin e fëmijës. Përkujdesja dhe edukimi i fëmijës është obligim i domosdoshëm, ashtu siç është obligim furnizimi dhe mbrojtja e tij nga dëmet e jetës.

Përkujdesja dhe edukimi i fëmijës kërkon maturi, shkathësi, durim dhe moral të lartë. Nëse dikush lutet për t’i ardhur vdekja fëmijës, të cilin e ka nën kujdes dhe edukim, kjo përbën diçka të urreyer, ashtu sikundër është e urreyer që njeriu të lutet kundër vetes, kundër shërbëtorit dhe pasurisë së tij. Për këtë kemi si argument fjalët e Pejgamberit (s.a.v.s.): “Mos bëni dua kundër vetes tuaj, kundër fëmijëve tuaj, kundër shërbëtorëve tuaj, kundër pasurisë tuaj...” (Muslimi dhe Ebu Davudi). Ebu Musa nga Ibn Abbasi (r.a.) transmeton: “Vërtet Eus bin Ibadet el-Ensariu kishte hyrë te Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe i kishte thënë: “O Pejgamberi i

Zotit, unë kam shumë vajza, e lus Allahun që t'u sjellë vdekjen atyre”, e Pejgamberi (s.a.v.s.) u përgjigj: “Mos u lut kundër atyre, se vërtet në vajzat ka begati (bereket), ato janë bukuri e begative, janë ndihmuese në fatkeqësi dhe sëmundje, ato janë të vlefshme në tokë dhe furnizimi i tyre (rrisku) është te Allahu”.

*Kush meriton të kujdeset dhe edukojë atë që ka nevojë për përkujdesje dhe edukim.*

Në lidhje me faktin se kush e meriton më shumë të përkujdeset për fëmijën dhe të merret me edukimin e tij, juristët islamë (*fukahat*) i japin përparësi disa individëve ndaj tjerëve, gjë të cilën e bëjnë vetëm e vetëm për të mbrojtur sa më shumë interesin e atij që ka nevojë për përkujdesje dhe edukim. Kështu, mes meshkujve dhe femrave, ata mendojnë se femrat e meritojnë më së shumti përkujdesjen dhe edukimin e fëmijëve, sepse janë më të dhembshme, dinë të edukojnë më mirë, janë më durimtare për ta zbatuar këtë obligim e në të njëjtën kohë janë më të afërta me fëmijët.

Por edhe mes grave ka që e meritojnë më tepër se të tjerat kryerjen e një obligimi të tillë.

**1. Nëna e meriton më shumë përkujdesjen dhe edukimin e fëmijës.** Nëna nuk mund ta kryejë këtë obligim nëse ajo është *murtede* (renegate), mëkatore e madhe si, f.v., nëse ajo është prostitutë, vjedhëse etj., sepse nëse ajo jepet pas veprimeve të tilla, mund të ndodhë që fëmija të ketë probleme në të gjitha aspektet e zhvillimit të tij. Dhënia përparësi nënës në *el-hadanetu* është sunet i Pejgamberit (s.a.v.s.). Transmetohet se ka ardhur një grua te Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe i ka thënë: “O Pejgamber i Zotit, vërtet për birin tim barku im ka qenë vendi ku e kam bartur, gjinjtë e mi kanë qenë ushqim për të, këmbët e mia kanë qenë prehje për të, ndërsa babai i tij më ka shkurorëzuar dhe dëshiron të ma marrë!”. E Pejgamberi (s.a.v.s.) u përgjigj: “Ti e meriton më shumë fëmijën, përderisa nuk je martuar (me dikë tjetër).” (Ebu Davudi, Bejhekiu dhe Hakimi) Po ashtu, në lidhje me këtë çështje Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: “Atë që ndan fëmijën nga nëna e vet, Allahu do ta ndajë prej dashamirëve të tij në ditën e kiametit.” (Ahmedi, Termidhiu dhe Hakimi)

**2. Nëna e nënës (gjyshja).** Gjyshja meriton ta zba-



tojë *el-hadanetu* për shkak të afërsisë që ka me nënën e fëmijës në aspektin e trashëgimisë dhe të lindjes. Pra, gjyshja e meriton përparësinë në zbatimin e *el-hadanetu*, nëse ajo është e aftë dhe gatshme për këtë. Në rast të kundërt ajo nuk meriton ta marrë këtë përgjegjësi.

**3. Nëna e babait.** Nëse ka vdekur nëna e nënës (gjyshja), apo nuk ka qenë gjallë, atëherë ajo që e meriton më shumë zbatimin e *el-hadanetu* është nëna e babait.

**4. Motra.**

**5. Motra prej nëne.** Motra e fëmijës prej nënës ka më shumë përparësi në përkujdesje dhe edukim se sa motra prej babait.

**6. Motra që e ka prej babait.**

**7. Motra e nënës (tezja) prej të dy prindërve.**

**8. Tezja e nënës.**

**9. Tezja e babait.**

**10. Vajzat e motrës.**



#### 11. Vajzat e vëllait.

#### 12. Halla.

Nëse nuk ka prej grave, të cilat u përmenden për përkujdesje dhe edukim, atëherë, këtë obligim duhet ta marrë ndonjëri prej burrave që **radhitën sipas të drejtës në trashëgimi dhe sipas afërsisë së gjakut**, por me të cilët ai fëmijë nuk ka të drejtë martesë. Sipas të drejtës në **trashëgimi** janë:

1. baballarët, gjyshërit e kështu më radhë,
2. vëllezërit dhe bijtë e tyre,
3. xhaxhallarët, pastaj bijtë e xhaxhallarëve.

Nëse këta mungojnë, atëherë radha u bie burrave që janë të afërt sa i takon lidhjes së gjakut, të cilët janë:

1. Vëllai prej nëne.
2. Biri i vëllait.
3. Xhaxhai që është prej dy prindërve.
4. Xhaxhai që është vetëm prej nënës.
5. Xhaxhai që është vetëm prej babait.
6. Daja që është prej prindërve të njëjtë.

#### 7. Daja vetëm prej nëne.

*Kushtet që duhet të plotësohen për t'u zbatuar (për përkujdesjen dhe edukimin e fëmijës) janë:*

1. **Kujdestari apo kujdestarja, të jetë i mençur.** Nuk lejohet që t'i besohet përkujdesja dhe edukimi i fëmijës njeriut që është i matufosur apo i çmendur, persona të tillë janë të paaftë për ta kryer këtë detyrë.

2. **Kujdestari-kujdestarja të jetë në moshë madhore.** Personit që nuk e ka arritur moshën madhore, qoftë edhe i aftë për të dalluar të mirën nga e keqja, nuk i besohet kryerja e kësaj detyre.

3. **Aftësia për të edukuar atë që meriton përkujdesje.** Nuk i lejohet përkujdesja burrit apo gruas që nuk është në gjendje ta edukojë personin që ka nevojë për përkujdesje. Për shembull, i verbëri nuk ka mundësi ta edukojë personin që ka nevojë për përkujdesje. Po ashtu nuk lejohet ta marrë përsipër një detyrë të tillë as i sëmuri rëndë që vuan nga ndonjë sëmundje, e cila e pengon të angazhohet në edukimin e personit në nevojë etj.

4. **Besueshmëria dhe morali.** Është e domosdoshme që ai i cili ka marrë përsipër obligimin për përkujdesjen dhe edukimin (*el-hadanetu*), të jetë patjetër prej njerëzve të besueshëm, por edhe të pajisur me virtyte e moral të mirë. Personi, i cili e ka marrë përgjegjësinë për përkujdesje dhe edukim nuk duhet të jetë prej mëkatarëve të mëdhenj e as njeri i pabesë. Në këtë rast, nuk kushtëzohet që personi, i cili ka marrë përgjegjësinë për përkujdesje dhe edukim të jetë edhe i drejtë.

5. **Kujdestari të jetë mysliman.** Rreth këtij kushti dijetarët islamë kanë divergjencë. Disa mendojnë se ky kusht nuk është i domosdoshëm dhe konsiderojnë se nuk është e thënë që kujdestarja të jetë myslimane, por mund të jetë ithtare e librit, *mushrike* (politeiste), pavarësisht nëse është apo jo nëna e fëmijës. Si argument merret rasti i Pejgamberit (s.a.v.s.), i cili e ka lejuar fëmijën të bëjë zgjedhje mes babait mysliman dhe nënës *mushrike* (politeiste), për të vendosur se cili do të kujdeset për edukimin e tij. Fëmija një herë ka anuar kah nëna, për çka Pejgamberi (s.a.v.s.) u lut: “O Zot, udhëzoje këtë fëmijë, i cili u kthye nga babai”. Ndërsa disa nga dijetarët mendojnë se ky kusht është i domosdoshëm, duke ngulmuar se fëmija nuk mund

të lihet nën përkujdesjen dhe edukimin e një jomyslimani apo të një jomyslimaneje.

**6. Kujdestarja të mos jetë e martuar.** Kur kujdestarja martohet me ndonjë të largët që nuk është i afërm i fëmijës, atëherë ajo nuk mund të merret më me përkujdesjen dhe edukimin e fëmijës. Mirëpo, nëse ndodh që kujdestarja të martohet me ndonjë të afërt të fëmijës si, fjala vjen me axhën e fëmijës, atëherë mund të vazhdojë të merret me përkujdesjen dhe edukimin e fëmijës. Si argument për këtë mund të përmendim hadithin e Pejgamberit (s.a.v.s.). Një grua dhe i ka thënë Pejgamberit (s.a.v.s.): “O Pejgamberi i Zotit, vërtet për birin tim barku im ka qenë vendi ku e kam bartur, gjinjtë e mi kanë qenë ushqim për të, këmbët e mia kanë qenë prehje për të, e babai i tij më ka shkurorëzuar dhe dëshiron të ma marrë!” E Pejgamberi (s.a.v.s.) u përgjigj: “Ti e meriton më shumë atë, përdërisa nuk je martuar (me dikë tjetër)” (Ebu Davudi, Behjekiu dhe Hakimi).

**7. Kujdestari-kujdestarja të jenë të lirë.** Robi apo robëresha nuk kanë mundësi të zbatojnë obligimin e përkujdesjes dhe të edukimit të fëmijës, ngase ata janë të ngarkuar me obligimet e zotërisë.

*Kushtet që duhet të plotësojë personi, i cili ka nevojë për përkujdesje dhe edukim:*

Personi që ka nevojë për përkujdesje dhe edukim duhet të plotësojë këto kushte:

1. të ketë nevojë për përkujdesje dhe edukim, për shkak të të qenit i pa aftë të mbrohet prej të këqijave dhe dëmeve,
2. të jetë foshnje,
3. të jetë i matufosur,
4. të jetë i çmendur.

Përsa i përket personit që ka hyrë në moshën madhore e që është i aftë ta mirëmbajë veten, ai nuk meriton përkujdesje.

#### **Pagesa për përkujdesjen dhe edukimin e fëmijës**

Pagesa për përkujdesjen dhe edukimin e fëmijës është e barabartë me pagesën për gjidhënie. Nëna nuk meriton të paguhet për përkujdesjen dhe edukimin e fëmijës, e nëse është e shkurorëzuar dhe ende është në kohën e pritjes. Po ashtu, asaj nuk i takon pagesa ngase ende furnizohet nga burri i saj. Kur të kalojë koha e pritjes pas shkurorëzimit, atëherë asaj i takon



shpërblimi, siç i takon edhe mëndeshës (gjidhënësës me pagesë).

Është obligim për babanë që t’ia paguajë kujdestarit vendstrehimin, por edhe shërbëtorin nëse kujdestari i fëmijës është i nevojshëm për të, kuptohet me kushtin që babai të ketë mundësi materiale.

#### **Përfundimi i kohës së përkujdesjes dhe të edukimit të fëmijës**

Përkujdesja dhe edukimi i fëmijës mbaron atëherë kur ai bëhet i aftë dhe arrin moshën kur mund të jetë i pavarur dhe mund ta mirëmbajë veten, pra të ushqehet vetë, të vishet, të pastrohet etj.

Hanefintët mendojnë se kur fëmija arrin moshën shtatëvjeçare, ai nuk është nevojtar më për përkujdesje. Mendimin e tyre e mbështesin në hadithin e Pejgamberit (s.a.v.s.):

*“Urdhëroni fëmijët tuaj që të falin namazin në moshën shtatëvjeçare”.* Disa nga hanefitet mendojnë se fëmija ka nevojë për përkujdesje deri në moshën nëntë vjeçare.

# Vetëllogaria

Vetëllogaria të shtyn në rishikimin e veprimeve dhe punëve që ke kryer duke na mundësuar që të bëjmë vepra të mira dhe duke na ndihmuar t'u shmangemi veprave dhe punëve të këqija. Ajo e bën njeriun të dallojë atë që është në të mirë të tij dhe atë që është në dëm të tij. Marrja në llogari e vetvetes është shumë e rëndësishme për vazhdimësinë e ndjenjës së imanit dhe përtëritjen e tij. Allahu (xh.sh.) thotë: *“O ju që besuat. Kini parasysh frikën, ndaj dhe le të shikojë njeriu se çka ka bërë për nesër.”* (Hashër, 18)

Në të vërtetë mosmarrja në llogari e vetvetes është shkak i zhytjes së njeriut përherë e më shumë në gjynahe. Jobsimtarët kënaqen me jetën e kësaj bote, duke mos e llogaritur faktin se një ditë do të dalin para Allahut (xh.sh.). Allahu i madhëruar urdhëron: *“Ata ishin që nuk ua merrte mendja se do të japin llogari.”* (Nebe 27)

**Ibn Kajimi thotë:** *“Shkatërrimi i shpirtit vjen si pasojë e lënies pas dore të vetëllogaritjes, pajtimit me kërkesat e epshit dhe praktikimit të tyre.”* Prandaj myslimani duhet të gjejë patjetër kohë për t'u vetmuar, që të shikojë se ku gjendet dhe çfarë ka përgatitur për të nesërmen (Ditën e Gjykimit).

Vërtet, ai që i kërkon llogari vetvetes e zbulon gabimin, ndërsa kush zbulon gabimin e vet pendohet dhe i kërkon falje Allahut (xh.sh.). Kush pendohet dhe kërkon falje prej Tij, ka pasur fatin të përjetojë mirësinë më të madhe në këtë jetë.

**Umer ibën Hatabi (r.a.)** i ka shkruar njërit prej nëpunësve të tij: *“Bëja llogaritë vetes kur je në siguri, përpara se ta llogaritësh kur je në vështirësi, sepse ai që e bën llogarinë e*

*vetes kur është në siguri para se të jetë në vështirësi, do ta kenë zili edhe të tjerët për gjendjen e mirë në të cilën do të jetë.”*

Besimtari është edukatori i vetes së tij. Ai e llogarit veten e tij për Hir të Allahut. Me të vërtetë që dënimi në ditën e gjykimit do të jetë më i lehtë për ata të cilët e kanë llogaritur veten në këtë dynja, e do të jetë i vështirë për atë njeri që e ka nënvleftësuar këtë të vërtetë. Një nga gjërat më të shkëlqyera është vetëllogaria në mënyrë të vazhdueshme, sepse *“I suksesshëm është ai person që ia bën llogarinë vetvetes dhe punon për botën tjetër, kurse i paafte është ai që ndjek epshin e tij”*.

**El Hasen ka thënë:** Robi do të vazhdojë në të mira, derisa të ketë këshillues brenda vetes së tij dhe preokupimi i tij të jetë vetëllogaria.

**1. Kërkojini llogari vetes për fjalët që thoni.** Allahu (xh.sh.) urdhëron: *“E ai nuk thotë ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij një mbikëqyrës i gatshëm për t'i regjistruar ato.”* (Kaf: 18.) Përsëri Allahu i madhëruar në Kuran urdhëron: *“Kurse mbi ju ka rojtarë, shkruet të ndershëm (te Allahu). Ata e dinë se çfarë punoni.”* (Infitar: 10-12.)

**2. Kërkojini llogari vetes tuaj për punët që bëni.** Allahu (xh.sh.) thotë: *“E kush punon ndonjë të mirë që peshon sa grimca, atë do ta gjejë, dhe kush punon ndonjë të keqe që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.”* (Zelzele: 7-8.)

## **Disa dobi nga llogaritja e vetvetes**

**1.** Vërejtja e mangësive të vetes, sepse ai që nuk i shikon mangësitë e tij nuk ka mundësi t'i largojë ato nga vetja.

**2.** Pendimi, keqardhja dhe kapja e asaj që të ka ikur në kohën e duhur.



*“Bëjani llogaritë vetes suaj para se t’ua bëjnë të tjerët.”*

*(Omer ibn Hatab)*

4. Përrulla e robit dhe nënshtrimi i tij para Zotit (xh.sh.).

**Ibn Mes’udi (r.a.)** transmeton: I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) ka thënë: “Nuk ka rob në ditën e Kijametit që s’do të pyetet për pesë gjëra:

1. Për jetën e tij, se si e ka kaluar.
2. Për rininë e tij, se për ç’ka e ka shfrytëzuar.
3. Për pasurinë e tij, se si e ka fituar dhe ku e ka shpenzuar atë.
4. Për diturinë se ç’ka ka punuar me të.

**(Tirmidhiu) Ebu Bekri, (r.a.)** e kapte gjuhën e vet dhe thoshte: “Kjo është ajo, e cila më ka ballafaquar me ballafaqimet!!” Dhe qante shumë.

**Ali ibën Ebu Talib (r.a.)** ishte nga ata që qante shumë, frikësohej dhe llogariste veten e tij. Frika e ti shtohet edhe më shumë nga dy gjëra: Shpresa e gjatë dhe pasimi i epsheve (dëshirave). Ai ka thënë: “Shpresa e gjatë të bën të harrosh ahiretin, ndërsa pasimi i epsheve të pengon nga pasimi i të vertetës.”

**Malik ibën Dinar ka thënë:** “Allahu e mëshiroftë robin i cili i thotë vetes: “A nuk je ti që ke bërë këtë? A nuk je ti që ke bërë atë?” Pastaj e shtrëngon atë, e kap fort dhe i vë detyrë Librin e Allahut, i cili bëhet udhëheqës i saj.”

**Një njeri ankohet për djalin e tij tek Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të.**

Kur Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, ishte udhëheqës i myslimanëve, tek ai vjen një person dhe i ankohet se i biri nuk i bindej dhe nuk e dëgjonte. Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, e thirri djalin dhe e qor-

toi për mosdëgjueshmërinë ndaj babait, duke i kujtuar obligimet e fëmijës ndaj prindit të tij.

Djali i tha:

-O emiri i besimtarëve, a nuk ka edhe prindi obligime ndaj fëmijës?

Omeri thotë:

-Po, gjithsesi!

Djali pyet:

-Cilat janë ato, o udhëheqës i besimtarëve?

Omeri thotë:

- T’i zgjedh një emër të mirë, t’ia mësojë Kuranin...

Djali i thotë:

-O udhëheqës i besimtarëve, babai im nuk e ka bërë asnjërin, emri im ka kuptim të keq dhe nuk më ka mësuar nga Kurani as edhe një shkronjë.

Omeri iu kthye prindit dhe i tha: “Erdhe të më anko-hesh për mosbindje të fëmijës, kurse ti para kësaj nuk iu binde atij. Kështu që ti u solle keq me të para se ai të sillet keq me ty.”

**Në gëzohemi me ditët që kalojnë,**

**por çdo ditë që kalon, na afron tek vdekja**

**Vepro për veten tënde para vdekjes, me përpjekje, sepse fitimi dhe humbja janë në punën tënde.**

**Omer ibn Hatabi (r.a.) ka thënë:**

*“Bëjani llogaritë vetes suaj para se t’ua bëjnë të tjerët.”*

# Kurani si terapi

Ma. Artur Tagani

"**T**në nuk të kam thënë asnjëherë se Kurani është një libër i gabuar. Por ti, ngaqë je në gjendje prej të vdekurit, nuk mund ta kuptosh atë. Muhamedi u bashkua me tërësinë. Ishte një pikë, u bë oqean. Në Hira kishte një festë, sepse Muhamedi u ngjit në pikën më të lartë që mund të ngjitet një njeri, në zenit. Dhe e mori atë, dhuratën e madhe. Ai ishte në zenit. Ti pa e përjetuar atë gjendje që u përjetua në Hira, nuk mund ta kuptosh as Kuranin e as Muhamedin. Kurani nuk është gabim, Kurani është i drejtë dhe i vërtetë... Gjithçka është e varur nga ty... Mirëpo ti, ngaqë nuk e ke zbuluar Muhamedin që ke brenda, e mban atë, nuk e jeton. Mos e mbaj, por jetoje, shijoje."

Osho, "Rruga e Mistikës"

Kohët e fundit janë bërë disa studime lidhur me energjitë pozitive dhe negative, lidhur me valët që përhap njeriu nga aura, lidhur me energjitë që përmbajnë fjalët, mendimet, madje edhe ndjenjat. Janë arritur rezultate interesante, të cilat lidhen drejtpërdrejt me temën tonë.

Një prej këtyre hulumtimeve është edhe ai që Prof. dr. Masaru Emoto-s ka bërë mbi ujin, mbi kristalet e ujit, punime të cilat i ka përmbledhur në libra të tij të ndryshëm.

Prof. Emoto ka punuar me mikroskop mbi kristalet e ujit për 12 vite me radhë dhe ka konstatuar se kristalet e ujit reagojnë ndaj faktorëve të jashtëm, si: fjala, shikimi, shkrimi, muzika, mendimi dhe ndjenjat. "Fotografitë që i janë bërë kristaleve të ujit janë të rregullta dhe të pastra," -shprehet Prof. Emoto, "por, në momentin kur artikullohet fjala "djall" pranë ujit, kristalet hyjnë në forma kaotike, deformohen; kur bëni që ato të dëgjojnë fjalë të bukura ose kur u thuhet lutje, pastërtia dhe përbërja gjashtëkëndëshe e kristaleve të ujit shfaqet më dukshëm."

Ai shprehet se uji reagon edhe sipas gradëve të ndryshme të vetëdijes, sikur i di të gjitha dhe merr formë sipas përbërjes së tyre. "Për shembull", -thotë ai, "kur pranë ujit lëshohet muzikë Heavy-metal, kristalet e ujit shpërbëhen. Gjithashtu, e

njëta gjë ndodh edhe kur përdoren fjalë fyese, banale pranë ujit. Madje, edhe kur mendohen gjëra negative, qoftë edhe kur je i shqetësuar, kristalet e ujit deformohen."

Të mos harrojmë se 70 % e trupit të njeriut është ujë. Imagjinoni çfarë ndikimesh marrim dhe japim ndaj njeri – tjetrit gjatë jetës së përditshme, kur përballemi me fjalë, mendime apo ndjenja negative.

"Si reagojnë kristalet e ujit kur u jepet të dëgjohet Kuran? Po ndaj 99 emrave të Allahut? Si reagon ndaj shkrimit "Bismil'lah" dhe çfarë forme kanë kristalet e ujit të Zemzemit?" -ishin një grup pyetjesh që i patën bërë Prof. Emotos, i cili ishte i ftuar në Ditën e Ujit, vitin e kaluar në Kolegjin Doga në Turqi. Përgjigjja ishte kjo:

"Kristalet shfaqeshin në një mënyrë aq të bukur, sa që fillova të mendoja nëse unë kam gjë lidhje me Islamin? Mos ka diçka për të më thënë Islami mua? Mos vallë po më tërheq brenda vetes kjo fe?!... Së shpejti, në Arabinë Saudite do botohet një libër i imi, aty do shikoni edhe fotografitë që i kam bërë ujit në këto raste"

Prof. Emoto, bashkë me ekipin e tij ka shkruar edhe në zonat arabe, Egjipt dhe Arabi Saudite, për të bërë testimet që sapo përmendëm. Ndër të tjera ata kanë bërë studime mbi myslimanin që bën dua, mbi njeriun që dëgjon ezanin dhe mbi njeriun që dëgjon Kuran. Për arsye të rezultateve që ai pati dhënë pas studimit, u popullarizua shumë emri i tij në shtetet Islame.

Në një prej stacioneve televizive të Kajros, ai ka shpjeguar gjatë ndikimin që shkakton në organizmin e njeriut dhe efektin që bën artikulli i Fjalës së Zotit, i ezanit dhe i Esmat'ul-Husnas (emrat e Zotit). Në fund, ai përdor një shprehje të tillë: "Feja Islame është besimi i drejtë, këtë e dëshmon edhe përputhshmëria që ka Fjala e Zotit me organizmin e njeriut."

Pasi pata lexuar këtë, të nderuar të ftuar, fillova ta mendoja

pak më ndryshe thënien e Profetit tonë të dashur: “**Kurani dhe besimtari janë binjakë**”. Ndoshta edhe në Kuran përmenden momentet më ekstreme të fuqisë së fjalës, së tingullit, zërit, p.sh. Fuqia e fjalës “**Kun!**” (Bëhu!), fuqia e zërit që do dalë nga suri (briri), aq i veçantë sa të bëjë të vdesë çdo njeri e pastaj të ringjallet çdo njeri. Dhe në suren Kamer, ajeti 31 thuhet: “**Ne u lëshuam kundër tyre një ushtimë, e ata u bënë si shproje vathi.**” Imagjinoni çfarë efekti mund të bëjë zëri, në ç’dimensione mund të hyjë.

Po, Kurani është i koduar tek çdo njeri, pa përjashtim. Shkenca do ta vërtetojë këtë gjë në kohët që do vijnë. Dhe, me sa duket, së shpejti do fillojmë ta dëgjojmë shpesh këtë gjë. Madje, një shkencëtar mysliman pakistanez, inxhinier i genetikës, në punimet që ka bërë rreth ADN-së ka konstatuar se në kodonet me numër **P19** të ADN-së gjendet e shkruar sureja Alak. Vini re, **P19**-a dhe sureja Alak. Është sureja e parë që ka zbritur dhe përbëhet nga **19 ajete**. Pa dashur të ndalemi në misterin e shifrës 19, po qëndrojmë në temën tonë.

Jo më kot ekspertët e valëve që përhap njeriu nga truri, kanë konstatuar se leximi i Kuranit në gjuhën autentike bën efekt që njeriu ta mbetet apo të kthehet në **valët alfa**, pra në valët e prehjes, qetësisë shpirtërore, duke ia transformuar **valët beta** që zakonisht përçon njeriu kur është i shqetësuar.

Pikërisht këtë gjë ka vërtetuar edhe studimi i klinikës “**Akbar**” në Florida. Studimi ishte planifikuar të realizohej mbi ajetet e Kuranit që flasin për mëshirën dhe kurimin. Ky studim do të bëhej në lidhje me ndikimin fizik të Kuranit dhe veçoritë kuruese të tij mbi organizmin, që do të vëzhgohej nga mjetet më moderne të kompjuterizuara. Për këtë studim u morën vullnetarisht persona jomuslimanë, të cilët nuk dinin arabisht, si dhe persona të moshave të ndryshme. Pra, eksperimenti do të kryhej mbi ata që nuk kanë asnjë njohuri në lidhje me ndikimin kurues të Kuranit. Së bashku me origjinalin arabisht të Kuranit, të eksperimentuarit dëgjuan edhe përkthimin e tekstit në anglisht. Në këtë kohë, leximi i Kuranit bëhej nga zëra të ndryshëm, duke u marrë kështu parasysh veçoria e ndikimit të zërit. Pas studimeve prej një viti, përfundimi që doli, me një fjalë të vetme ishte i jashtëzakonshëm, sepse te **97%** e vullnetarëve të eksperimentuar u vu re një rënie e theksuar e stresit, për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë në sistemin nervor autonom. Një arritje tjetër e eksperimentit ishte edhe mundësia e matjes së ndikimit të dëgjimit të Kuranit mbi trupin e njeriut.

Në këtë sukses, rolin kryesor e luajtën mjetet matëse kompjuterike, të prodhuara posaçërisht për këtë eksperiment. Matjet u bënë në saje të ndryshimit të potencialit elektrik të muskujve, përcimit elektrik të lëkurës, shpejtësisë së rrahjes së zemrës dhe ndryshimit të nxehtësisë së lëkurës.

Të gjitha këto ndryshime ndikuan në organet e tjera të trupit dhe në funksionet e tyre, duke bërë të mundur të përcaktohej kështu edhe ndikimi mbi sistemin nervor autonom. Gjithashtu, ky sistem tregoi ndikimin e Kuranit edhe në vënie në lëvizje të sistemit imunitar, duke bërë të mundur

parandalimin e kancerit dhe të shumë sëmundjeve tjera. Përfundimet e pjesës së parë të eksperimentit u paraqitën në “**Kongresin e 17-të të Mjekësisë Islame**”, në Misuri të Amerikës Veriore, ku rezultatet u pranuan me entuziazëm. Kështu, krahas burimit kurues shpirtëror doli në pah edhe forca shëruese, në drejtimin material dhe fizik e Kuranit. Duke mos i lënë vend rastësisë, këto makina nxirrnin çdo herë të njëjtin rezultat të ndikimit të Kuranit tek të eksperimentuarit, ndërsa ndaj dëgjimit të fjalës Allah u vu re se rritja e qarkullimit të gjakut, e rrahjeve të zemrës dhe nxehtësia e lëkurës u normalizuan. Vlen për t’u përmendur se dëgjuesit nuk dinin absolutisht asgjë rreth asaj që dëgjonin. Megjithatë, kur dëgjonin fjalën **Allah**, ndikimet ishin të menjëherëshme, ndryshe prej pjesëve të tjera.

Pikërisht këtë po konstaton prej kohësh edhe psikiatri holandez **Vander Hoven**, i cili tash tri vite me radhë punon mbi zërin, mbi gjuhën dhe analizon efektet e tyre tek njeriu. Vetë ai nuk është mysliman, por ka parashtruar se sistemi, muzikaliteti dhe vibracioni i fjalëve të ajeteve të Kuranit bën efekt shumë pozitiv, në veçanti tek ata që janë të sëmurë me zemër, me tension dhe me strese. Ai thotë se ata që lexojnë dhe dëgjojnë Kuran e largojnë veten lehtësisht nga shqetësimet psikologjike.

Për shembull, kur përmendet fjala **Allah**, thotë ai, germa e parë, germa “**elif/a**” është një zë që vjen nga respiratori dhe kontrollon frymëmarrjen. Ndërsa kur thuhet bashkëtingëllojra “**I**”, gjuha prek lehtë në qiellzën e sipërme, gjë e cila është një pauzë. Më pas, të bësh të njëjtin kontroll të frymëmarrjes, pra të thuash sërish “**la**” liron frymëmarrjen. Veçanërisht, kur thuhet germa e fundit që është “**h**” krijohet një lidhje mes mushkërive dhe zemrës, lidhje kjo që rregullon ritmin e zemrës. Në shëndetin njerëzor faktori më i rëndësishëm dhe më parësor është frymëmarrja. Hoveni ka konstatuar se me frymëmarrje të rregullt njeriu është mirë, ndërsa kur ka frymëmarrje të parregullt njeriu është i ekspozuar ndaj sëmundjeve. Në një qendër mjekësore, gjithnjë duke iu referuar gjendjes së pacientëve, ai i këshilloi ata që ta artikulojnë në sasi të caktuara fjalën “**Allah**”. Ai në këtë mënyrë bën terapi.

Fjala **Zot** nuk mund ta zëvendësojë fjalën “**Allah**” apo fjala “**lexo**” fjalën “**ikra**”. Përkthimi vlen për të kuptuar. Prandaj, vendin e origjinale nuk mund ta zëjë asgjë. Gjuha e nëndërgjegjës së njeriut është kuranishtja, pra gjuha e Zotit në një farë mënyre. Format janë në ADN-në tonë që prej kohës së Hz. Ademit (a.s.), të cilat ne i transformojmë në vibrime, pastaj i zgjojmë me Kuran...

Studime të tilla po bëhen në mbarë botën. Ndërsa, Kurani, në fakt ka 1400 vjet që po bën efektin kurativ tek njerëzit. Shkenca thjesht po i vë emër praktikës së myslimanëve.

Sot, më shumë se kurrë, ne duhet t’i rikthehemi këtij libri të mistershëm, Kuranit, ta lexojmë atë me këtë vetëdije: Kurani është shërim për brendësitë tona dhe mëshirë për besimtarin.



## Meleku i madh Xhebrail

**M**yslimanët besojnë në engjëjt si krijesa të krijuara prej drite, të cilët i binden Allahut dhe nuk e kundërshtojnë Atë për asgjë. Emrat e disave prej tyre përmenden në tekstet e shenjta të besimit mysliman, Kurani dhe hadithet e profetit Muhamed. Njëri prej engjëjve të thirrur me emër dhe i cili përmendet më shumë në tekstet e shenjta islame është engjëlli Xhebrail.

Emri i këtij meleku përmendet po ashtu në burimet e besimit hebre dhe atij të krishterë në formën Gabriel, që në shumë aspekte ka të njëjtattribute dhe funksione me melekun Xhebrail. Ashtu siç parashtrohet edhe në rastet e emrave të dy melekëve të tjerë Mikail dhe Azrail, edhe emri Xhebrail mban prapashtesën “il” që është forma arabe e emrit “el (oh)” që në hebraisht do të thotë zot, perëndi. Pjesa tjetër e emrit, xhibr, në hebraisht është në formën “geber” që do të thotë “i fuqishëm”. Kuptimi etimologjik i fjalës do të ishte “fuqia e Zotit”. Të dyja këto fjalë pranohen me burim nga gjuhët antike, më saktë nga gjuha suriane apo ajo keldane. Në formën Gabriel ajo është përfshirë në gjuhët antike greke dhe latine.

Në tekstet fetare hebreje dhe të krishtera Gabrieli konsiderohet njëri nga tre engjëjt më të rëndësishëm, emrat e të cilave përmenden në tekstet e shenjta të këtyre besimeve. Në Bibël emri i tij përmendet për të parën herë te kapitulli Daniel (8/15-26; 9/21-27), në Besëlidhjen e vjetër

(Dhjata e vjetër) dhe në librat apokrifë, Gabrieli përmendet si një nga gjashtë engjëjt që qëndrojnë së bashku me Perëndinë, në të majtë të Tij. Këtij engjëlli i shkojnë më së pari lutjet e shenjtorëve; ai është kujdestar për parajsën, është sundimtari i qiellit të parë, është një ndër ndërmjetësuesit më të rëndësishëm për tek Perëndia, ai shkatërron të këqijtë, hedh djajtë në ferr dhe drejton punët e forcave natyrore. (Tobi, 12/15; Enoku, 9/1, 9-10, 20/7, 40/1-9, 54/6, Hezekiel, 9/3, 10/2)

Në hebraizëm, Gabrieli është engjëlli që përcjell tek njerëzit e përzgjedhur të Perëndisë urdhërat dhe dëshirat e Perëndisë, dhe në të njëjtën kohë është shtylla e drejtësisë. Ai i shpuri Josefit të vëllezërit, bëri mundje me Jakobin dhe mori pjesë së bashku me engjëllin Mikael në varrimin e profetit Musa, sipas këtij besimi.

Në Dhjatën e re, për engjëllin Gabriel flitet dy herë, dhe në të dy rastet ai kryen funksionin e engjëllit që jep siharigë. Kemi rastin e profetit Zakaria, të cilin e njofton për lindjen e të birit Gjon dhe rastin e Maries kur e njofton se ka për të lindur Jezuin (Luka, 1/11-20, 26-38)

Gjuhëtarët arabë ndahen në dy grupime sa i takon pikëpamjeve në lidhje me burimin etimologjik të kësaj fjale. Shumica e tyre janë të mendimit se kjo fjalë rrjedh nga hebraishtja në arabisht, ndërsa disa prej tyre mendojnë se është një fjalë e pastër arabe, pasi është trajta e ndryshuar


e fjalës “xheberetullah”, që do të thotë “fuqia e Zotit”. Duket qartë që të dytët ofrojnë një shpjegim të sforcuar dhe ndonjë kuptim të ri leksikor, prandaj pikëpamja e të parëve duket më e vërtetë.

Në besimin mysliman Xhebraili është një ndër katër melekët më të rëndësishëm, i cili kryen funksionin e komunikuesit të shpalljeve hyjnore tek profetët. Megjithëse engjëlli i shpalljes në gjuhën arabe shprehet me fjalë të ndryshme, më të njohurat prej tyre janë Xhebrail, Xhebreil, Xhebril, Xhibrin dhe Xhibril.

Në Kuranin fisnik përmendet me pesë mënyra emërtimi, të cilat janë: Xhibril, Ruhulkudus (Shpirti Shenjtë), Ruhulemin (Shpirti Besnik), Ruh (Shpirti) dhe Resul (I dërguari). Sikurse tregojnë ajetet kuranore, engjëlli Xhebraili zotëron një fuqi të papërballueshme, një informacion sublim dhe të dhëna absolute. Ai gëzon respekt të veçantë nga “Poseduesi i fronit” (Zoti) dhe është një engjell, të cilit i binden edhe engjëjt e tjerë në mënyrë kategorike. (Nexhm, 53/5-6; Tekvir, 81/19-21) Xhebraili i qe shfaqur Merjemes në trajtën e një njeriu normal, i pati thënë se ai është i dërguari i Zotit dhe se vinte tek ajo për ta njoftuar se ka për të lindur një fëmi të dliurë si dhuratë të Zotit për të. (Merjem, 19/17-19) Meleku Xhebrail qe i ngarkuar t’i shpallte profetit Muhamed librin e shenjtë Kuranin. Profeti Muhamed e pati parë dy herë Xhebrailin në formën e tij si melek, njëherë në “horizontin e hapur” dhe herën e dytë në “sidretu’l-munteha”. Ai qe miku i Profetit dhe mbështetësi i besimtarëve kundër politeistëve. Ky engjell zbret natën e Kadrit së bashku me engjëjt e tjerë në botë dhe ka për t’u rreshtuar së bashku me melekët e tjerë ditën e gjykimit kur njerëzit do të japin llogari në mahsher.

Në hadithe Xhebraili është meleku që i sjell vahjin Profetit Muhamed, ia mëson atij Kuranin përmendësh, i mëson gjykimet e drejta për çështje të ndryshme dhe shfaqet para profetit, madje edhe para sahabeve në formën e një njeriu. Ai komunikon drejtpërdrejt me Zotin. (Musned, II, 267; III, 230; Buhari, Tevhid, 33) Për herë të parë ai u shfaq para profetit Muhamed në shpellën Hira për t’i komunikuar shpalljen e parë hyjnore, që përbëhej nga pesë ajetet e para të sures Alak e që janë “*Lexo! Me emrin e Zotit që të krijoi! Ai e krijoi njeriun nga gjaku ngjizur! Lexo, se Zoti yt është fisnik. Ai i mësoi njeriut të shkruajë me pendë. Ai i mësoi njeriut gjëra që nuk i dinte.*” (Alak, 1-5) (Buhari, Tabir, 1; Bedu’l-halk, 7; Muslim, Iman, 257, 258)

Meleku Xhebrail ia pati mbushur zemrën me “urtësi” profetit Muhamed përpara se të kryente miraxhin, duke bërë që trupi i tij të bëhej i lehtë si shpirti. Gjatë këtij udhëtimi mrekulli profeti Muhamed e pa Xhebrailin për të dytën herë në formën e tij si melek. Xhebraili e shoqë-



roi atë nëpër botën tjetër duke i sqaruar pamjet që profeti Muhamed shihte aty. (Buhari, Salat, 1, Bedu’l-halk, 6) Në mënyrë të veçantë gjatë muajit të Ramazanit Xhebraili vinte tek profeti Muhamed çdo mbrëmje për të dëgjuar prej tij ajetet kuranore që i ishin shpallur deri në atë moment. Vitin e fundit të jetës së profetit, ai kishte kërkuar nga Muhamedi (a.s.) që t’ia këndonte nga dy herë. (Buhari, Savm, 7) Në hadithet tregohet se Xhebraili i shndërruar në njeri pati marrë pjesë në disa beteja, madje e pati frymëzuar poetin Hasan bin Thabit kur ai thurte vargje në përgjigje të sulmeve fyese që politeistët mekas u drejtonin myslimanëve. (Buhari, Megazi, 17; Muslim, Fedail, 46, 47)

Në literaturën islame është shkruar një numër i madh traktatesh, veprash dhe librash që kanë lidhje me emrat e Xhebrailit, cilësitë, funksionet, pamjet prej njeriu që ai merrte dhe epërsinë e tij mbi melekët e tjerë, duke formuar kështu një literaturë të pasur në fushat e tefsirit, hadithit, historisë islame, tasavufit, kelamit dhe filozofisë islame. Ky shtjellim i gjerë i këtij meleku ka bërë që përveç emërtimeve në Kuran e hadith, në literaturën islame të krijohet një seri emërtimesh të tjera siç janë Ruhullah, Hadimullah, Ruhu’l-adham, Aklu’l-ekrem, Namusu’l-ekber, Aklu’l-faal, Vahibu’s-suver, Hazinu’l-kuds, Tavusu’l-melaikë.

Në literaturën islame gjendet shumë informacion në lidhje me melekun Xhebrail, por me përjashtim të të dhënave që gjenden në Kuran dhe në librat e saktë të hadithit, ky lloj informacioni është konsideruar prej dijetarëve myslimanë i dobët dhe në të shumtën e rasteve me prejardhje nga literatura izraelite.



## Kadri Prishtina dhe revista "Udha e së vërtetës"

Hoxhë Kadri Prishtina lindi në vitin 1878, kohë kur u themelua Lidhja Shqiptare e Prizrenit, platforma më e plotë politike kombëtare shqiptare, e cila qe një trajtim aq i mprehtë i çështjeve kombëtare shqiptare, duke përfshirë edhe zgjidhjet përkatëse që e ruajnë vlerën në ditët e sotme. Në vitin 1885 ai u regjistrua në shkollën fillore në Prishtinë. Pasi plotësoi shkollën fillore dhe atë plotore në Prishtinë, i ati Lutfullahu e regjistroi në gjimnazin turk në Shkup, ku spikati në mesin e shokëve për zgjuarsia dhe arritje në mësim.

Më pas, sipas traditës arsimore osmane, ai u regjistrua në Daru't-Tedris, të cilën e përfundoi për dy vjet. Këtu, përkrah edukimit fetar mësoi edhe pedagogji, psikologji, histori, letërsi etj. Në medresenë Fatih ai perfeksionoi njohuritë islame, në mënyrë të veçantë gjuhët arabe dhe perse, ndërsa turqishtja osmane qe gjuha e arsimit.

Në vitin 1903, në moshën 25 vjeçare, ai regjistrohet në fakultetin juridik të universitetit osman Darulfunun, nga ku diplomohet si jurist. Përkrah gjuhëve të lindjes ai mësoi edhe gjuhë perëndimore, si gjermanisht dhe frëngjisht.

Në periudhën 1904-1909 ai arrestohet dhe burgoset në Jedikule, ndërsa në periudhën 1909-1913 burgoset në Tokat. Një periudhë kohe punoi si këshilltar juridik në Samsun deri sa u deportua jashtë Turqisë, sipas një vendimi të Ministrisë së punëve të Brendshme.

Në vitin 1914 vendoset në Shkodër, ku fillimisht

punoi si avokat në gjyqe të ndryshme. Ndërkohë, me kushtet e reja para së cilave përballej kauza kombëtare pas luftës së parë botërore, ai së bashku me patriotë të tjerë shqiptarë, kryesisht kosovarë, krijoi në muajin nëntor të vitit 1918 komitetin "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës". Hoxhë Kadria ishte kryetar i këtij komiteti. Si organ i komitetit qe gazeta "Populli", me kryeredaktor patriotin vlonjat Salih Nivica, gazetë e cila u botua mes datave janar 1919 dhe gusht 1920.

Hoxhë Kadria u zgjodh deputet dhe mbuloi edhe postin e ministrit të drejtësisë.

Vdiq me datë 20 janar 1925, në moshën 47 vjeçare, moshë kur ai me fuqitë e tija mendore kishte shumë gjëra për t'i dhënë lëvizjes kombëtare shqiptare.

Gjatë viteve të punës si avokat në Shkodër, Hoxhë Kadria nxori gazetën e titulluar "Udha e s'Vërtetës" emri i të cilës të sjell ndërmend gazetën e shtypit intelektual mysliman në Stamboll, që titullohej "Sirati Mustekim". Revista u botua në shtypshkronjën "Ora" në Shkodër. Kjo qe revistë fetare-politike-letërore dhe kishte moton "Kërkimi i së vërtetës asht e drejta e mendjes".

Revista trajtoi kryesisht tema me natyrë informative fetare dhe u aktualizua duke trajtuar çështje të diskutueshme në realitetin shqiptar të Shkodrës. Në numrin e saj të parë, Hoxhë Kadria e shpreh me këto fjalë arsyen e ndërmarrjes së këtij botimi: "qëllimi kryesor asht me i këshillue bashkëfetarët t'onë, me ua mësuë këtyne parimet e thjeshta të fesë,..., mu munduem me i ba gjymtyrë të do-



*bishëm për jetën shoqërore e kombëtare t'onën...me i dhanë një zhvillim mendimtar krejt popullit në lamë të filozofisë, të sociologjisë e të politikës."*

Revista doli në tre numra. Numri i parë i revistës doli në muajin tetor të vitit 1923, i dyti dhe i treti respektivisht në muajt në vazhdim, në nëntor e dhjetor. Pra, Kadri Prishtina edhe në vitet e fundit të jetës së tij (dy vjet pas daljes së revistës ai vdiq) vazhdoi të kontribuonte në jetën e mendimit fetar, ashtu siç kontribuonte në jetën politike dhe kombëtare të vendit. Temat e trajtuara në revistë qenë me natyrë fetare.

Në numrin e tetorit ai botoi artikujt: Parathënie, **Nevoja e fesë, Feminizëm** dhe Lajme të ndryshme.

Në numrin nëntor ai botoi këto artikuj: Burimi i mendimit të besimit tek njerëzit, Profesionimi më i keq, Bisedë, Kuvendi konsistues, Letër e hapur.

Në numrin e dhjetorit ai botoi artikujt: Hytbe, Letër e hapur, I ndershmi Z. H. Kadri dhe Besimi i natyrës.

Artikulli "**nevoja e fesë**" mbështetet mbi disa nëntema që janë feja si prehje e vetme shpirtërore për njeriun, feja e vërteta e përjetshme, mjete më i mirë për ruajtjen nga e keqja, njeriu pa fe nuk mund të jetë i sinqertë, myslimanët mbetën prapa atëherë kur braktisën fenë e tyre.

Në artikullin **Feminizëm** ai trajton temat si martesë me kurorë, martesë stabilizim për njeriun, çfarë dëmshkakton i pamartuari, si e mbyllin jetën ata që nuk martohen, çfarë fshihet pas parullave të emancipimit të femrës, si lidhet kurora, historia nuk njihet popull pa fe, besimi është instinkti i lindur tek njeriu.

Në artikullin "Profesionimi ma i keq", ai trajton temën e

thashethemeve dhe të spiunimit.

Në artikullin "Bisedim", Kadri Prishtina polemizon me artikullshkruesin e gazetës "Lajmëtari", organ i kishës katolike në Shkodër, i cili kishte guxuar t'i drejtonte thirrje myslimanëve që të ktheheshin në të krishterë. Ai merr në diskutim edhe çështjen e dr. Rashës që jep lëndën e historisë myslimane në Gjymnazin Shtetëror, i cili mbështet në pohimet e historianëve tendenciozë perëndimorë që sulmojnë fenë islame dhe profetin e saj Muhamedin pa baza dhe të mbështetur në trillime.

Në këtë artikull ai ndalet në disa pika që janë: Kush i fton myslimanët në fenë e krishterë?, kush i nxiti kryqëzatat?, pluralizmi fetar tek shqiptarët, shqiptarët myslimanë janë të palëkundur në besimin e tyre, myslimanët e respektojnë Isanë (Krishtin), islami është fe e lirisë, e vërteta rreth gurit të zi (haxheru'l-esved) në Qabe, shpifjet e orientalistëve rreth udhëtimeve të profetit Muhamed kur ai ishte në moshë të re, Muhamedi i dërguar për mbarë njerëzimin, cilat janë bazat e fesë islame, pavërtetësia e mendimit se islami është përhapur me forcë, feja islame nuk e pranon fatalizmin, dallimi mes Kuranit dhe hadithit.

Interesant është krahasimi që Kadri Prishtina i bën xhizjes, që trajtohet nga shumë shkrimtarë dhe studiues si mjete i presionit që myslimanët përdorën kundër të krishterëve që ata të bëheshin myslimanë. Para së gjithash, Kadri Prishtina u bën thirrje që të hedhin sytë nga e kaluara e pushtimeve që kryen kombe si anglezët dhe francezët sa andej-këndej nëpër botë. Tek zhatjet dhe plaçkitjet që bënë ata në për këto vende dhe vrasjet në numër të banorëve vendas. Para këtyre të vërtetave historike, aplikimi i xhizjes nga myslimanët nuk qe tjetër përveç se një taksë më se e kuptueshme, përkundrejt së cilës jomyslimanët liroheshin nga kryerja e ushtrisë. Madje, edhe në të drejtën ndërkombëtare, shton Kadri Prishtina, në rast se shkoni në një vend të huaj duhet të merrni lejeqëndrimin për të cilin paguani një vlerë të caktuar parash, në rast se nuk pranoni ose në rast se refuzoni nënshtetësinë e atij shteti apo të mbretërisë ku ndodheni.

Artikulli Hytbe në të vërtetë është një thirrje drejtuar të gjithë myslimanëve shqiptarë, që të japin kontributin e tyre për të ndryshuar fatin e shtetit shqiptar, duke e mbyllur me këshillën që ende ruan vlerën e saj në planin kombëtar dhe që është: "**Çel sytë sot, të mos qash mot.**"

# Të shtosh nevojat

Një mbrëmje, tirani që mbretëronte në Turkestan, po dëgjonte një mjeshtër shpirtëror, i cili ishte duke i treguar ca rrëfenja, kur befasi ra ndërmend ta pyeste në lidhje me Hizrin.

-Hizri shfaqet kur ke nevojë,- i tha mjeshtri. Nëse ai shfaqet, mbërtheje kindin e tunikës së tij, dhe dituria bëhet e jotja.

-Mund t'ia dalë kushdo?,- pyeti mbreti.

-Kushdo që është i zoti,- u përgjigj mjeshtri.

-E kush mund të jetë më i zoti se unë?,- tha me vete mbreti, e pas kësaj u dha urdhër kasnecëve të tij që t'ua shpallnin njerëzve këto fjalë: ***“Do ta mbuloj me pasuri atë njeri që do më nxirrte përpara Hizrin e padukshëm, mbrojtësin e madh të njerëzve.”***

Duke dëgjuar këtë lajm, një plak me emrin Baftjar, i cili rronte në mjerim, pati një ide dhe i tha së shoqes:

-Kam një plan, e së shpejti do bëhemi të pasur. Pak më vonë, unë do të vdes, por kjo nuk ka rëndësi, sepse kjo pasuri do ta sigurojë jetën tënde.

Baftjari u paraqit tek mbreti dhe i tha se ishte në gjendje ta sillte Hizrin brenda dyzet ditëve, nëse ai, mbreti, do t'i jepte njëqind monedha ari.

-Nëse do ta glesh Hizrin,- u përgjigj mbreti, do të marrësh një shumë dhjetë herë më të madhe, përndryshe do të ekzekutohesh në çast, si paralajmërim për ata që do të guxojnë të tallen me mbretin.

Baftjari i pranoi kushtet. U kthye në shtëpi e ia dha florinj të shoqes. Tashmë, me atë shumë të hollash, jeta e saj qe siguruar. Dyzet ditët që i kishin mbetur për të rrojtur, i kaloi në meditim, duke u përgatitur për jetën tjetër.

Në ditën e dyzetë u paraqit tek mbreti e i tha:

-Madhëri, lakmia juaj ju ka çuar në atë gjendje sa të mendoni se paratë tuaja do ta detyrojnë Hizrin të shfaqet.

Por, është thënë se Hizri nuk shfaqet në përgjigje të dëshirave që burojnë nga lakmia.

Mbreti u tërbua.

-I mallkuar, këtë do ma paguash me jetën tënde! Kush je ti që guxon të tallesh me dëshirat e një mbreti?

Baftjari tha:

-Legjenda dëshmon se çdo njeri mund ta takojë Hizrin, por gjithashtu thotë se takimi është i frytshëm vetëm nëse qëllimet e njeriut që kërkon janë të pastra. Thuhet se Hizri mund t'i shfaqet një njeriu në masën dhe në kohën brenda të cilave njeriu e meriton ndërhyrjen e tij. Mbi këto të dhëna, as ju e as unë nuk mund të ushtrojmë as kontrollin më të vogël.

-Mjaft me këto dokrra!,- thirri mbreti. Sigurisht që këto fjalë nuk do të ta zgjasin jetën! Nuk më mbetet tjetër veçse t'u kërkoj këshilla ministrave të mi, të pranishëm këtu, që të gjej mënyrën më të mirë për të të ekzekutuar.

Iu drejtua vezirit të parë, dhe e pyeti:

-Në ç'mënyrë duhet të vdesë ky njeri?

-Piqeni për së gjalli,- tha veziri i parë, që të bëhet she-mbull për të tjerët.

Duke folur njeri pas tjetrit, veziri i dytë tha:

-Prejeni në katër pjesë.

Kurse i treti tha:

-Përbushjani këtij njeriu nevojat thelbësore në jetë, që të mos jetë më i detyruar të mashtrojë për të siguruar nevojat familjes së vet.

Teksa po gjykonin mbi këtë çështje, një plak i urtë kishte hyrë në sallën e dëgjimit. Me ta shprehur mendimin e vet edhe veziri i tretë, i porsaardhuri tha:

-Secili nga këta shprehu pikëpamjen që përputhet me paragjykimet e veta të fshehura e të pandryshueshme.

-Ç'kërkon të thuash?,- e pyeti mbreti.

-Dua të them se veziri i parë e ka filluar jetën e tij si bukëpjekës. Ai flet duke përdorur termat e zanatit të vet, e kështu propozon që këtë njeri ta pjekin. Veziri i dytë ka punuar kasap, prandaj di të flasë vetëm për prerje. Veziri i tretë, i cili është një mjeshtrë në politikë, arrin ta kuptojë thelbin e çështjes rreth të cilës jeni duke diskutuar. Kini parasysh dy gjëra. E para, që Hizri i shfaqet dhe i shërben secilit në bazë të aftësisë që ka për të përfituar nga ardhja e tij. E dyta, që ky njeri me emrin Baftjar, të cilin do ta quaj Baftjar Babà, për shkak të vetëflimit të tij është shtyrë nga dëshpërimi për të bërë atë që bëri. Ai ka shtuar nevojat e tij e, si rrjedhojë, më ka detyruar të shfaqem.

Dhe ndërsa të gjithë po e shikonin, plaku i urtë u zhduk përpara syve të tyre. Mbreti bëri ç'ishte e mundur për të ndjekur udhëzimet e Hizrit. I caktoi një pension të përjetshëm Baftjarit, ndërsa vezirin e parë dhe të dytë i shkarkoi nga detyra. Nga ana e tyre, Baftjar Babai dhe e shoqja, duke

u treguar mirënjohës, i rikthyen njëmijë monedhat e arta në thesarin mbretëror. Sesi mbreti arriti ta takonte sërish Hizrin, e gjithë ç'ndodhi mes tyre, gjendet e mbyllur në rrëfenjën e rrëfenjës së rrëfenjës së Botës së Padukshme.

\*\*\*

*Thuhet se Baftjar Babai ishte një sufi i urtë që kaloi një jetë të thjeshtë e të rregullt në Horasan, deri në ngjarjen që përshkruan kjo rrëfenjë. Duke iu mvëshur edhe mjshtrove të tjerë sufijnj, rrëfenja ilustron konceptin e ndërveprimit mes dëshirave njerëzore dhe një rrafshi tjetër të ekzistencës. Hizri është lidhja mes këtyre dy sferave. Titulli është frymëzuar nga poezia e famshme e Xhelaludin Rumit:*

**"Nevoja krijon organe të reja perceptimi.**

**Njeri, shtoji pra nevojat e tua,**

**Që të mund ta rritësh perceptimin tënd".**

*Ky version rrjedh prej gojës së një mjeshtri sufi nga Afganistani.*

## Mbreti dhe çunaku i varfër

**F**ill i vetëm, njeriu nuk mund t'i shkojë deri në fund udhëtimit të brendshëm. Nuk duhet të përpiqeni ta ndërmerrni vetëm këtë Udhë. Udhërrëfyeni është i domosdoshëm. Ai që po e quajmë mbret është udhërrëfyeni, e ai që po e quajmë fëmijë i varfër, është kërkuesi. Rrëfëhet se, një ditë, mbreti Mahmud rastisi të shkëputej nga ushtria e tij. Mbreti po kalëronte me të shpejtë, kur pa një çunak në breg të një lumi. Çunaku kishte lëshuar rrjetën në ujë dhe dukej shumë i trishtuar.

-Biri im-, i tha mbreti, -përse je i dëshpëruar? Kurrë nuk kam parë dikë në një gjendje të tillë.

-Madhëri-, iu përgjigj çunaku, -jemi shtatë vëllezër dhe nuk kemi baba. Jetojmë me nënën tonë në skamje dhe pa

mbështetjen e askujt. Unë vij këtu çdo ditë me rrjetën time, duke shpresuar të zëndonjë peshk për darkë. Nëse ditën nuk arrij të zëkurrëgjë, në mbrëmje s'kemi çfarë të hamë.

-Biri im-, i tha mbreti, -a dëshiron të të ndihmoj në këtë punën tënde?

Fëmija pranoi dhe mbreti Mahmud lëshoi rrjetën në lumë. Me të ndjerë preken e dorës mbretërore, rrjeta u mbush me njëqind peshq.

\*\*\*

*Kjo parabolë i përket të madhit Attar, dhe është shkëputur nga vepra e tij "Kuvendi i zogjve". Çmohet si në kuptimin letrar, ashtu dhe në atë simbolik.*



## Parimet themelore në edukimin e fëmijëve

**P**eriodha më ndikuese në formimin e fëmijëve është mosha 0-6 vjeçare. Është fjala për një periudhë kur fëmija nuk është njohur akoma me ndonjë rreth tjetër shoqëror përveç familjes. Si rezultat i kësaj, fëmijët në këtë periudhë “kopjojnë” çdo fjalë dhe veprim të prindërve, disa prej të cilave i përvetësojnë dhe i praktikojnë gjatë gjithë jetës.

Kjo periudhë përbën bazën e edukimit të fëmijës me etikën e të udhqerit, të fjeturit, me ndjenjën e respektit ndaj të mëdhenjve, me ndjenjën e mikpritjes, të mëshirës ndaj nevojtarëve dhe të dobtëve. Në këtë periudhë duhet patjetër ta njohim fëmijën me dashurinë dhe ta edukojmë me bindjen ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Përcjellja dhe adaptimi i këtyre parimeve realizohet me anë të dashurisë, interesimit dhe besimit që kemi tek fëmijët.

### DASHURIA

Gjithë psikologët janë të një mendimi se dashuria e nënës për fëmijën ndikon shumë në formimin psikologjik dhe në botën fiziologjike të fëmijës.

Fëmijët e rritur me përkëdhelje, fjalë të bukura dhe me dashurinë e prindërve zotërojnë një karakter të qetë, kanë besim në vetvete që janë në gjendje të përballojnë më sukses vështirësi nga më të ndryshmet.

Profeti (s.a.v.s.) ishte shumë i ndjeshëm në këtë aspekt, përkëdhelte dhe përqafonte çdo fëmijë.

Tregon Xhabiri (r.a.): “Fala namazin e drekës bashkë me Profetin (s.a.v.s.), pastaj u drejtuam për në shtëpi. Rugës takuam disa fëmijë, ndërsa Profeti i mëshirës përkëdheli kokën e çdo fëmije, përkëdheli edhe kokën time. Ndjeva në dorën e tij një freski dhe një erë të mirë,

aq sa m’u duk sikur dora e tij të kishte dalë nga një shishe misku (erë e mirë)”. (Tirmidhi)

### INTERESIMI

Fëmijët me të cilët bashkëpunojnë dhe interesohen familjarët, kanë prirjen të jenë më aktivë se fëmijët e tjerë, shohin çdo çështje me pozivitet dhe në përgjithësi zotërojnë një karakter të fortë.

Hz. Aliu (r.a.) ka thënë: “Luani me fëmijët deri në moshën 7 vjeçare, silluni si shokë me fëmijët deri në moshën 15 vjeçare, ndërsa pas kësaj moshe konsultohuni me ta duke marrë mendimin e tyre në çështje të ndryshme. Si rezultat, në të ardhmen këta fëmijë zotërojnë ndjenjën e përgjegjësisë në çdo hap të jetës së tyre.”

Ibni Abbasi (r.a.) tregon: “Kisha hipur bashkë me Profetin (s.a.v.s.) në kafshën e tij. Vogëlush, më tha ai:- do të të mësoj disa fjalë, ki kujdes ndaj urdhërave dhe ndalesave të Allahut, në mënyrë që edhe Allahu të kujdeset për ty. Zbato me kujdes çdo këshillë të Allahut, që ta kesh afër Atë në çdo moment. Nëse kërkon diçka, kërkoje nga Allahu...” (Tirmidhi)

### BESIMI

Fillimisht, duke ua bërë me dije fëmijëve që ata janë një amanet i Allahut, duhet t’u shprehim në çdo çast dashurinë e madhe që kemi për ta, sepse bazë e ndjenjës së besimit janë dashuria dhe respekti.

Vlerësimi, besimi dhe përkujdesja e vazhdueshme ndaj fëmijëve ndikon thellë në formimin e karakterit të tyre.

Jahja bin Muadh (r.a.) ka thënë: “**Çdo fjalë e thënë, çdo reagim, shton një tullë në “ndërtesën” e karakterit të fëmijës, ose heq një të tillë.**”

# Familja në këndvështrimin Islam

## KARAKTERI I NJË INSTITUCIONI HYJNOR

Familja është një institucion hyjnor, origjina e të cilit përkon me krijimin e njeriut, ndërsa lloji njerëzor është rezultat i këtij institucioni. Allahu (xh.sh.) thotë në Kuran: **“O ju njerëz! Kujtoni për detyrën që keni kundrejt Zotit tuaj, i Cili ju krijoi nga një çift i vetëm, pasi kishte krijuar mashkullin e më pas femrën duke nxjerrë nga çiftëzimi i tyre një numër të madh burrash e grash.”**

Në një vend tjetër në Kuran, ky raport martesor mes çiftit është emërtuar si shenja e Zotit.

Institucioni i familjes dhe ai i martesës janë përshkruar edhe si “praktika e profetëve”.

Profeti (s.a.v.s.) ka thënë: **“Martesa është pjesë e praktikës sime jetësore dhe kushdo që i largohet praktikës sime jetësore, nuk është prej nesh”.**

Në Kuran, martesa është përshkruar si një “marrëveshje private shumë e përgjegjshme” dhe, që ajo të jetë e vlefshme lypset konsensusi i të dy bashkëshortëve. Kjo nënkupton se martesa është një kontratë shoqërore.

Për të siguruar suksesin e martesës si dhe themele të shëndosha në familje, element i rëndësishëm është praktikimi i fesë nga të dy bashkëshortët.

Institucioni familjar luan një rol mjaft të rëndësishëm në shoqërinë Islame. Familja është njësi themelore e kësaj shoqërie dhe organizohet në mënyrë të atillë që të mund të përqaset me një shoqëri në miniaturë. Familja Islame është një familje e madhe. Në familjen Islame ka një barazi gjinore, e cila është e përcaktuar në Kuran nga vetë krijuesi i gjithësisë, sepse si mashkulli ashtu edhe femra marrin pjesë në mënyrë të barabartë në institucionin familjar.

Misioni i gruas është të përqendrojë energjitë dhe aktivitetin e saj në qeverisjen e shtëpisë dhe të familjes. Normalisht, gruaja ka përgjegjësi të caktuara shoqërore, të drejta dhe detyra, por detyra e saj kryesore dhe parësore është t'i përkushtohet familjes.

## FUNKSIONET DHE QËLLIMET E FAMILJES

Familja nuk është një fabrikë për prodhimin e njerëzve, por një mekanizëm që siguron stabilitetin social, ideologjik dhe kulturor të shoqërisë.

Ruajtja e llojit është një ndër qëllimet dhe funksionet e

familjes, ku Allahu (xh.sh.) thotë: **“Gratë tuaja për ju janë një fushë (që ju nuk duhet ta lini pas dore, por duhet ta trajtoni me dashuri, me shumë kujdes dhe përkushtim) kështu hyni në fushën tuaj si të dëshironi dhe kujdesuni për frutat që do të dalin.”**

Ruajtja e moralit është qëllim dhe funksion i rëndësishëm i familjes. Në lidhje me këtë çështje Allahu (xh.sh.) thotë: **“Martesa është si një fortesë që e mbron njeriun nga një jetë e çrregullt.”**

Një qëllim tjetër i familjes është që të sigurojë ekuilibër psikologjik dhe mbështetje shpirtërore. Raporti midis pjesëtarëve të familjes dhe në veçanti midis çiftit nuk është thjesht një raport utilitar. Ky raport ka karakter shpirtëror dhe prej tij buron dashuri, mirësjellje, mirëkuptim, mbështetje, besim reciprok, sakrificë, përkrahje dhe ndihmë. Allahu (xh.sh.) thotë: **“Ai krijoi për ju bashkëshortë nga lloji juaj ku ju të gjeni prehje dhe vuri midis jush dashuri dhe mëshirë.”**

Edhe edukimi shoqëror është një prej qëllimeve dhe funksioneve të familjes. Asnjë institucion tjetër nuk është në gjendje ta kryejë siç duhet këtë funksion, përveç familjes. Allahu (xh.sh.) thotë: **“Zoti ynë, bëj që gratë dhe fëmijët tanë të jenë burim kënaqësie për sytë tanë dhe bëje hijeshinë të zërë vendin e parë në praktikimin e drejtësisë.”**

Profeti (s.a.v.s.) ka thënë: **“Nga gjithë ajo që një prind mund t'i japë të birit, më e vlefshmjia është një edukatë e mirë dhe përgatitja për jetën.”**

- Institucioni familjar është një pjesë shumë e rëndësishme e sistemit Islam të sigurimit shoqëror dhe ekonomik. Profeti (s.a.v.s.) ka thënë: **“Kur Zoti ta jep mirëqenien ekonomike shpenzo fillimisht për veten dhe familjen tënde.”**

- Familja është motiv për përpjekje dhe sakrificë, si dhe ndikon pozitivisht në progresin shoqëror. Nëse institucioni i familjes dobësohet ose shkatërrohet, gjithë e ardhmja e njerëzimit do të jetë në rrezik të madh. Rolin kryesor për një familje të shëndetshme e luan gruaja.

- Familja është një botë e tërë dhe përfshin zhvillimin e një kompleksi aktiviteteve intelektuale fizike dhe organizative. Gruaja e drejton dhe e mban atë me përgjegjësi dhe autoritet. Profeti (s.a.v.s.) ka thënë: **“Kush edukon një grua ka edukuar një shoqëri.”**





## Shkencëtarët: *Alkooli më i dëmshëm se heroina*

Bazuar në një studim të bërë nga një revistë britanike mjekësore, alkooli renditet si më “i dëmshmi” në listën që përmban 20 droga, duke lënë pas heroinën dhe kokainën.

Sipas CNN, një panel ekspertësh “peshoi” problemet fizike, psikologjike dhe sociale të shkaktuara nga drogat dhe rezultoi se alkooli është më i dëmshmi nga të gjithë. Studimi u publikua nga “The Lancet Sunday”.

Në vlerësimin e shkallëzuar nga 1 deri në 100, që synonte të përcaktonte dëmtimin që njeriu i bën vetes dhe të tjerëve, alkooli mori një rekord prej 72 pikësh. Ky vlerësim e bën atë të paktën tri herë më të dëmshëm se kokaina dhe tabakojat.

Herina, Krak kokaina dhe metamfetamina renditen si drogat më të dëmshme për individët, ndërsa si më të dëmshmet për veten edhe për të tjerët, i pari është alkooli



i ndjekur nga heroina dhe krak kokaina.

Panelistët thanë se renditja konfirmon studimet e tjera, të cilat thonë se “lufta e ashpër kundër dëmeve të alkoolit është e vlefshme dhe e nevojshme për strategjinë e shëndetit publik”.

## OECD: Obeziteti rrezik serioz për vendet në zhvillim



Vendet në zhvillim, ku përfshihen dhe vendet, në të cilat ekonomia po fuqizohet gjithmonë e më shumë, si Brazili, Kina, India dhe Rusia, duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme për të luftuar mbipeshën që është duke njohur rritje dramatike. Organizata për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik, OECD, në raportin e saj të fundit thekson se mënyra jo e shëndetshme e të ushqyerit dhe mungesa e aktiviteteve fizike, kanë bërë që numri i njerëzve mbi peshë në vendet në zhvillim t’i afrohet atyre të zhvilluara.

Raporti thekson se shtatë në dhjetë mexikanë të rritur janë obezë dhe po kështu gjysma e brazilianëve, rusëve dhe afrikano-jugorëve i takojnë kësaj kategorie.

# Duhani, shkak i parë i vdekjeve në botë

Përdorimi i duhanit është tani shkaku i parë i vdekjeve në botë. Drejtori i Qendrës amerikane për Kontrollin e Sëmundjeve thotë se jo të gjitha vendet e botës po marrin masat e nevojshme për ndalimin e duhanit. Dr. Tomas Friden në Qendrën për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare në Washington, foli po ashtu rreziqe të reja që kërcënojnë shëndetin global. Më tepër se 5 milionë njerëz vdesin çdo vit ngaqë pijnë duhan, shumë prej të cilëve jetojnë në vendet në zhvillim. Doktor Thomas Frieden përmend vende si: Shtetet e Bashkuara dhe Uruguaji, programet e të cilëve kundër duhanit kanë patur sukses. Ai thotë se shembullin e tyre duhet ta ndjekin edhe vende të tjera.

**"Duhani është tani shkaku kryesor i vdekjeve në botë. Ai shkakton më tepër vdekje se sa SIDA, tuberkulozi dhe malaria të marra së bashku. Dhe ndryshe nga këto sëmundje, të cilat janë duke u pakësuar, duhani po bëhet tani më tepër shkak i vdekjeve."** - thotë doktori.

Por pirja e duhanit është jo vetëm një nga problemet kryesore të botës, thotë Dr. Frieden; ai shton se vdekjet nga aksidentet në trafik po shtohen si epidemi. Ai thotë se çdo vit në trafik humbin jetën më tepër se 1 milion vetë, mes të cilëve numërohen edhe njerëz që ecin më këmbë apo me biçikletë:

**"Nëse nuk marrim masa urgjente, do të ndodhë në 20-25 vjetët e ardhshme vdekjet në trafik të shtohen nga 2 për qind të të gjitha vdekjeve që përbëjnë tani, në 3 për qind e gjysëm. Ato do të bëhen shkaku i 5-të i vdekjeve në mbarë botën"**

Dr. Friden thotë se infeksionet në rrugët e frymëmarrjes, si tuberkulozi, vazhdojnë të jenë një tjetër problem kyç. Ai thotë se një miliardë njerëz nuk kanë ujë të pijshëm dhe dy miliardë e gjysëm jetojnë në kushte jo të mira sanitare. Ai thotë se, nëse njerëzit do t'i kishin këto kushte të nevojshme, do të parandaloheshin vdekjet e miliona njerëzve, mes tyre fëmijë që vdesin nga diareja:

**"Ka ende raste të kolerës në shumë vende të botës, gjë që pasqyron dështimin tonë në përpjekjet për të siguruar ujë të pijshëm dhe kushte të nevojshme sanitare."**



Drejtori i Qendrës për Kontrollin e Sëmundjeve thotë se SIDA vazhdon të jetë shkaktari kryesor i vdekjeve në Afrikë. Ai thotë se pjesë e problemit është se gjysma e njerëzve të infektuar me virusin HIV, që shkakton SIDË-n, nuk e dinë fare se janë të infektuar:

**"Ne jemi të bindur se njerëzit që e dinë se janë të infektuar nga sëmundja e kanë më pak të mundur ta përhapin infeksionin tek njerëzit e tjerë, kështu që vetmja mënyrë për të marrë ndihmën e nevojshme është të dish që je i infektuar,"** - thotë zoti Friden.

Dr. Friden thotë se obeziteti është po ashtu një problem përherë e më shqetësues për shëndetin. Ai thekson se tani ka në botë më tepër persona në mbipeshë se sa nën peshë. ...Gjithashtu, ai shton se numri i përvitshëm i vdekjeve nga kanceri mund të përgjysmohet nëse njerëzit e lënë duhanin, nëse mbajnë një dietë më të shëndetshme dhe zhvillojnë aktivitete më të madh fizik.

## Ja mbulesa e qëndisur me ar e Qabes



Në fabrikën e hapur për të qëndisur mbulesën e Qabes mund të qëndiset vetëm një mbulesë në vit. Mbi mbulesën prej kumashi të vërtetë që peshon 670 kg, përdoren 120 kg ar dhe argjend për perin e përdorur në qëndisjen e ajeteve (pasazheve të Kuranit).

Në fabrikën Masnaat-ul Kisve (Fabrikën e mbulesës) që ndodhet në Meke dhe ku po qëndiset mbulesa e Qabes, punojnë 70 punëtore me kombësi arabe.

Për këtë mbulesë me vlerë rreth 4 milionë euro, përdoret 670 kg kumash i vërtetë dhe 720 kg bojë.

Me lartësi 13 m dhe gjerësi 11 m, mbulesa që përdoret për të mbuluar Qaben prej guri përbëhet nga 16 pjesë, ndërsa mbulesa e derës së Qabes përbëhet nga 5 pjesë.

Endja, ngjyrosja, qëndisja dhe përgatitja e mbulesës së Qabes zgjat 1 vit.

### -AJETET (PASAZHET) E QËNDISURA ME AR

Për ajetet e qëndisura mbi mbulesë dhe për perin e përdorur duhet 120kg ar dhe argjend.

Në pjesën e jashtme të mbulesës së Qabes qëndisen ajete me pe të ndërthurur me ar dhe argjend.

Për të arritur një paraqitje më të bukur të shkrimeve, nën shkronjat me ar dhe argjend bëhet pak fryrje. Fryrjet e bëra me pe prej mëndafshi mundësojnë një shikim më të qartë nga larg të shkronjave arabe.

### -DO TË NDËRROHET DITËN E AREFESË

Mbulesa e jashtme e Qabes së shenjtë, e quajtur ndryshe "Bejtullah", (shtëpia e Zotit), ndryshohet një herë në vit.

E futur në ihram në fillim të muajve të haxhit duke mbledhur anët e mbulesës, Qabja del nga ihrami ditën e arefesë (sot) me ndërrimin e mbulesës.

Ndërrimin e mbulesës, të bërë një ditë para Bajramit në kohën kur haxhinjtë ndodhen në Arafat, mund ta shohin vetëm vendasit.

Qabja, mbulesa e së cilës ndryshohet me ndihmën e ashensorëve dhe përpjekjeve të dhjetëra njerëzve, bëhet gati për vizitën e haxhinjve që zbresin nga Arafati.

Ndërsa mbulesa e brendshme me ngjyrë jeshile e Qabes ndryshohet një herë në 20 vjet.

### -SHTËPIA E PARË, TEMPULLI I PARË

E quajtur si "Bejtullah" d.m.th. "shtëpia e Zotit", Qabja e shenjtë njihet si një nga vendbanimet më të lashta të gjeografisë botërore.

Është shtëpia dhe tempulli i parë i ndërtuar në tokë. Arsyetja e quajtjes "Bejtullah" të Qabes, një nga vendet më të pazëvendësueshme në historinë e njerëzimit, është vetëm për të treguar vlerën dhe madhësinë e saj.

Qabja e shenjtë është vendi i shenjtë i vizituar nga gjithë profetët gjatë shekujve me radhë, me lutjen e Ibrahimit dhe Ismailit (a.s.) është begatuar e gjithë zona, e cila njihet si tempulli më i rëndësishëm.

Pavarësisht transmetimeve se profeti Ismail (a.s.) ka qenë i pari që e ka mbuluar Qaben, sipas disa opinionëve më të sakta pranohet se i pari që e ka mbuluar Qaben është një nga mbretërit e Jemenit, Esad Ebu Kerib.

Edhe në shekujt më pas Qabja është mbuluar me mbulesa të ndryshme dhe ka transmetime se gjyshi i profetit Muhamed (a.s.) Abdulmuttalib e ka veshur Qaben me kisve, si falënderim për gjetjen e ujit zemzem.

### -MUZEU I QABES

Në muzeun e Qabes (Methaful-Kabe) ngjitur me fabrikën e mbulesës ekspozohen mbulesa të vjetra të Qabes, çelësat, dyert, kolonat, ulluqet.

I vizituar nga miliona haxhinj të ardhur nga të katër anët e botës, Muzeu i Qabes ruhet nën masa të rrepta sigurie.

## Vizita e Kryeministrit Erdogan në Kosovë

Kryeministri Rexhep Tajip Erdogan, më 3-4 nëntor zhvilloi një vizitë zyrtare në Kosovë. Erdogan është Kryeministri i parë turk që viziton Kosovën. Të mërkurën, gjatë vizitës së tij të parë në Kosovë, Rexhep Tajip Erdogan iu rezervua një pritje e madhe në Prishtinë dhe Prizren. Në Prizren iu bë një pritje madhështore nga mijëra qytetarë dhe iu dha titulli “Qytetar Nderi”, në Prishtinë, Hashim Thaçin e quajti “vëlla”. Kryeministri i Turqisë premtoi mbështetje ekonomike dhe politike për shtetin e ri dhe deklaroi se shteti i tij gjithmonë do të përkrahë Republikën e Kosovës.

Ndër të tjera Erdogan tha: *“Unë dhe vëllai im Thaçi, në bisedat që kemi zhvilluar, edhe në Ankara, por edhe në takimin e sotëm, jemi zotuar që të vazhdojmë këtë unitet në bashkëpunimin midis vendeve tona dhe që Kosova të ketë një të ardhme më të fuqishme dhe më të begatë.”*

Ndërsa në gjatë vizitës që zhvilloi në Prizren deklaroi: *“Të jeni të bindur se Turqia gjithmonë e ka syrin dhe veshin nga Kosova. Jemi ndër ata që më së shumti jemi gëzuar për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Është një kënaqësi e madhe*

*për mua që jam Kryeministri i parë i Turqisë që vizitohet Kosovën”.*

Vizita e Kryeministrit Erdoan në Kosovë në datat 3-4 nëntor mund të jenë caktuar rastësisht, por është e qartë që kjo vizitë u realizua në një moment kritik. Para së gjithash pritjet që me presionin e Perëndimorëve të nisë një proces i ri negocimi mes Kosovës dhe Serbisë. Ministri i Jashtëm, Ahmet Davutollu fliste hapur se është i gatshëm të ndërmjetësojë në negociatat në fjalë. Në të kaluarën Turqia në lidhje me problemin e Kosovës gjithmonë ka bërë hapa në përputhje me organizatat ndërkombëtare. Nëse duhet të rikujtojmë në ndërhyrjen e NATO-s ndaj Serbisë në vitin 1999, Turqia mori pjesë me 11 avionë luftarakë të tipit F-16. Kur perëndimorët vlerësuan se është e përshtatshme që Kosova të jetë e pavarur, Turqia u rendit mes vendeve të para që e njohu pavarësinë e saj.

Në këtë vizitë ai u shoqërua nga kryeministri në largim i Kosovës, Hashim Thaçi, kryetari i komunës së Prizrenit Ramadan Muja dhe ministri në largim i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Mahir Jagcilar.

## Kryeqyteti i Shqipërisë me xhami të re dhe një muze ndërftuar

Një ditë para festës së madhe të Kurban Bajramit, besimtarët myslimanë marrin lajmin e mirë se ashtu si dy komunitetet e tjera fetare të mëdha, do të kenë tashmë një xhami të re në qendër të kryeqytetit.

Në lidhje me këtë vendim, kreu i bashkisë së Tiranës u shpreh kështu:

*“Në prag të kësaj nate të mirë dua t’ju jap lajmin që bashkia ka gati planin e punës për ndërtimin e xhamisë së re, një nevojë e munguar e komunitetit mysliman.”*

*“Sa herë dalim nga këto dyer flasim fjalë të bukura për bashkëjetesën fetare dhe për unikalitetin e këtij qyteti dhe të këtij vendi që jeton në harmoni me të tri komunitet e tij fetare. Sot unë jam shumë i lumtur që përveç fjalëve mund të përsëris nismën për t’i hapur rrugë më në fund realizmit të xhamisë së re, e cila plotëson trekëndëshin e bashkëjetesës fetare, duke fuqizuar këtë imazh të harmonisë fetare, duke i dhënë besimtarëve myslimanë shtëpinë e tyre të re e duke i dhënë të gjithë kryeqytetasve një pikë të re referimi në këtë qytet.”*

Edi Rama ka zgjedhur pikërisht këtë dhuratë simbolike për t’u uruar të gjithë besimtarëve myslimanë festën e Kurban Bajramit.

“Për xhaminë e re kemi gati një sipërfaqe të nevojshme në qendër të Tiranës, bazuar në planin e qendrës. Kemi edhe asistencën teknike për të organizuar konkursin ndërkombëtar.” - tha Rama. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Edi Rama u shpreh se përgjigja pozitive ndaj komunitetit për një hapësirë më të madhe do të pasojë dhe bashkëpunimin e mëtejshëm me përfaqësues të Komunitetit Mysliman, deri në ndërtimin e kësaj xhamie dhe muzeut në krah të saj.

Tirana së shpejti do të ketë edhe një muze dedikuar bashkëjetesës fetare. Projektidenë e prezantoi kreu i Bashkisë së Tiranës, Edi Rama së bashku me studiues, historianë dhe përfaqësues të komuniteteve fetare, mbështetës të kësaj ideje.